

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • N° 391 QERSHOR 2023

MADHËSHTIA E ADHURIMIT JETËSOR - HAXHIT

GRUAJA NË HAXH

MORALI ISLAM PËRBALLË SFIDËS SË
MODERNITETIT

بِالْحَجِّ وَأَذِّنْ فِي النَّاسِ

يَأْتُوكَ رِجَالًا وَعَلَى كُلِّ ضَامِرٍ يَأْتِينَ مِنْ كُلِّ فَجٍّ عَمِيقٍ ﴿٢٧﴾

«Dhe thirr ndër njerëz për haxh, se të vijnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura, që vijnë nga rrugë të largëta!»

(El Haxh: 26, 23)



EDITORIAL

- 4 Porosi fisnike nga Shtëpia e Lashtë

FE & SHKENCË

- 5 Haxhi dhe mesazhet e tij unifikuese për myslimanët
Vedat Shabani
- 9 Madhështia e adhurimit jetësor - haxhit
Isa Tërshani
- 12 Kushtet e obligueshmërisë dhe ato të vlefshmërisë së haxhit
Mr. Fitim Gashi
- 15 Farzet dhe vaxhibet e haxhit
Mr. Zenel Hajdini
- 18 Gruaja në haxh
Dr. Ilmije Kuqi
- 22 Haxhi për tjetrin (bedeli)
Mr. sc. Bahri Curri
- 25 Haxhi, udhëtimi më i bukur i jetës me të cilin e fitojmë Xhenetin
Mihana Goga – Bekteshi
- 27 Komentimi i sures El-Fet'h (5)
Sabri Bajgora
- 31 Pranimi dhe shpërndarja e informacionit në këndvështrimin e ajetit të 6-të të kaptinës Huxhurat
Dr. Valmire Batatina

FAMILJE & EDUKIM

- 34 Morali islam përballë sfidës së modernitetit
Ervin Qylafku



- 38 Inteligjenca Artificiale – IA, dilemat, problemet dhe e ardhmja

Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi

- 41 Rrugëtimi shpirtëror drejt së vërtetës hyjnore

Mimoza Sinani

KULTURË

- 44 Dijetarët shqiptarë në revistën "Hëna e Re"

Sadik Mehmeti

- 48 Një vështrim filleve të literaturës islame në gjuhën shqipe në Kosovë (1)

Arbin Ahmeti

PERSONALITETE

- 51 Hafëz Selim ef. Hoshi, myezini i njohur shqiptar i xhamisë së "Sulltan Fatihut" në Sarajevë

Bajro Perva

HISTORI & CIVILIZIM

- 53 Haxhi në kohë

Dr. Agron Islami

- 56 Konvertimi i shqiptarëve myslimanë në fenë ortodokse në Sanxhakun e Nishit

Prof. dr. Jusuf Osmani

- 61 Rëndësia e Imam Maturidiut dhe shkollës maturidite për një qytetërim të ri islam (1)

Prof. dr. Hasan Onat

AKTIVITETE

- 65 Myftiu Tërnavë dhe nënsekretari i Kombeve të Bashkuara vizituan Xhaminë e Madhe



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore

Nr. 391 • viti 37 • qershor 2023

• Dhul-Ka'de 1444

• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi

Anëtarë:

Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci, mr. Muharrem Tërnavë, mr. Vedat Shabani.

Sekretar redaksie: Dr. Rexhep Suma

Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri

Redaktor artistik & teknik:

Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame", rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +384 38 224 024

E-mail: redaksia@dituriaislame.net

www.dituriaislame.net

Shtypi:

"Europrint", Prishtinë



*“(Kujto) Kur Ibrahim
tha: “Zoti im! Bëje
këtë qytet (Mekën) të
sigurt dhe më mbro
mua e bijtë e mi nga
adburimi i idhujve!”*

(Ibrahim, 35)

POROSI FISNIKE NGA SHTËPIA E LASHTË

Në viset e largëta e të thella të shkretëtirës përcëlluese arabe, diku në mes ca gurëve të thepisura e atyre kodrave të egra e shtatlarta, u ndërtua një Shtëpi e Shenjtë, që synonte të freskonte shpirtin e mekur njerëzor me puhizën e njomë të besimit të kulluar monoteist. Me urdhër të Zotit, e në Mekën e bekuar, u ngrit Shtëpia e Lashtë-Qabeja, e cila që atëherë e gjer më sot, vazhdon të bekojë njerëzimin me mesazhet e pavdekshme të fesë së zgjedhura nga Zoti Fuqiplotë.

Ajo ishte dhe mbetet faltorja e parë e monoteizmit në tokë. Këto fakte na i rikujtoi për ne Vetë Allahu në Librin e Tij fisnik kur tha: “Shtëpia faltore (xhamia) e parë e ndërtuar për njerëz është ajo në Bekë (Mekë), e dobishme dhe udhërrëfyese për mbarë njerëzimin. Aty ka shenja të qarta (të madhërisë së Allahut), (aty gjendet edhe) Mekami-vendi i Ibrahimit. E kush hyn në të, ai është i sigurt ...”. (Ali Imran, 97). Në gjirin e atyre njerëzve që më shumë se kushdo tjetër kishin harruar parimet e besimit në Një Zot, u ngrit Shtëpia e Zotit, që synonte të flakte përgjithmonë muzgun e frikshëm të idhujtarisë e të injorancës, nga ajo shoqëri nomade arabe në fillim, por pastaj edhe nga i tërë njerëzimi pa dallim.

Me gjithë faktin se në një periudhë jo aq të shkurtër historike, para ardhjes së Muhamedit (paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të), brenda Qabesë së Bekuar u vendosën mizorisht shumë idhuj nga politeistët e lajthitur, që i krijonin ortakëri të shpifur hyjnise së Zotit të Vërtetë, megjithatë Vullneti Hyjnor i Zotit të asaj Shtëpie nuk lejoi që aty të lëshonte edhe më tej rrënjë idhujtaria dhe besimi i devijuar njerëzor. Qabeja e Bekuar, që nga çlirimi i Mekës e këndeje, do të kthehej përfundimisht nën kujdesin e besimtarëve myslimanë. Atyre që besuan dhe jetësuan mesazhet hyjnore të zbritura nga Allahu për njerëzimin në atë vend. Ajo i kthehet misionit të vet të përvijuar nga Zoti, për të mos mbetur më asnjëherë në dorë të “harrestarëve” të monoteizmit të mirëfilltë.

Atë Shtëpi të Bekuar, Allahu na e bëri obligim që të vizitojmë, sipas mundësive, së paku një herë në jetë. Të shkojmë atje që ta kryejmë ritualin islam më përbashkues e më madhështor mbi faqen e dheut-haxhin. Kështu, secili nga që ka mundësi të marrë këtë udhë, në shenjë të nënshtrimit e përgjigjes ndaj thirrjes së Tij hyjnore ia mësyjmë Mekës duke brohoritur fjalët “Lebbejke Allahumme lebbejke, lebbejke la sherike leke lebbejke -Të përgjigjemi Ty o Zot, të përgjigjemi, Ti nuk ke askënd shok-ortak, ne Ty të përgjigjemi...”.

Të veshur që të gjithë me petkun e bardhë të modestisë e delirësisë shpirtërore-ihramin, gjithandej nëpër vendet e shenjta në Mekë, e veçanërisht në Qabe e Arafat, myslimanët manifestojnë në formën më mahnitëse unitetin e vëllazërinë ndërmjet vete, që edhe më tej mbetet aspiratë e lartë fisnike që ka nevojë shumë më shumë për jetësim. Këto synime fisnike të haxhit janë vërejtur edhe nga të tjerët, që nga distanca soditën këtë ritual bazik të Islamit.

F. Hitti, si studiues i njohur libanezo-amerikan dhe shkollor i Harwardit, ishte njëri prej tyre. Ai, me gjithë opinionet e ngatërruara që i kishte rreth Islamit, prapë kur flet rreth haxhit dhe peshës së tij të myslimanët, në formë objektive thotë: “Haxhi edhe më tutje, përgjatë gjithë kohës mbetet një sistem që nuk krahasohet me asgjë tjetër në përforcimin e lidhjes së mirëkuptimit Islam, si dhe në përbashkimin e shtresave të ndryshme të myslimanëve. Dhe në sajë të tij, i mundësohet secilit mysliman që së paku një herë në jetë të marrë rrugëtim të gjatë, që të bashkohet me besimtarët e tjerë në një vendtakim vëllazëror. Haxhiu aty i bashkon ndjenjat e veta me ndjenjat e atyre haxhilerëve të tjerë të ardhur nga gjitha anët e botës...Islami arriti një sukses që nuk arriti asnjë fe tjetër e botës. Arriti eliminimin e diskriminimit në baza racore, të ngjyrës e të nacionalitetit në mënyrë specifike në mes të pasuesve të tij...”, (The Arabs: A Short History). Një adhurim madhështor mbetet madhështor, nëse ne ruajmë shpirtin e tij, dhe përçojmë te të tjerët porositë e urtësitë e tij.

E për atë vend të bekuar, ne na mjafton ta bëjmë lutjen e përsëritshme të Ibrahimit a.s., i cili pasi ngriti themelet e Qabesë aty, ngriti duart e tha: “(Kujto) Kur Ibrahim tha: “Zoti im! Bëje këtë qytet (Mekën) të sigurt dhe më mbro mua e bijtë e mi nga adhurimi i idhujve!” (Ibrahim, 35).

Mr. Driton Arifi

Haxhi dhe mesazhet e tij unifikuese për myslimanët

Vedat Shabani

HAXHI DHE UNITETI ISLAM

Uniteti islam është një prej aspekteve të haxhit. Myslimanët nga e gjithë bota mbledhen në Mekën e bekuar dhe kryejnë së bashku ritualet e haxhit. Haxhi është një tubimi fetar i të gjithë myslimanëve me karakter global. Le t'i meditojmë së bashku këto ajete kuranore: *"Dhe kur shtëpinë (Qabenë) e bëmë vendkthim dhe vend sigurie për njerëzit.¹; "Shtëpia (xhamia) e parë e ndërtuar për njerëz, është ajo që u ngrit në Bekë (Meke), e dobishme udhërrëfyesë për mbarë njerëzimin)."*² *"Allahu e bëri Qabenë, shtëpinë e shenjtë, vend jetësim (çështje të fesë e të jetës) për njerëzit."*³ *"... pra bën që zemrat e disa njerëzve të mallëngjehen për ata."*⁴ *"Dhe thirr ndër njerëz për haxhin, se të vijnë ty këmbësor e edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të larta."*⁵

HISTORIKU I HAXHIT

Historia e haxhit është e ndërlidhur me jetën e Ibrahimit dhe Ismailit a.s., të cilët i besojnë si peygamberë jo vetëm myslimanët, përkundrazi, edhe ithtarët e feve të tjera qiellore i konsiderojnë ndër peygamberët më të njohur, dhe pikërisht për këtë arsye rituali i haxhit gëzon një shenjtëri dhe madhështi historike, që nuk e gëzon asnjë ritual tjetër fetar në botë. Ibrahim a.s. ka lindur në Irakun e lashtë, kurse Ismaili a.s. ishte biri i tij. Iraku në atë kohë ishte një vend i qytetëruar. Azeri, babai i Ibrahimit dhe gjyshi i Ismailit, ishte ndër zyrtarët e lartë në qeverinë irakiane të asaj kohe. Së këndejmi, mundësitë për përparim dhe avancim në Irak ishin të hapura për Ibrahimin dhe Ismailin a.s., mirëpo ata

nuk mund të toleronin një sistem të bazuar në politeizëm. Për këtë arsye, ata e braktisën atë vend pjellor që ishte qendra e politeizmit për të adhuruar Zotin Një, të Vetëm. Ata shkuan në shkretëtirën shterpe arabe, dhe aty ndërtuan Shtëpinë e Zotit xh.sh. me qëllim që ajo të jetë një qendër botërore për adhurimin e Zotit të Vetëm. Kjo qendër botërore është edhe vendi i kryerjes së ritualeve të haxhit. Le të shohim tani disa aspekte të këtyre ritualeve. Fjala të cilën haxhiu e përsërit vazhdimisht gjatë haxhit është: "Allahu është më i madhi, Allahu është më i madhi, nuk ka zot tjetër përveç Allahut, Allahu është më i madhi, Allahu është më i madhi, lavdërimi i qoftë Allahut!" Bërja e haxhiut t'i përsërisë këto fjale pa pushim synon të gjenerojë një psikikë të caktuar tek ai, për të kuptuar se madhështia i përket vetëm Allahut. Të gjitha format e tjera të madhështisë duhet të përkulen përpara kësaj madhështie dhe ta pasojnë atë. Kjo ndjenjë është sekreti më i madh social, sepse jeta sociale dhe unike – e bashkuar nuk bëhet aty ku të gjithë mendojnë se ai është i madh. Përçarja është shenjë e luftës për autoritet, ndërsa uniteti islam përmes ritualit të haxhit është uniteti më autoritativ. Tavafi është një nga shtyllat më të rëndësishme të haxhit, dhe të gjithë ata që takohen në Mekë gjatë sezonit të haxhit fillojnë me tavafin e Qabesë, që është një konfirmim praktik se një person do të bëjë një pikë në fokus të të gjitha përpjekjeve të tij, dhe se ai do të lëvizë në një rreth unik. Pastaj haxhiu vrapon midis Safasë dhe Merves, duke filluar nga kodrina e Safasë dhe pastaj duke u kthyer prapë aty. Ky veprim na mëson në mënyrë praktike se përpjekja jonë në jetën praktike duhet të jetë brenda kufijve të caktuar,

Përçarja është shenjë e luftës për autoritet, ndërsa uniteti islam përmes ritualit të haxhit është uniteti më autoritativ

pra nëse nuk do të kishim kufij ose do t'i tejkalonim ata; atëherë disa prej nesh do të devijojnë nga njëra anë, ndërsa disa nga ne do të humbasin në anën tjetër. Por kur ne i vendosim disa kufij qëllimeve tona, ne gjithmonë do të kthehemi atje ku janë vëllezërit tanë. Kështu vërtiten ritualet e tjera të haxhit, të cilat na mësojnë, në një mënyrë apo tjetër, të bashkohemi dhe të punojmë së bashku. Këto rituale janë një demonstrim praktik i veprimit harmonik mes nesh.

QABEJA, QENDËR E BESIMIT MONOTEIST

Kur flasim për haxhin dhe unitetin islam, përmes ajeteve kuranore, duhet të dimë se qëllimi hyjnor pas ndërtimit të Qabesë nga Ibrahim a.s. ishte përgatitja e një qendre për njerëzit e monoteizmit. Shtëpia e Zotit, Qabeja, është qendra e myslimanëve deri në Ditën e Kiametit dhe është selia e takimit vjetor global për të gjithë myslimanët anekënd botës. Thuhet se Zoti i Madhëruar e urdhëroi Ibrahim që t'i thërriste njerëzit që të vinin në këtë shtëpi si vizitorë. Ai tha: "O Zot, si t'i informoj njerëzit kur zëri im nuk i arrin ata?!" Ai tha: "Ti thirri, ndërsa Ne ua përcjellim atyre ftesën." Me këtë rast, Ibrahim a.s. hipi mbi një gur dhe tha: "O njerëz, Zoti juaj ka bërë një shtëpi, prandaj bëni haxhin tek ajo." Prandaj thuhet: "Malet u përulën derisa zëri arriti në cepat e tokës, atë zë e dëgjuan edhe ata që ishin në mitër, dhe këtij zëri iu përgjigjen të gjitha ata që do të bëjnë haxhin deri në Ditën e Kiametit." Zëri i Ibrahim a.s. ishte një thirrje simbolike dhe jo në mënyrë reale.

Tradita e të Dërguarit të Zotit tregon se haxhi është vendtubimi më i përshtatshëm për diskutimin e të gjitha çështjeve dhe vendimeve të rëndësishme për Islamin dhe myslimanët.

HAXHI, VENDTUBIM PËR DISKUTIM TË ÇËSHTJEVE MADHORE

Haxhi është vendtubimi i natyrshëm për kumtimin e çështjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë edhe me jetën sociale. Prandaj, çështjet më të rëndësishme të Islamit dhe myslimanëve shpallëshin në kohën e haxhit. Një nga shembujt e tillë është deklarimi ose shfuqizimi i marrëveshjes me jobesimtarët dhe mushrikët, e cila ndodhi pas zbritjes së sures Et Teube. Meka u çlirua në muajin Ramazan të vitit 8 hixhri. Pas çlirimit u bënë tri haxhe gjatë jetës së të Dërguarit a.s. dhe i Dërguari i Zotit nuk e bëri haxhin gjatë dy viteve të para, por në vitin e dhjetë e kreu



haxhin e tij, i njohur përgjithësisht si haxhi i lamtumirës, e më pastaj vdiq. I Dërguari i Zotit a.s. e kishte caktuar Ebu Bekër es Sidikun për udhëheqës të haxhilerëve në vitin e 9-të hixhri, kështu që Ebu Bekri shkoi në Mekë me një grup shokësh dhe pasi u largua nga Medina, zbriti pjesa e parë e sures Et Teube, në të cilën Zoti urdhëroi që i Dërguari a.s. të shpallte shfuqizimin e marrëveshjes mes Zotit xh.sh. dhe të Dërguarit të Tij dhe mes politeistëve, duke i dhënë një afat prej katër muajsh për ta vënë në praktikë këtë deklaratë. Dispozita e shfuqizimit të kësaj marrëveshje kishte zbritur në Medinë, mirëpo kumtimi i saj ishte bërë në Mekë gjatë sezonit të haxhit, dhe kjo është dëshmi e qartë se periudha e haxhit në Mekë është vendi i duhur për shpalljen e të gjitha vendimeve të rëndësishme islame. Haxhi është qendra unike për të gjithë myslimanët e botës, dhe këtu duhet të shpallin vendimet dhe planet e tyre madhështore për një të ardhme më të mirë të mbarë njerëzimit. Shembulli i dytë i qartë për këtë është hytbeja e lamtumirës, e cila është hytbeja më e rëndësishme në jetën e të Dërguarit a.s.. Me anë të saj, ai dëshiroi t'i informonte njerëzit për kërkesat themelore të fesë Islame në formën përfundimtare para vdekjes së tij, dhe këtë,

i Dërguari a.s., nuk e shpalli askund tjetër përveçse në haxhin e fundit në vitin 10 hixhri. Ishte e mundur që i Dërguari i Zotit a.s. t'i ftonte njerëzit në Medine për ta bërë këtë deklaratë para tyre, por ai nuk ndoqi këtë rrugë, mirëpo priti haxhin dhe kështu ai i kumtoi ato këshilla pas mbërritjes së tij në Mekë. Kështu, tradita e të Dërguarit të Zotit tregon se haxhi është vendi më i përshtatshëm për diskutimin e të gjitha çështjeve dhe vendimeve të rëndësishme për Islamin dhe myslimanët.

ASPEKTI SOCIAL I HAXHIT

Haxhi është një prej adhurimeve më të rëndësishme islame, i cili kryhet çdo vit. Ky adhurim bie në muajin e fundit të kalendarit hënor, i njohur si dhulhixheh. Ritualet e haxhit kryhen në shtëpinë e Zotit në Mekë (Qabe) dhe në disa vende përreth saj. Ky adhurim konsiderohet përmbledhës i të gjitha adhurimeve të tjera, sepse përmban një sërë pikëpamjesh rreth adhurimit; prej tyre edhe aspektin social. Ky aspekt është shumë i spikatur në adhurimin e haxhit. Aty, për çdo vit, diku dy milionë njerëz kryejnë haxhin dhe ky adhurim luan rolin e një force bashkuese në Islam, e cila tërheq ndjekës nga kombësi të ndryshme, që të mbledhen së bashku në një ceremoni fetare, ndërsa në Kuran në kontekstin e urdhrit për kryerjen e haxhit Allahu xh.sh. thotë: “Dhe kur shtëpinë (Qabenë) e bëmë vendkthim dhe vend sigurie për njerëzit”.⁶ Fjala “vendkthim – methabeten” është sinonim i fjalës “qendër”, d.m.th. vendi ku mbledhen njerëzit dhe është referencë ku kthehen dhe vendtubim që i mbledh dhe i mbron nga shpërndarja. Njerëzit vijnë për të kryer haxhin nga të gjitha anët e botës dhe nga të gjitha racat, kështu që ju mund të shihni fytyrat e njerëzve kudo në Mekë dhe rrethinat e saj gjatë ditëve të haxhit duke folur në gjuhë të ndryshme, mirëpo mendimi dhe qëllimi i tyre bashkohet pasi të vijnë në Mekë, sepse që të gjithë shkojnë drejt një qëllimi të përbashkët, sa që duket se ekziston një magnet hyjnor i cili tërheq të gjithë në një pikë të përbashkët. Kur këta njerëz i afrohen Qabesë, ata braktisin rrobat e tyre të rëndomta dhe veshin veshjen e haxhit të quajtur “ihram”, e cila përbëhet nga dy rroba të bardha, njërën prej të cilave haxhiu e mbështjell trupin, dhe tjetrën e vendos mbi supet dhe shpinë, dhe kështu vëreni qindra mijëra njerëz në një pozicion dhe rroba të ngjashme. Këta njerëz më në fund tubohen në malin e gjerë të Arafatit pas kryerjes së ritualeve të tjera të haxhit ... sa pamje e mahnitshme është ajo! Duket se të gjitha dallimet midis

Haxhi si adhurim është ngjarja më e madhe sociale e këtij lloji, dhe shembullin e tij nuk do ta gjeni askund tjetër në botë.


njerëzve eliminohen dhe papritur të gjithë njerëzit tretën në përkushtimin ndaj Zotit xh.sh., duke harruar të gjitha dallimet mes tyre. Njerëzit janë unifikuar këtu siç është unik edhe Zotit i tyre. Nëse i shikon haxhitë nga lartësia e një mali, ndërsa ata janë mbledhur në sheshin e madh të Arafatit me rrobat e ihramit, do të shihni se qenia njeri, përkundër dallimit të gjuhës, ngjyrës, pozitës dhe racës, është bashkuar. E vërteta është se haxhi si adhurim është ngjarja më e madhe sociale e këtij lloji, dhe shembullin e tij nuk do ta gjeni askund tjetër në botë.

Qabeja është orientimi i myslimanëve. Myslmanët i drejtohen asaj pesë herë në ditë në namazet e tyre, kështu që orientimet gjatë adhurimit për të gjithë myslimanët janë të njëjta. Ky orientim është një realitet imagjinar në rrethana normale. Mirëpo ky realitet imagjinar bëhet realitet i dukshëm kur arrini në Mekë gjatë ditëve të haxhit dhe kur myslimanët nga e gjithë bota vijnë në të dhe falen duke u drejtuar drejt saj nga çdo drejtim, kështu që ju e shihni në mënyrë të prekshme se orientimi i të gjithë myslimanëve të botës është me të vërtetë një orientim i zakonshëm. Qabeja është një ndërtesë e lartë në formë kubi, dhe njerëzit ecin rreth saj në formë rrethi, ky veprim quhet tavaf, ku ata rreshtohen dhe falen rreth saj në një rreth, ndërsa Qabeja është qendra e të gjitha

drejtimeve të tyre gjatë haxhit, prandaj rituali i haxhit është një adhurim që na jep mësimet sociale me ndjenjat dhe ritualet e tij të ndryshme.

MEKA, QENDRA E UNITETIT ISLAM

Haxhi në realitet është një udhëtim drejt Zotit xh.sh.. Të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të tyre pas vdekjes, por besimtari paraqitet para Zotit të tij para se t'i vijë vdekja. Dalja e njerëzve në përgjithësi para Zotit bëhet në formë të detyrueshme, ndërsa dalja e besimtarit bëhet me përzgjedhjen e tij, dhe kjo është ajo pamja apo panorama të cilën e paraqet tubimi i haxhive nga e tërë bota në mejdanin e Arafatit, ndoshta kjo është arsyeja pse i Dërguari i Zotit a.s. ka thënë: “Haxhi është Arafat”.⁷ Haxhi është një adhurim gjithëpërfshirës, në të cilin Zoti ka vënë shumë dobi të tjera, të drejtpërdrejt ose tërthorazi. Ndër këto dobi është se ky ritual është një mjet i unitetit islam. Qabeja është pika qendrore rreth së cilës bëhet organizimi i adhurimit të besimtarëve në mbarë botën. Ky është namazi social i përvitshëm që falet gjatë haxhit dhe në të marrin pjesë rreth



dy milionë e gjysmë myslimanë nga e gjithë bota, është një ngjarje që mund të shihet dhe fotografohet. Mirëpo ata që drejtohen drejt Kibles në namazin e tyre nuk janë të gjithë ata që shohim në Qabe, ekziston edhe një numër i madh i myslimanëve jashtë Qabesë dhe në çdo vend në faqen e dheut që i drejtohen Qabesë pesë herë në ditë për të falur namazin e tyre dhe ky rreth - të cilin e shohim brenda Qabesë vazhdon të zgjerohet derisa të përfshijë të gjithë globin. Prandaj, nëse imagjini, do të shihni se ajo që ndodh në mënyrë të kufizuar në oborrin e Xhamisë së Shenjtë ndodh çdo ditë në një nivel gjithnjë e më të madh në të gjitha anët e botës. Ky është një aspekt i madh social që është i pashembullt në asnjë grup fetar apo jofetar në botë. Ky është sistemi madhështor që u krijua gjatë mijëra viteve të historisë, dhe sikur myslimanët të kishin një ndjenjë të vërtetë, ata do të merrnin nga haxhi mësimin që synon ky sistem i madh, ku si rezultat do të kishte ndodhur rilindja e vërtetë në jetën e myslimanëve, dhe secili prej tyre do t'i bashkoheshin këtij trupi shoqëror unik. E vërteta është se Qabeja është simbol i njëshmërisë së Zotit në tokë, dhe në të njëjtën kohë është simbol i unitetit dhe socialitetit të myslimanëve. Ndër aspektet e dukshme të këtij sistemi të madh që ushqen unitetin islam në haxh është se ai kërkon që të gjithë të braktisin rrobat e tyre të veçanta dhe të veshin një petk të thjeshtë, kështu që dallimi midis mbretit dhe qytetarit zhduket këtu, gjithashtu edhe dallimet e veshjeve perëndimore dhe atyre lindore zhduken këtu dhe njerëzit shfaqen me veshjet e përbashkëta të ihramit sikur secili prej tyre ka një

pozitë, sepse të gjithë janë robër të Zotit dhe nuk kanë status tjetër përveç atij të robërisë ndaj Zotit xh.sh.. Rituale të planifikuara të haxhit përfundojnë në Meke, por shumica e haxhivë shkojnë në Medinë pas përfundimit të haxhit ose edhe para tij nëse kanë kohë të mjaftueshme. Në qytetin e Medinës gjendet xhamia të cilën e ka ndërtuar i Dërguari i Zotit, Muhamedi a.s., dhe rreth saj janë përhapur gjurmët e jetës së tij. Shkuarja e haxhivë në Medinë – edhe pse nuk është kusht – është një mësim për ta për më shumë unitet islam, sepse ata e kuptojnë në xhaminë e Profetit se prijësi i tyre është një dhe kthehen me ndjenjë se pavarësisht nga dallimet gjeografike dhe kombëtare midis tyre, ata duhet të ndjekin rrugën e të njëjtit Profet, Muhamedit a.s..

Literatura e shfrytëzuar:

- Kurani, përkthim me komentim në gjuhën shqipe, H. Sherif Ahmeti
- Koleksionet e haditheve, versioni elektronik: جامع الكتب التسعة
- Rruga për në Mekë, Muhamed Asad, Logos-A, 2011
- تفسير القرآن العظيم، ابن كثير
- Edukata Islame, revistë
- Dituria Islame, revistë

Fusnotat:

- 1 El Bekare, 125.
- 2 Ali Imran, 96.
- 3 El Maide, 97.
- 4 Ibrahim, 37.
- 5 El Haxh, 27.
- 6 El Bekare, 125.
- 7 Transmeton Imam Nesaiu, nr. 3016 dhe 3044. Imam ibën Maxhe, nr. 3015. Tirmidhiu, nr. 889/890, dhe Imam Ahmedi, nr. 18774.

Madhështia e adhurimit jetësor - haxhit

Isa Tërshani

“Shtëpia (xhamia) e parë e ndërtuar për njerëz, është ajo në Bekë (Mekë), e dobishme, udhërrëfuese për mbarë njerëzimin.” (Ali Imran, 96).

Një ndër shtyllat themelore të Islamit është edhe haxhi. Me shprehjen “El haxhxhu”, në aspektin gjuhësor nënkuptojmë: “vizitë”, kurse në kuptimin terminologjik të Sheriatit, do të thotë: “Vizita e veçantë në vendin e veçantë (Qabe – Arafat) në kohën e veçantë me veprime e nijet të caktuar.” Nga ky përkufizim, kuptohet se haxhi nuk është vetëm udhëtim i thjeshtë, por ai është udhëtim i veçantë, përmes të cilit i bëhet adhurim Allahut xh.sh.. Gjithashtu, gjatë kryerjes së haxhit, duhet patjetër të kryhen detyrimet e caktuara sipas parimeve islame dhe atë në kohën dhe vendin e caktuar.¹

Myslimani përmes namazit, pesë herë në ditë, e drejton fytyrën e vetë kah Qabeja e Madhërueshme në Mekë, ashtu që ai, tërë jetën e vetë e lidh me kiblen, e cila është simboli ibadetit, vendlindja e të Dërguarit Muhamed a.s., dhe xhamia e parë në Tokë, të cilën Allahu e ka bërë vend ku duhet t’i bëhet ibadet Atij. Për këtë çështje, vizita e shtëpisë së Zotit, haxhi, prezanton dëshirën e çdo myslimani, dëshirë e cila vazhdimisht rritet e kurrë nuk zvogëlohet deri sa të realizohet, se ai në haxh sheh dëshminë e tubimit rreth një qëllimi, i cili i bashkon myslimanët anekënd botës. Haxhi, është adhurim që Allahu e bëri obligim një herë në jetë për myslimanët, të cilët i plotësojnë kushtet e parapara. Allahu i Madhërishëm në Kuranin famëlartë ka thënë: “...Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabesë) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi tek ajo.” (Ali Imran, 97).

Po ashtu, edhe i Dërguari i Allahut a.s., në hadithin e gjatë në të cilin iu përgjigj melekut Xhibril a.s., në pyetjet e parashtruara, e konfirmoi se haxhi është një nga shtyllat e Islamit. Muhamedi a.s. tha: “Islami është ngritur mbi pesë shtylla (baza): Dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi a.s. është i dërguar i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, kryerja e haxhit dhe agjërimi i ramazanit.”²

Për haxhin mund të flitet nga shumë aspekte dhe për shumë dimensione të tij, gjegjësisht mund të bëhet përshkrim

Vizita e shtëpisë së Zotit, haxhi, prezanton dëshirën e çdo myslimani, dëshirë e cila vazhdimisht rritet e kurrë nuk zvogëlohet deri sa të realizohet.

i mënyrës së kryerjes së haxhit, mund të shqyrtohen dispozitat juridike të haxhit, për ndjenjat e haxhilerëve, etj..³ Por në këtë shkrim, nuk do të ndalemi në asnjërën nga këto që përmendëm, por do të ndalemi në disa urtësi që përmban haxhi.

HAXHI DHE URTËSITË E TIJ

Haxhi është adhurim (ibadet), i cili ngërthen në vete shumë të mira e urtësi, e sa për ilustrim do t’i përmendim vetëm disa nga ato.

a. Haxhi është shkak, i cili bën shlyerjen e gabimeve dhe mëkateve. Nëse vizita e Qabesë bëhet me nijet të sinqertë dhe me pasuri të fituar nga hallalli është shkak dhe shpresë e madhe për shlyerjen e mëkateve. Ibni Abasi transmeton se kishin qenë me të Dërguarin a.s., ndërkohë që erdhi një grup nga Jemeni dhe thanë: “O i Dërguar i Allahut, na trego për vlerat e haxhit?” Pejgamberi a.s. tha: “Çdo njeri që del nga shtëpia e tij për të kryer haxhin ose umren, sa herë që e ngre dhe e ul këmbën i bien gjynahet nga trupi i tij, ashtu siç bien gjethet e pemës. Kur vjen në Medinë dhe më dërgon salam, edhe melaqet do t’ia kthejnë selamin.

Kur arrin te vendi Dhulhulejfe dhe merr gusël (pastrohet), Allahu do ta pastrojë prej gjynaheve dhe kur vesh rrobat e reja, Allahu do t’ia ripërtërij të mirat e tij. Kur thotë: “T’u përgjigja o Zot t’u përgjigja”, Allahu i thotë: “Unë po të shikoj dhe po t’i dëgjoj fjalët tua.” Kur hyn në Meke e bënë tavafin dhe vrapimin në Safa dhe Merve, Allahu do t’i vazhdojë mirësitë pandërprerë. Kur të qëndrojnë në Arafat e të gumëzhijnë zërat duke i kërkuar Allahut që t’i zgjidhë hallet e tyre, Allahu krenohet para melaqeve të shtatë qiejve duke ju thënë: “O melaqet e Mia që jeni banorët e qiejve të Mi, a nuk i shikoni se robërit e Mi kanë ardhur tek Unë duke iu përgjigjur thirrjes Sime prej distancave të largëta të lodhur e të rraskapitur, kanë shpenzuar pasuritë e tyre, kanë lodhur trupat e tyre. Pasha Madhërinë dhe bujarinë Time, Unë do t’i nxjerr të pastër prej gjynaheve porsi dita kur kanë lindur prej nënave të tyre. Kur të hedhin gurët e të rruajnë kokat dhe të vizitojnë Qabenë, do t’i thërras një thirrës nga Arshi i Allahut: “Kthehuni se jeni të falur dhe filloni të punoni.”⁴ Gjithashtu



Ebu Hurejre r.a., transmeton se i Dërguari a.s. ka thënë: “Shejtani nuk ndjehet asnjë ditë më i pa fuqishëm, më i zemëruar dhe më i poshtëruar se sa në ditën e Arafatit, dhe kjo për arsye se shikon zbritjen e rahmetit dhe faljen e Allahut për gjynahet e njerëzve, dhe nuk është ndërjerë kurrë më parë kështu, përveçse në ditën e Bedrit.”⁵ Po ashtu, Pejgamberi, Muhamedi a.s. ka thënë: “Haxhi i pranuar (mebrur) nuk ka shpërblim tjetër, pos Xhenetit.”⁶

Çështje haxhi mebrur? Ekzistojnë shumë mendime lidhur me atë se cili haxh është mebrur:

Haxhi në të cilin nuk ka mëkate;

Haxhi i cili është i përgatitur;

Haxhi në të cilin nuk ka hipokrizi dhe shtirje;

Haxhi pas të cilit më nuk ka mëkate.⁷

Ebu Hurejra r.a., transmeton se kur është pyetur Muhamedi a.s., se cila është puna më e mirë? Ai është përgjigjur: “Besimi në Allahun xh.sh. dhe të Dërguarin e tij.” I thanë, po tjetër? Ai u përgjigj: “Lufta në rrugën e Allahut.” Po tjetër? Iu përgjigj: “Haxhi mebrur” - tha i Dërguari a.s..⁸

Muslimi në “Sahihun” e tij shënon se, me rastin e dhënies së betimit, i Dërguari i Allahut a.s., i kishte thënë Amr ibën el Asit: “Vallë, nuk e ke ditur që Islami i shlyen atë që ka qenë para tij, sikur hixhreti që shlyen atë që ka ndodhur para saj dhe që haxhi e shlyen atë që ka ngjarë para tij?”⁹

Gjithashtu në një hadith tjetër që e transmeton Ebu Hurejre r.a., Pejgamberi a.s., ka thënë: “Kush e kryen haxhin dhe me këtë rast nuk i cenon dispozitat e Allahut dhe nuk e shqipton asnjë fjalë të papëlqyeshme, do të kthehet i pastër nga mëkatet sikur atë ditë që e ka lindur nëna e tij.”¹⁰ Pastaj hadithi tjetër ku thotë: “I falen mëkatet haxhiut dhe atij për të cilin lutet haxhiu.” Vlen të përmendet se mëkatet të cilat i fshinë haxhi janë mëkatet e vogla, kurse për mëkatet e mëdha doemos duhet penduar sinqerisht tek Allahu xh.sh.. E mëkatet sipas Sheriatit islam ndahen në dy lloje:

- Mëkatet që drejtpërsëdrejti ndërlidhen me Allahun xh.sh., si p.sh.: mos falja e namazit, mos agjërimi etj., dhe
- Mëkatet që ndërlidhen dhe kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me njerëzit.

Sa u përket mëkateve që kanë të bëjnë në relacionin njeri-Allah, ky lloj mëkati është e mundur të falet, pasi që kryerësi i mëkatit të pendohet dhe plotësisht t’i dorëzohet Allahut xh.sh., ngase ato mëkate janë nën mëshirën e Allahut xh.sh., nëse dëshiron i falë, e nëse jo atëherë i dënon ata që kanë bërë mëkate. Kurse mëkatet që ndërlidhen në relacionin njeri-njeri, ato mbeten borxh derisa Allahu xh.sh. t’i tubojë njerëzit pranë Madhërisë së Tij dhe t’i llogarit, ashtu secilit t’ia japë hakun që e meriton. Ky lloj mëkati mund të falet nëse njeriu kërkon falje prej atij që ia ka bërë të padrejtën dhe ai t’ia falë. Personi, i cili i ka borxh dikujt, doemos duhet të kërkojë falje nga ai dhe t’ia falë, e pastaj mund të shkojë në haxh, sepse haxhi nuk e falë mëkatin, të cilin haxhiu ia ka borxh dikujt.

Nga kjo nënkuptohet se haxhi, për ta shlyer mëkatin që ndërlidhet në relacion njeri-njeri, së pari duhet të kërkojë falje nga ai që i është bërë e padrejtë dhe ai t’ia falë (t’ia bëjë hallall), e mandej shpresohet se haxhi do t’ia shlyej mëkatin atij personi.

Në Ditën e Gjykimit, Allahu xh.sh. është e mundur ta falë dikë, por me kusht nëse vëllai i tij t’ia falë mëkatin. Duhet të dihet se një gjë e tillë është nga mirësia dhe butësia e Allahut e jo nga domosdoshmëria për Të.¹¹

b. Haxhi forcon besimin, i hap shtigjet që njeriu të pendohet me një pendim të sinqertë.

c. Haxhi ia mëson njeriut principet e durimit, ashtu që e aftëson atë që të jetë më i durueshëm edhe gjatë problemeve të jetës së tij të përditshme. Pastaj e orienton atë dhe i jep kahje se si duhet të jetë ai i ndërgjegjshëm, i përpiktë në zbatimin e obligimeve gjatë jetës së tij.

ç. Haxhi është adhurim nëpërmes të cilit njeriu e falënderon Allahun xh.sh. për begatitë e dhuruara.

d. Haxhi ia mëson njeriut parimet e edukatës si duhet të jetë i sjellshëm, i moralshëm dhe i edukuar. Haxhiu gjatë kohës së haxhit e ka të ndaluar të ofendojë dhe të flas fjalë të pakuptimta, të këpus bimë, gjethe, të shkatërroj gjelbërimin në atë vend, t’i thyej drunjtë etj..

Përveç dobive fetare, prej haxhit ka edhe dobi të tjera, si: historike, shoqërore, morale, kulturore etj.

DOBITË HISTORIKE TË HAXHIT

Njeriu në haxh viziton vendet e shenjta: Meken, Qabenë e bekuar, Safanë, Merven, Arafatin, Muzdelifen dhe Minanë. Kujton Ibrahimin a.s., babanë e shumë pejgamberëve, i cili erdhi në truallin e Mekës, një vend djerrinë, pa ujë, pa bimë, pa kafshë e njerëz, një vend që mund të quhej i pa jetë. Kur gjendemi në këtë vend, kujtojmë Qabenë e Madhërueshme, banorët e saj, Ibrahimin a.s. dhe të birin Ismailin a.s., dhe nënën e tij, zonjën Haxhere, e cila vraponte nëpër dy kodrinat, Safa dhe Merve, duke kërkuar ujë dhe gjëra të tjera për jetesë.

E në këto rrethana, me urdhrin e Zotit, filloi të shpërthejë uji i famshëm në botë, uji Zemzem.

Kujtojmë këtë vend në të cilin lindi dhe u rrit Muhamedi a.s.. Në këtë vend filloi t'i zbresë Kurani, ku jetoi dhe punoi deri në moshën 53 vjeçare, ku pastaj emigroi prej Mekës në Medinë.

Gjithashtu kujtojmë vendin ku shejtani i mallkuar u mundua ta mashtroi Ibrahimin a.s., që të mos e zbatoi urdhrin e Zotit xh.sh., ta flijoi (kurban) djalin e tij Ismailin a.s.. Dhe në atë çast, Allahu i Madhëruar i dërgoi Ibrahimin a.s., një dash kurban, për ta prerë në vend të djalit të vet të dashur. Në këtë mënyrë, vizita dhe njohja me ato vende madhështore të historisë islame e forcojnë besimin e njeriut.

DOBITË SHOQËRORE

Gjatë këtij udhëtimi të shenjtë, haxhiu i një vendi takohet me një haxhi të vendit tjetër. Në këtë mënyrë njihen dhe lidhin miqësi vëllazërore duke ngrënë e pirë bashkë, duke ecur e duke bërë adhurime bashkë dhe duke u njohur me kulturën e njëri-tjetrit. Udhëtimi e mëson njeriun të jetojë e të hyjë në marrëdhënie shoqërore me të tjerët, d.m.th. të silltet mirë me njerëzit, të ndihmojë të tjerët e të ndihmohet prej tyre, të përkrahë të mirën e të largojë të keqën. Ja sa bukur na udhëzon Kurani për këtë udhëtim: "... nuk bën të merr nëpër këmbë dispozitat e Sheriatit, as nuk duhet shkaktuar grindje..." (El Bekare, 197).

Pra haxhi e forcon jetën shoqërore e bashkëjetesën vëllazërore mes njerëzve. Kjo vërtetohet edhe me ajetin tjetër të Kuranit që thotë: "*S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër...*" (El Huxhurat, 10).

DOBITË MORALE TË HAXHIT

Në haxh çdo vit tubohen miliona njerëz që vijnë nga vende të ndryshme, të largëta e të afërta. Aty takohen njerëz me tipare të ndryshme për nga gjuha që flasin, nga zakonet e shumëllojshme, moshat, temperamentit etj.. Gjatë udhëtimit e qëndrimit në haxh njeriu kënaqet duke zbatuar porositë islame dhe nga mjedisi shoqëror që shquhet nga mirësjellja. Duke vizituar ato vende madhështore, me vlera të mëdha fetare dhe duke u njohur me haxhitë nga vise të ndryshme të botës, njerëzit zhvillohen e përparojnë. Njeriu po ashtu ndien kënaqësi të paparë, meqë gjen mikpritjen bujare të vendasve, prandaj edhe e kryen me kënaqësi të plotë këtë adhurim të madh.

Gjatë qëndrimit në këto vende, njeriu e kupton se në këtë mjedis duhet të silltet në mënyrën më të mirë të mundshme, duke pritur e duruar dhe duke përdorur fjalë të buta dhe të ëmbla me të tjerët.¹²

Gjatë këtij udhëtimi të shenjtë, haxhiu i një vendi takohet me një haxhi të vendit tjetër. Në këtë mënyrë njihen dhe lidhin miqësi vëllazërore duke ngrënë e pirë bashkë, duke ecur e duke bërë adhurime bashkë dhe duke u njohur me kulturën e njëri-tjetrit.

Nga kjo që e përshkruam me pak rreshta për urtësitë dhe dobritë e haxhit, e shumë të tjera mbetën pa u përmendë, pyesim; me çfarë të drejte disa njerëz refuzojnë plotësisht obligimin e haxhit dhe mbajnë qëndrimin se është shumë më mirë dhe më e dobishme, që mjetet materiale për haxh t'i harxhojnë për qëllime të tjera si: të ndërtojnë objekte për të mirën e të tjerëve, të ndihmohen të varfrit etj.. Një gjë duhet ditur, se haxhi është obligim i caktuar prej Allahut xh.sh., për atë të cilin i plotëson kushtet e parapara, e nuk mund të kompensohet me asgjë tjetër.

Ai që e ka obligim haxhin e nuk e kryen, mund të ndërtojë njëqind spitale, shkolla, jetimore etj., këto do të jenë në dobinë e tij pa dyshim, por kurrësi nuk e ka kryer obligimin e haxhit, edhe më tutje e ka borxh këtë obligim islam. Për këtë obligim, te disa, ende mendohet gabimisht, se në haxh duhet të shkohet kur të plakemi (edhe pse viteve të fundit ka filluar të ndryshojë ky mentalitet). Faktet na tregojnë se si pritja dhe shtyrja e kryerjes së haxhit shumë vetë i ka mashtuar, sepse disa kanë vdekur, disa janë sëmurë, e disa janë varfëruar. Abdullah ibën Abasi r.a., transmeton se Muhamedi a.s. ka thënë: "Shpejtoni në kryerjen e obligimit të haxhit, sepse askush prej jush nuk e di se çka mund t'ju pengojë (nesër) të mos e kryeni."¹³

Në fund, e lusim Allahun e Madhërishëm që të na bëjë prej atyre që e kryejnë këtë obligim, kurse ata që nuk kanë mundësi, Allahu ua mundësoftë ta kryejnë këtë ibadet madhështor! Amin!

- 1 Ilmihali i zgjeruar, Tiranë-Prishtinë-Shkup, Dituria Islame, 2018, f. 467.
- 2 Buhari, Sahihu el Buhari, nr. VIII, Kajro, Daru el Gadi el Xhedid, 2013.
- 3 Mr. Bashkim Aliu, "Mozaiku Islam", Shkup, Furkan, 2014, f. 130.
- 4 Saimir Bulku, "Edukimi Shpirtëror", Sira, Prishtinë, 2014, f. 138. (Shënon Ahmedin)
- 5 Bejhëkiu, në "Fedailu el Evkat", 81.
- 6 Muslimi, Sahihu Muslim, (Damask-Siri, Muessesetu er Rrisaletu nashirun, 2013), Sahih, nr. 3289 dhe Buhari, nr. 1773.
- 7 Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, "Fikhu Hanefi" Vëllimi I, ibadat, Prishtinë, 2008, f. 529.
- 8 Muslimi, Sahihu Muslim, (Damask-Siri, Muessesetu er Rrisaletu nashirun, 2013), Sahih, nr. 248 dhe Buhari, nr. 26.
- 9 Muslimi, Kitabu el Iman, nr. 121.
- 10 Buhari, Sahihu el Buhari, (Kajro, Daru el Gadi el Xhedid, 2013), nr. 1521.
- 11 Fahrudin Ebibi, Irfan Abazi, Taxhedin Bislami, Jusuf Zimberi, "Pesë shtyllat e fesë islame" Shkup, 1998, f. 571.
- 12 Vehbi Sulejman Gavoçi, Tiranë, 1999, f. 299.
- 13 Sahih el Xhamiu es sagir ve zijadetu, Muhamed Nasiruddin el Albani v. I. (Fet'hu el Kebir) El Mektebu el Islamij, Botimi i tretë, 1988, Siri, Ibni Maxheh nr. 2957.

Kushtet e obligueshmërisë dhe ato të vlefshmërisë së haxhit

Mr. Fitim Gashi

Për t'u bërë obligim haxhi, personi duhet të jetë mysliman, sepse haxhi është një prej pesë shtyllave të Islamit, për të cilën obligohen vetëm myslimanët.

Haxhi është një obligim i detyruar fetar dhe një ndër pesë shtyllat themelore të Islamit. Obligimi i tij është përcaktuar nga fundi i vitit të nëntë hixhri. Për të, në Kuran thuhet: *"Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabesë) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi tek ajo."* (Ali Imran, 97). Gjithashtu i Dërguari i Allahut a.s., në hadithin e gjatë në të cilin iu përgjigj pyetjeve të parashtruara të melekut Xhibril, konfirmoi se haxhi është një nga pesë shtyllat e Islamit. Muhamedi a.s. ka thënë: *"Islami është ngritur mbi pesë shtylla-baza:... ndër to kryerja e haxhit."* (Buhariu dhe Muslimi).

Kryerja e haxhit është obligim vetëm një herë gjatë jetës, ndërsa kryerja e tij më shumë se një herë është nafile - vepër vullnetare. Muhamedi a.s. ka thënë: *"Haxhi është i obliguar vetëm një herë, ndërsa ai që e kryen disa herë, kjo është nafile."*¹

Pra, haxhi është një obligim individual që duhet të kryhet një herë në jetë, për të gjithë ata persona që kanë përmbushur kushtet e obligueshmërisë, kushte këto që në rast të mos përmbushjes së qoftë dhe vetëm njërit prej tyre, njeriu shkarkohet nga obligimi, dhe haxhi nuk mbetet farz për të.

KUSHTET E OBLIGUESHMËRISË SË HAXHIT

Kushte të cilat në momentin që plotësohen të gjitha bashkërisht te një person, ia bëjnë obligim haxhin janë:

Islami. Për t'u bërë obligim haxhi, personi duhet të jetë mysliman, sepse haxhi është një prej pesë shtyllave të Islamit, për të cilën obligohen vetëm myslimanët. Nga jomuslimani

nuk kërkohet kryerja e haxhit, përveç nëse ai paraprakisht pranon Islamin. Nëse myslimani ka kryer haxhin dikur dhe më pastaj ka braktisur fenë islame, pas pranimit të serishëm të Islamit, sipas hanefitëve, malikitëve dhe një mendimi të hambelitëve, ai përsëri duhet ta kryej haxhin, nëse ekziston mundësia, ngase duke mohuar Islamin, ai i ka shlyer të gjitha veprat e kryera më herët. Ndërsa shafitë dhe mendimi bazë i hambelitëve, mendojnë se personi i tillë nuk është i obliguar ta përsërisë haxhin edhe një herë, dhe se haxhi i tij mbetet i vlefshëm.

Të jetë i shëndoshë mendërisht. Personi duhet të ketë psikikë të shëndoshë, sepse ai që është me të meta mendore nuk e ka obligim kryerjen e haxhit. Mirëpo, nëse personi e kryen haxhin duke qenë i shëndoshë, dhe më pastaj sëmuret mendërisht, haxhi që e ka kryer, konsiderohet i vlefshëm dhe ai nuk është i obliguar për ta kryer sërish, kur të shëndoshet.

Pjekuria. Kjo nënkupton se personi duhet të jetë mbi moshën madhore, moshë kjo që kur personi të hyjë në të, sipas rregullave të Sheriatit obligohet t'i kryejë obligimet e caktuara fetare, rrjedhimisht edhe haxhin. Nëse fëmija e kryen haxhin, haxhi i tij është në rregull, por atij i kërkohet ta bëjë haxhin prej kohës kur hynë në moshën madhore, nëse i plotëson kushtet e parapara, sepse haxhi i bëhet detyrim atij vetëm pasi ta arrijë moshën madhore.

Të jetë i lirë, jo i robëruar. Robi dhe ai që është i zënë peng ose i okupuar nga armiku nuk e ka obligim që të shkoj në Qabe, madje një gjë e tillë në rrethana të tilla as nuk mund të realizohet.

Që ta dijë se haxhi është obligim për t'u kryer. Ky kusht vlen vetëm për personin që jeton në vendet e jobesimtarëve, aty ku informimi për dispozitat e Islamit është më i vështirë. Nëse personin e tillë e njoftojnë dy burra ose një burrë dhe dy gra se kryerja e haxhit është farz, llogaritet se tashmë ai e di obligueshmërinë e haxhit. Ky kusht nuk vlen për atë që jeton në mesin e myslimanëve. Për të, mosnjohja e dispozitave themelore të Islamit nuk mund të përbëjë kurrfarë arsyetimi legjitim që të shkarkohet nga obligueshmëria e haxhit.

Të ketë mundësi. Mundësia këtu nënkupton përfshirjen e tri komponentëve esenciale, pa plotësimin e të cilave njeriu llogaritet se nuk ka mundësi ta kryej haxhin.

a. mundësia fizike – të jetë i shëndoshë fizikisht që të mund t'i përballoj vështirësitë e udhëtimit dhe të ritualeve të haxhit. Nëse njeriu është i sëmurë nga ndonjë sëmundje që ka mundësi të shërohet, atëherë ai pret derisa të shërohet e pastaj e kryen haxhin. Ndërsa, nëse sëmundja është e atij lloji nga e cila nuk pritset shërim, atëherë e dërgon dikë tjetër për ta kryer haxhin për të (bedel).

b. mundësia materiale për udhëtim dhe qëndrim në haxh – me kusht që të mos ketë as borxhe, si dhe mundësia për të lënë pasuri të mjaftueshme për familjarët e vet që i ka lënë në shtëpi nëse ata varen prej tij, duke u siguruar atyre ushqim, vendbanim dhe veshmbathje derisa të kthehet.

Ihrami realizohet me veshjen e atyre dy petkave të bardha, të pa qepura në mes vete, me njërën prej të cilave mbulohet avreti – pjesa nën kërthizë, dhe tjetra hidhet mbi supe te meshkujt.

c. siguria e rrugës për të udhëtuar – të jetë i sigurt dhe mos të ketë frikë për të marrë rrugë, qoftë nga armiku apo nga çfarëdolloj kërcënimi tjetër i mundshëm.

Gruaja të ketë mahrem. Të jetë në shoqërim të bashkëshortit të saj, ose ta përcjellë atë një mashkull i afërm, me të cilin nuk ka të drejtë të martohet në asnjë rrethanë, e nëse as kjo nuk është e mundur, atëherë eventualisht të jetë në shoqërim të grave të ndershme dhe të besueshme.

Mos të jetë në kohën e idetit – pritjes nga shkurorëzimi apo vdekja e burrit.²

KUSHTET E VLEFSHMËRISË SË HAXHIT

Kushtet e vlefshmërisë janë ato të cilat, nëse nuk plotësohen, edhe nëse kryhet haxhi, nuk është i vlefshëm. Pra në mënyrë që haxhi i kryer të jetë i vlefshëm, duhet të plotëson edhe këto kushte:

Hyrja në ihram me nijet të pastër dhe të sinqertë për kryerjen e haxhit. Haxhi është ibadet – adhurim, ndërsa është e qartë dhe dihet mirëfilli se ibadetet nuk mund të pranohen tek Allahu nëse ato nuk bëhen vetëm për hir të Tij. Ihrami në thelb nënkupton nijetin për hyrje apo fillim të ritualit të haxhit i cili shoqërohet edhe me telbijen. Mirëpo ky nijet manifestohet me veshjen e dy petkave të bardha. Ihrami në këtë kuptim (pra të nijetit për haxh) te hanefitët llogaritet si kusht i vlefshmërisë, ndërsa te shumë dijetarë llogaritet si farz – obligim i prerë i haxhit.



Ndërsa vetë petku ose veshja e ihramit, që ishte si manifestim i ihramit konsiderohet si vaxhib i tij. Ihrami realizohet me veshjen e atyre dy petkave të bardha, të pa qepura në mes vete, me njërën prej të cilave mbulohet avreti – pjesa nën kërthizë, dhe tjetra hidhet mbi supe të meshkujt. Ndërsa femrat kryejnë ritualet e haxhit me veshjen e tyre të rëndomtë, sepse për to nuk ka rroba të veçanta të cilat llogariten ihram për to.

Për veshjen e ihramit kemi vend dhe kohë të caktuar. Sa i përket kohës së veshjes së tij, ajo është e njohur qysh nga koha e Ibrahimit dhe Ismailit a.s.. Koha e veshjes së ihramit në fakt fillon dhe mund të realizohet brenda muajve të haxhit e të cilët janë muaji sheval, dhulkade dhe dhjetë ditët e para të muajit dhulhixheh. Këta muaj janë të përmendur në Kuran, ku Allahu i Madhërishëm thotë: *“Haxhi është në muajt e caktuar.”* (El Bekare, 197).

Ndërsa sa u përket vendeve të veshjes së ihramit, po ashtu ato janë të përcaktuara dhe quhen mikate - vendveshje të ihrameve, të cilat haxhiu nuk lejohet t'i tejkalojë pa veshjen e ihramit, pa marrë parasysh a vjen nga toka, deti apo ajri – përmes fluturimeve. Kalimi i atyre pikave pa ihram, dhe moskthimi i serishëm aty, nënkupton obligueshmërinë e therjes së një kurbanit të vogël. Ndërsa banorët e Mekës dhe ata të rrethinës së saj, të cilët jetojnë më afër se sa mikatet, veshjen e ihramave e bëjnë nga shtëpitë e tyre.

Veshja e ihramit në kohë dhe vend të caktuar ka simbolikën e vet dhe bëhet me qëllim që ai i cili ka marrë rrugën për ta kryer haxhin ta ndërrojë gjendjen e tij shpirtërore dhe pamjen e tij fizike, pra të pastrohet nga çdo e keqe dhe ta largojë çdo vepër apo mendim të ligë prej vetes së tij.

Rëndësi të veçantë mikateve – vendveshjeve të ihramave u dha vetë Pejgamberi a.s., i cili i caktoi ato në të gjitha anët e Mekës. Ato janë në distancë të ndryshme nga Meka e shenjtë, varësisht se nga cila anë vjen haxhiu.

Transmetohet nga Ibën Abasi r.a. se ka thënë: “Na i ka caktuar neve i Dërguari i Allahut a.s. të gjitha mikatet – vendveshjet e ihramave, kështu që për banorët e Medinës është Dhul Hulejfe, për banorët e Shamit është El Xhuhfetu, për banorët e Nexhdit është Karnul Menazil, për banorët e Jemenit është Jelemleni, dhe ka thënë: “Këto mikate – vendveshje janë për banorët e këtyre vendeve, e edhe për ata që kalojnë për këto vende prej haxhilerëve të tjerë, prej atyre që dëshirojnë ta kryejnë haxhin ose umren, ndërsa kush banon brenda këtyre vendeve (më afër Mekës), atëherë ai e vesh ihramin nga shtëpia e tij.” (Muslimi).

Personi që ka vendosur për kryerjen e këtij obligimi, duhet t'i nënshtrohet disa rregullave të veçanta, sidomos pas hyrjes së tij në ihram, e që nënkupton fillimin e kryerjes së obligimit të haxhit.

Para se të hyhet në ihram, është e pëlqyer prerja e thonjve, shkurtimi i mustaqeve, prerja e flokëve ose rregullimi i tyre. Pastrimi apo marrja abdes para se të hyhet në ihram është synet i fortë. Gjithashtu është e pëlqyer parfumimi i trupit para ihramit, si dhe është synet falja e dy rekateve namaz (jashtë kohërave në të cilat ndalohet namazi).

Pas hyrjes në ihram, haxhiut i ndalohen disa gjëra siç janë: marrëdhëniet intime dhe çdo veprim tjetër që mund të sjell deri te ky akt, si puthja, ledhatimi, përqaftimi dhe prekja me epsh. Ndalohet nëpërkëmbja e çdo dispozite të Sheriatit si dhe grindja me njerëz. Allahu i Lartësuar thotë: “Haxhi është në muajt e caktuar e kush bën (ia fillon të zbatojë) haxhin në këta muaj, nuk duhet afuar gruas, nuk bën të merr nëpër këmbë dispozitat e Sheriatit, as nuk duhet shkaktuar grindje.” (El Bekare, 197). Ndalohet gjuetia tokësore. Në Kuran thuhet: “Kurse gjahu tokësor u është ndaluar sa të jeni në ihram” (El Maide, 96). Gjithashtu ndalohet këputja ose prerja e bimëve, barit, ose pemëve që kanë mbirë vetvetiu në territorin e Haremit të Qabesë (ndërsa ato që i ka mbjellë njeriu lejohet edhe të prehen). Ndalohet përdorimi i parfumit në rroba ose trup, sikurse që ndalohet edhe prerja e thonjve. Mashkullit i ndalohet të vesh diç që është e qepur, si këmbishë etj.. Ndalohet mbulimi i kokës dhe i fytyrës me çfarëdo petku. Ndalohet qethja ose rruajtja e flokëve, ose e çdo qimeje të trupit, si dhe lyerja e flokëve ose trupit me yndyra që përmbajnë erë parfumi.³

Që haxhi të kryhet në kohën e vet dhe në vendet e veta të caktuara. Haxhi duhet të kryhet dhe është i pranuar vetëm nëse kryhet në muajt dhe ditët e caktuara, ashtu siç ka thënë Allahu i Madhërishëm: *“Haxhi është në muajt e caktuar.”* (El Bekare, 197).

Po ashtu ai pranohet që të kryhet vetëm në vendet e caktuara (Qabe, Arafat, Muzdelife, Mine), në të cilat realizohen ritualet e haxhit.

Personat që i plotësojnë këto kushte obligohen me kryerjen e haxhit po atë vit që i kanë plotësuar ato, dhe shtyrja e haxhit për vitin tjetër pas plotësimit të kushteve të obligueshmërisë është mëkat tek Allahu.

Allahu ua mundësoftë dhe ua lehtësoftë vizitën e vendeve të shenjta çdo myslimani e myslimaneje! Amin!

1 Shih kaptinën e haxhit në Sahihun e Muslimit.

2 Shih: El Fikh el Islami ve ediletuhu, prof. dr. Vehbet ez Zuhejli, fq. 2076-2084, bot. 4, 2002, Darul Fikr, Dimeshk, dhe Kitabul Fikh al el medhahib el erbeatu, Abdurrahman bin Muhamed el Xheziri, fq. 377-378. bot. 1, 2001, Dar ibën Hazem, Bejrut.

3 Kitabul Fikh al el medhahib el erbeatu, Abdurrahman bin Muhamed el Xheziri, fq. 360-362.

Farzet dhe vaxhibet e haxhit

Mr. Zenel Hajdini

Haxhi është një ndër shtyllat kryesore të fesë islame, i cili ngërthen në vete vlera të shumta jo vetëm në aspektin religjioz, por edhe në atë shoqëror e njerëzor. Kjo pasi që ai është manifestim i vlerave të brendshme të besimtarit që tregon lidhjen e fuqishme që ka me Krijuesin e tij, por dhe manifestim i vlerave të jashtme që tregon formësimin e personalitetit të tij dhe moralin e tij të lartë në fjalë e veprë. Dhe ky mesazh është i qartë në fjalën hyjnore, ku Zoti thotë: “...ai që e obligon veten të kryejë haxhin, nuk duhet të ketë marrëdhënie me gruan e tij dhe as nuk duhet të bëjë grindje e sharje (me të tjerët)...” (El Bekare, 197).

Pra, prirja për grindje dhe sharje janë prej sinjaleve të nivelit të ulët të moralit, si dhe një gjuhë e cila bie në kundërshtim me parimet dhe vlerat e haxhit. Pikërisht për këtë, i Dërguari i Zotit a.s. tha: “Ai që e kryen haxhin, duke mos bërë veprime epshore apo mëkate, kthehet prej tij (i pastruar prej mëkateve) si në atë ditë që e lindi nëna e tij.”

Prandaj, rituali i cili nuk paraprihet me vepra të mira dhe nuk reflekton në jetën dhe karakterin e besimtarit pas përfundimit të tij, vihet në pikëpyetje pranueshmëria e tij te Zoti i gjithësisë, ngase shpërblimi i këtij rituali dhe pranueshmëria e tij, ndërlidhen pikërisht me formën e përmbushjes dhe plotësimit të tij.

Kjo edhe është arsyeja që çdo adhurim në Islam ka parakushte të cilave nëse nuk u përmbahemi, e bëjnë të pavlefshëm edhe vetë adhurimin. Ashtu siç ka thënë Pejgamberi a.s.: “Zoti nuk pranon namazin pa abdes, e as lëmshën nga grabitja.” Andaj, si çdo adhurim tjetër, edhe haxhi ka shtyllat (farzet) e tij, të cilat po që se nuk plotësohen, nuk është i vlefshëm haxhi. Farzet e haxhit janë:

1. Nijeti (ihrami) – Me fjalën “ihram” kuptojmë nijetin e myslimanit për të kryer ritualet e haxhit apo umres, i cili

Si çdo adhurim tjetër, edhe haxhi ka shtyllat (farzet) e tij, të cilat po që se nuk plotësohen, nuk është i vlefshëm haxhi.

shoqërohet edhe me telbijjen. Shumë prej juristëve hanefitë, ihramin në kuptim të nijetit e konsiderojnë si kusht të vlefshmërisë së haxhit, duke u nisur nga hadithi i Pejgamberit a.s., në të cilin thuhet: “Vërtet veprat shpërblehen sipas qëllimeve- nijeteve”. (Buhariu, 1. Muslimi, 1907).¹

Ndërsa disa juristë të tjerë atë e llogarisin edhe si rukn – farz e pjesë përbërëse e patjetërsueshme të haxhit. Efekti i kësaj divergjence pothuajse nuk vërehet fare. Po ashtu, ihram quhet edhe rroba e bardhë, e cila në fakt e manifeston nijetin e brendshëm, e që përbëhet prej dy pjesëve. Ai vishet në kohë dhe vend të caktuar. Kjo është sa u përket burrave, ndërsa për femrat, nuk ka rrobë të caktuar, por ato i kryejnë ritualet e haxhit apo umres me rrobat e tyre të përditshme.

Pas veshjes së ihramit, haxhiut i ndalohen këto veprime:²

- Prerja e thonjve dhe shkulja e qimeve, si dhe qethja ose rruajtja e flokëve;
- Parfumosja e trupit, si dhe parfumosja e ngjyrosja e ihramit;
- Gjuetia;
- Mbulimi i fytyrës dhe duarve të femrës;
- Mbulimi i kokës;
- Veshja e rrobave të zakonshme, mashkullit i ndalohet gjithashtu të vesh rroba që janë të qepura;
- Marrëdhëniet intime.


Qëndrimi në Arafat. – është një ndër shtyllat kryesore të haxhit. Me këtë nënkuptojmë qëndrimin në Arafat qoftë edhe për pak çaste. Arafati është vendi, në të cilin është kusht të qëndrohet, dhe se pa të nuk mund të realizohet haxhi. Për këtë e kemi argument fjalën e Pejgamberit a.s., në të cilën na thotë: “Haxhi është Arafat”. (Ebu Davud, 1949, Ibën Maxheh, 3015, Tirmidhiu, 889).³ Ndërsa të qëndruarit në Arafat deri

në perëndim të diellit të asaj dite llogaritet vaxhib e jo farz i haxhit. Në hadithin që është transmetuar për Haxhin Lamtumirës, qëndron se Pejgamberi a.s., ka qëndruar në Arafat deri pas perëndimit të diellit.

Koha e mundshme e qëndrimit qoftë për pak qaste në Arafat (për ta kryer farzin e haxhit) fillon pas kalimit të diellit nga zeniti i ditës së 9-të dhe vazhdon deri në agimin e ditës së 10-të të muajit dhulhixhe.⁴ Për këtë, i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Kush vjen në Arafat natën e Kurban Bajramit dhe para se të lindë agimi, ai e ka arritur haxhin.” (Ebu Davud, 1949, Ibën Maxheh, 3015, Tirmidhiu, 889).⁵

Është prej traditës së Pejgamberit a.s. që gjatë qëndrimit në Arafat haxhiu të qëndrojë me abdes gjatë gjithë kohës; të mos agjërojë; të drejtohet nga Kibla; t'i ngrit duart lart dhe të kërkojë nga Allahu për çdo gjë nevojë të tijën; të falënderojë, madhërojë e lartësojë Allahun; të lexojë sa më shumë Kuran; të mos fjaloset me njerëzit etj.

3. Tavafi ifadas (i vizitës) – Me tavaf kuptojmë rrotullimin rreth Shtëpisë së Shenjtë, Qabesë, i cili përbëhet nga shtatë rrotullime. Tavafi është një adhuring i veçantë që i bëhet Allahut duke u sjellë rreth Qabesë. Tavafi ifadas, është shtylla e dytë kryesore e haxhit, dhe kryhet në ditët e teshrikut, por më mirë është të kryhet në ditën e parë.⁶ Në lidhje me këtë, Allahu xh.sh., në Kuran na thotë: “Mandej, kthehuni, siç kthehen të gjithë të tjerët.” (El Bekare, 199); dhe në ajetin tjetër: “Pastaj, haxhitë le të pastrojnë trupin e tyre, le t'i kryejnë zotimet e tyre dhe le t'i vijin rrotull Shtëpisë së lashtë.” (El Haxh, 29).



Transmeton Nafiu nga Ibën Umeri se Pejgamberi a.s., e ka bërë tavafin ifada në ditën e parë të Bajramit, pastaj është kthyer dhe e ka falur namazin e drekës në Mine.⁷ (Muslimi, 1308).

VAXHIBET E HAXHIT

Veprimet vaxhib gjatë kryerjes së haxhit janë:

Dallimi në mes të farzeve të haxhit dhe vaxhibeve të tij është se moskryerja e farzeve nënkupton mospranim të haxhit, ndërsa moskryerja e vaxhibeve nënkupton obligimin e shpagimit më therje të kurbanit, por jo edhe mospranim të haxhit në tërësi. Vaxhibet e haxhit janë:

1. Saji (ecja) në mes Safasë dhe Mervas: Në medhhebin hanefi, saji konsiderohet nga veprimet vaxhibe të haxhit. Andaj, ai i cili nuk e kryen këtë veprim llogaritet mëkatat dhe ai për ta fshirë këtë mëkat duhet therur një kurban. Për këtë janë argumentuar në transmetimin e Urve Taiu r.a., i cili tregon: “E gjeta të Dërguarin e Allahut a.s., në Muzdelife e i thashë: “O i Dërguari i Allahut! Kam ardhur nga mali i Taiut. Kam therur devenë dhe e kam ngrënë atë. Jam tepër i lodhur! O i Dërguari i Allahut! Të betohem në Allahun, se kam ndaluar në çdo mal. A e kam marrë shpërblimin e haxhit?” i Dërguari i Allahut a.s., m'u përgjigj: “Kush e fal namazin me ne, qëndron këtu ku jemi dhe ka qëndruar në Arafat natën apo ditën, ai e ka kryer si duhet haxhin dhe e ka realizuar atë që ka pasur për qëllim.” (Ebu Davud, 1950, Ibën Maxheh, 3016, Tirmidhiu, 891).⁸

Ndërsa, pjesa më e madhe e dijetarëve e konsiderojnë sajnin shtyllë të haxhit, duke e argumentuar atë në fjalën e Pejgamberit a.s.: “Bëjeni sajnin sepse Allahu ua ka bërë detyrë atë.” (Imam Ahmed, 27463).⁹ Po ashtu, transmetohet nga Aisheja r.a., se ka thënë: “I Dërguari i Allahut a.s., dhe myslimanët kanë bërë sajnin duke e bërë këtë veprim traditë të vazhdueshme. Betohem në Allahun, se nuk është plotësuar haxhi nëse nuk bëhet saji mes Safasë dhe Mervas.” (Buhari, 1643, Muslimi, 1277).¹⁰

Kushtet për vlefshmërinë e sajnit në mes Safasë dhe Mervas janë:

- Saji duhet të bëhet pas tavafit;
- Saji të bëhet me shtatë ecje nga Safaja te Merveja (një ecje) dhe anasjelltas (e dyta);
- Të fillohet në Safa dhe të mbarojë në Merva.

Këto kushte janë marrë nga Haxhi Lamtumirës i Pejgamberit a.s., kur edhe ka thënë: “Mësojini nga unë ritet e haxhit.” (Muslimi, 1297).¹¹

Transmetohet se kur Pejgamberi a.s., mbaroi tavafin, u nis për në vendin ku bëhet saji, duke lexuar fjalën e Allahut: “Kodrinat Safa dhe Merva (në Mekë) janë pjesë të ritualeve (të adhuringut të bëhet për hir) të Allahut.” (ElBekare, 158) dhe më pas tha: “Po e filloj me atë që ka filluar Allahu”. Ai u

ngjit mbi kodër dhe sapo e pa Shtëpinë e Shenjtë, u kthye drejt Kibles dhe filloi të lartësojë e madhërojë Allahun. Më pas u nis për në Merva dhe kur arriti atje, bëri po ato veprime që bëri në Safa.” (Muslimi, 1218).¹²

2. Qëndrimi natën në Muzdelife – Në lidhje me këtë, Allahu në Kuran thotë: “E, kur të ktheheni nga Arafati, përmendni Allahun në vendet e shenjta.” (El Bekare, 198). Transmetohet se Pejgamberi a.s. ka qëndruar në Muzdelife deri në mëngjesin e ditës së Kurban Bajramit, më pas e ka falur namazin e sabahut dhe është nisur për në Mina, para se të lindte dielli. Mirëpo, lejohet që çdo person i sëmure apo i moshuar, të largohet nga Muzdelifeja pas mesnate. Për këtë tregon Ibën Umeri r.a., se Pejgamberi a.s., ua ka lejuar atyre që janë të dobët, që të largohen nga Muzdelifeja pas mesnate. (Buhari, 1676, Muslimi, 1295).¹³

Madje edhe në të kaluarën edhe sot, shumë nga dijetarët islamë tolerojnë largimin nga aty edhe për njerëzit e tjerë pas gjysmës së natës për shkak të numrit të madhe të haxhilerëve dhe turmave të mëdha të grumbullimit të njerëzve gjithandej nëpër vendet e kryerjes së ritualeve, e jo vetëm për ata që kanë arsye.

3. Gjuajtja e guralecëve – Nga veprimet e tjera të haxhiut është edhe gjuajtja e guralecëve në ditën e Kurban Bajramit dhe në tri ditët e teshrikut. Vendet ku gjuhen guralecët quhen xhemerate: El Akabe, Es Sugra dhe El Vusta. Në ditën e parë të Kurban Bajramit, gjuhen shtatë guralecë të Xhemeratul Kubra. Ndërsa në ditën e dytë dhe të tretë gjuhen nga shtatë guralecë të secila nga xhemeratet. Në ditën e parë është e preferuar që të gjuhen guralecët pas lindjes së diellit e deri në kohën e namazit të drekës. Ndërsa, në dy ditët në vijim, është e preferuar pas namazit të drekës e deri në perëndimin e diellit. Gjithashtu, nëse haxhiu është i sëmure dhe nuk ka mundësi t'i gjuaj vetë guralecët, mund që ta autorizojë dikë që t'ia gjuaj guralecët në ditën e dytë dhe të tretë të teshrikut.

4. Rruajtja dhe shkurtimi i flokëve – Nga vaxhibet e haxhit është edhe rruajtja apo shkurtimi i flokëve. Duhet ditur se ky veprim është adhurim si dhe konsiderohet çelës për lirimin e haxhiut nga ihrami. Në lidhje me këtë, Allahu në Kuran thotë: *“Allahu e përmbushi me të vërtetë ëndrrën e të Dërguarit të Tij, i cili kishte thënë: Me siguri, ju do të hyni në Xhaminë e Shenjtë, dashtë Allahu, të sigurt, kokërruar dhe flokëshkurtër, pa kurrfarë frike. Ai e dinte atë që ju nuk e dinit dhe veç kësaj, ju dhuroi një fitore të afërt.”* (Fet'h, 27).

Sipas transmetimeve nga Pejgamberi a.s., më e preferuar është të rruhen flokët, sepse Pejgamberi a.s., është lutur tri herë për ata që i rruajnë flokët dhe vetëm njëherë për ata që i shkurtajnë. Tregon Ebu Hurejra r.a., se Pejgamberi a.s. ka thënë: “O Allah! Fali ata që i rruajnë flokët!”. Të pranishmit thanë: “O i Dërguar i Allahut! Allahu i faltë edhe ata që i shkurtajnë flokët.” Ai a.s. tha: “O Allah! Fali ata që rruajnë

flokët!”. Të pranishmit thanë përsëri: “O i Dërguar i Allahut! Allahu i faltë edhe ata që i shkurtajnë flokët”. Ai a.s. tha: “O Allah! Fali ata që shkurtajnë flokët!” (Buhari, 1727, Muslimi, 1306).¹⁴ Ndërsa, koha e rruajtjes së flokëve ose shkurtimit të tyre është pas gjuajtjes së guralecëve dhe vazhdon gjatë ditëve të teshrikut. Dhe nëse haxhiu e vonon prerjen e flokëve apo rruajtjen e tyre, obligohet me prerjen e një kurbanit.

5. Tavafi lamtumirës – Nga vaxhibet e haxhit është edhe tavafi lamtumirës, dhe nëse ky tavaf nuk kryhet, atëherë haxhiu obligohet me prerjen e kurbanit. Për këtë Pejgamberi a.s. ka thënë: “Askush të mos largohet nga Meka, pa u takuar me Shtëpinë e Shenjtë (pa bërë tavafin) dhe kjo të jetë gjëja e fundit që bën (në Meke).” (Muslimi, 1327).¹⁵

6. Therja e kurbanit – Kjo është vaxhib vetëm për ata haxhilerë të cilët e kryejnë njërin nga llojet e haxhit, kiran dhe temettu. Ndërsa sot, meqë haxhilerët e Kosovës rëndom e kryejnë haxhin temettu, këtë kurban e merr përsipër ta bëjë therjen e tij organizatori i haxhit, d.m.th. Bashkësia Islame e Kosovës.

E lusim Allahun që të pranojë haxhin prej të gjithë atyre që kanë mësyre këtë rrugë! Amin!

1 Muhamed Ismail el Buhari, “Sahihu El Buhari”, (Rijad, Arabia Saudite, 2000), v.1, f. 12, Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, Sahihu Muslim, (Bejrut, Lubnan), v. 3, f. 1515.

2 Abdullah el Musili, “El Ikhtijar lilealil Mukhtar”, (Dar er Risaleh el Ilmije, Siri, 2010), v. 1, f. 449.

3 Ebu Davudi, Sunen Ebu Davud, (Dar er Risale el Ilmije, Siri, 2009), v. 3, f. 322. Ebu Abdullah Ibën Maxheh, Sunen Ibën Maxheh, (Dar er Risale el Ilmije, Siri, 2009), v. 4, f. 218. Muhamed bin Isa et Tirmidhiu, Sunen Et Tirmidhiu, (Darul Garb, Bejrut, Lubnan, 1998), v. 2, f. 229.

4 Abdullah el Musili, “El Ikhtijar lilealil Mukhtar”, (Dar er Risaleh el Ilmije, Siri, 2010), v. 1, f. 469.

5 Ebu Davudi, Sunen Ebu Davud, (Dar er Risale el Ilmije, Siri, 2009), v. 3, f. 322. Ebu Abdullah Ibën Maxheh, Sunen Ibën Maxheh, (Dar er Risale el Ilmije, Siri, 2009), v. 4, f. 218. Muhamed bin Isa et Tirmidhiu, Sunen Et Tirmidhiu, (Darul Garb, Bejrut, Lubnan, 1998), v. 3, f. 229.

6 Abdullah el Musili, “El Ikhtijar lilealil Mukhtar”, (Dar Er Risaleh El Ilmije, Siri, 2010), v. 1, f. 480.

7 Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, “Sahihu Muslim”, (Bejrut, Lubnan), v. 2, f. 950.

8 Ebu Davudi, Sunen Ebu Davud, (Dar er Risale el Ilmije, Siri, 2009), v. 3, f. 322. Ebu Abdullah Ibën Maxheh, Sunen Ibën Maxheh, (Dar er Risale el Ilmije, Siri, 2009), v. 4, f. 219. Muhamed bin Isa et Tirmidhiu, Sunen Et Tirmidhiu, (Darul Garb, Bejrut, Lubnan, 1998), v. 3, f. 229.

9 Ahmed bin Hanbel esh Shejbanij, Musned Imam Ahmed, (Mueseseh er Risaleh, Lubnan, 2001) v. 45, f. 455.

10 Muhamed Ismail el Buhari, Sahihu el Buhari, (Rijad, Arabia Saudite, 2000), v. 2, f. 157. Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, Sahihu Muslim, (Bejrut, Lubnan), v. 2, f. 929.

11 Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, Sahihu Muslim, (Bejrut, Lubnan), v. 2, f. 943.

12 Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, Sahihu Muslim, (Bejrut, Lubnan), v. 2, f. 886.

13 Muhamed Ismail el Buhari, Sahihu el Buhari, (Rijad, Arabia Saudite, 2000), v2, f165. Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, Sahihu Muslim, (Bejrut, Lubnan), v. 2, f. 941.

14 Muhamed Ismail El Buhari, Sahihu El Buhari, (Rijad, Arabia Saudite, 2000), v2, f174. Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, Sahihu Muslim, (Bejrut, Lubnan), v. 2, f. 946.

15 Muslim el Haxhaxh en Nisaburij, Sahihu Muslim, (Bejrut, Lubnan), v. 2, f. 963.

Gruaja në haxh

DOSPOZITAT SPECIFIKE TË HAXHIT QË KANË TË BËJNË ME GRUAN

Dr. Ilmije Kuqi

Ky punim kufizohet vetëm me dispozitat që kanë të bëjnë me gruan, si: hyrja në ihram, tavafi, saji, qëndrimi në Arafat, qëndrimi në Muzdelife, gjuajtja e gurëve në xhemarate dhe qëndrimi në Mina.

Haxhi është vizita e Shtëpisë së Shenjtë të Zotit, në Mekë, me qëllimin e kryerjes së veprimeve të caktuara, në një kohë të caktuar. Ai është një nga pesë shtyllat mbi të cilat është ndërtuar Islami dhe është farz ajn, obligim të bëhet një herë në jetë, për atë që i ka mundësitë. Ky punim kufizohet vetëm me dispozitat që kanë të bëjnë me gruan, si: hyrja në ihram, tavafi, saji, qëndrimi në Arafat, qëndrimi në Muzdelife, gjuajtja e gurëve në xhemarate dhe qëndrimi në Mina. Në vijim, në pika të shkurtra, do të flasim për dispozitat me të rëndësishme të secilës prej këtyre.

HYRJA NË IHRAM

Rekomandohet që ata që duan të hyjnë në ihram për haxh, të përgatiten për të para se të hyjnë në të. Para hyrjes në ihram, qoftë për haxh apo umre, më parë, rekomandohet prerja e thonjve të duarve dhe të këmbëve, heqja e qimeve nga vendet e turpshme dhe nënsqetullave, pastrimi i dhëmbëve dhe krehja e flokëve. Në të gjitha këto çështje, si gruaja ashtu edhe burri janë të njëjtë në dispozita.

Rekomandohet që gruaja, kur dëshiron të falë dy rekatet e ihramit, të pastrohet – të marrë gusël nëse kjo është e mundur, e nëse është e pamundur larja, atëherë ajo merr abdes. Me gusël apo abdes bëhet nijet ihrami. Kjo larje ose abdes është mustehab edhe për femrën me cikël menstrual dhe gruan lehonë.¹

Pas larjes, gruaja vesh rrobat e saj të zakonshme, këpucë dhe çorapë, ngase asaj i ndalohet veshja e ihramit – petkut ekskluziv të meshkujve, si dhe parfumon trupin dhe rrobat e saj. Është mustehab të qenët me misk. Nuk është e dëmshme mbetja e gjurmëve të

parfumit, por mos mbetja e gjurmëve të tij është më mirë.² Ndërsa pas hyrjes në ihram, asaj nuk i lejohet përdorimi i parfumimit, prerja e thonjve të duarve dhe të këmbëve, si dhe heqja e qimeve nga vendet e turpshme dhe nënsqetullave.

Mandej gruaja, me përjashtim të asaj me cikël menstrual dhe lehonë, falë dy rekate namaz sunet të ihramit. Këto dy rekate nuk falen në kohë të ndaluar dhe pranohen me namazin e asaj kohe.³ Por, nëse hyhet në ihram pa këto dy rekate, ihrami konsiderohet në rregull, por është mekruh.

Në momentin kur nijeti, bëhet me zemër dhe deklarohet edhe me gojë:

اللَّهُمَّ إِنِّي أُرِيدُ الْحَجَّ فَيَسِّرْهُ لِي وَتَقَبَّلْهُ مِنِّي، نَوَيْتُ الْحَجَّ وَأَحْرَمْتُ بِهِ لِلَّهِ تَعَالَى.

“O Zot, dëshiroj ta kryej haxhin, andaj ma lehtëso këtë dhe pranoje nga unë! Vendosa ta kryej haxhin dhe hyra në ihram për Allahun e Plotfuqishëm!”

Pas kësaj thuhet telbija duke mos e ngritur zërin gjatë telbijes.

«لَبَّيْكَ اللَّهُمَّ لَبَّيْكَ، لَبَّيْكَ لَا شَرِيكَ لَكَ
لَبَّيْكَ، إِنَّ الْحَمْدَ وَالنَّعْمَةَ لَكَ وَالْمُلْكَ، لَا شَرِيكَ لَكَ».

“Të përgjigjem o Zot, të përgjigjem, të përgjigjem! Ti je i pa shoq. Të përgjigjem. Ty të takon çdo lavdërim, begati dhe pushtet, Ti nuk ke shok.”

Pas telbijes, i dërgohet salavat të Dërguarit të Allahut a.s., pastaj personi lutet për çfarë të dëshirojë.

HYRJA NË MEKË DHE NË SHTËPINË E SHENJTË

Pas hyrjes në ihram shkohet në Mekë. Atje është mustehab të pastrohet - të marrë gusël nëse është e mundur, por nëse jo, atëherë lahet para këtij vendi. Larja është mustehab edhe për femrën me cikël menstrual dhe atë lehonë.

Kur gruaja e sheh Mekën, lutet dhe e thotë telbijen më zë të ultë derisa të arrijë në portën Es Selam, ani pse, për gruan vonimi i tavafit deri në mbrëmje është mustehab.

Kur gruaja ta shoh Qabenë thotë tri tekbire dhe thotë tri herë: “La ilahe il-lallah”, pastaj i dërgon salavat Pejgamberit a.s. dhe bën dua për çka të dëshirojë. Duart nuk ngritën kur të shihet Qabeja dhe as gjatë bërjes së duave.

Pas kësaj shkohet në anën e Qabesë ku ndodhet Haxherul Esvedi (guri i zi), dhe e bën tavaful kudumin. Ajo e bën tavafin dhe nuk fal namaz te hijetut mesxhid, sepse te hijetut mesxhidi i saj është tavafi rreth Qabesë. Po ashtu, ajo nuk falë diçka tjetër, pos nëse i ka kaluar ndonjë namaz ose ekziston frika se për shkak të kryerjes së tavafit i kalon namazi i kohës, sunetet e konfirmuara, namazi me xhemat ose xhenazja. Në këto raste, së pari duhet kryer namazin, pastaj tavafin.⁴

Nëse kur arrihet në Mekë, gruaja është me cikël menstrual apo i shfaqet cikli pasi që të arrijë në të, ajo duhet të qëndrojë në vendbanimin e saj derisa ta përfundojë ciklin menstrual, e mandej ta bë tavaful kudumin dhe sajën ndërmjet Safasë dhe Merves.

BËRJA E TAVAFIT

Gruaja, duke qenë e mbuluar me përjashtim të fytyrës dhe duarve, si dhe e pastër me gusël apo abdes, fillon tavafin rreth Qabesë nga Haxherul Esvedi, në mënyrë që Qabeja të jetë nga ana e majtë e saj. Pastaj, kalon afër Haxherul Esvedit, ngrit duart paralel me supet apo veshët, me brendësinë e shuplakave të duarve të kthyer nga Haxherul Esvedi, pastaj e prek atë, në qoftë se nuk ka turmë nga burrat. Përndryshe nëse ka turmë, atëherë gruaja e bën tavafin larg Qabesë dhe vetëm ndalet dhe kthehet me fytyrë në drejtim të gurit të zi, me duar të ngritura paralel me veshët, të kthyer me brendësinë e shuplakave kah ai, duke thënë: “Ne emër të Allahut, Allahu është më i Madhi dhe Allahut i takon lavdërimi, lutjet dhe përshëndetjet qofshin mbi të Dërguarin e Allahut. O Zoti im, duke të besuar Ty, duke kryer obligimin Tënd, dhe duke e pasuar synetin e të Dërguarit Tënd, Muhamedit a.s.” Pastaj i puthë shuplakat e veta.

Është sunet që sa herë që kalohet pranë gurit të zi, të veprohet si në herën e parë, nëse kjo është e mundur. Mirëpo, në qoftë se herën e parë dhe të fundit veprohet siç e cekëm më lartë, kjo mjafton. Në çdo rreth, me dorën e djathtë preket



këndi i Jemenit, por pa u puthur. Mirëpo, nëse nuk është e mundur të prekët për shkak të turmës, atëherë vetëm sinjalizohet në drejtim të tij.

Gruaja e kryen tavafin pa rremel (pa shpejtim në të ecur me shkundje supesh), pa idtiba' (pa zbulim të krahëve).

Gjatë tavafit falënderohet Allahu, bëhet dua dhe i dërgohet salavat Pejgamberit a.s. dhe thuhet: Subhanallah, vel-hamdulillah, ve la ilahe il-lallah, vAllahu ekber, ve la havle ve la kuvvete il-la bil-lah.

Nëse gruaja është duke e bërë vetëm haxhin, ky tavaf i numërohet si tavaful kudum. Nëse është duke e kryer vetëm umren apo është ka'rin apo mutemetti, i numërohet tavaf i umres, pavarësisht se a është bërë nijet për të apo jo, kështu që ka'ri duhet ta bëjë një tavaf tjetër si tavaful kudum pasi ta ketë bërë sajën e umres.

Pastaj, nëse ekziston mundësia, falen dy rekate prapa Mekami Ibrahimit. Nëse nuk mund të falen aty, atëherë do të falen në cilindo vend tjetër, dhe pas atyre dy rekateve shkohet te Zemzemi për të pirë ujë, e më pas dilet nga dera e Safasë për të shkuar në kodrën e Safasë për saj.⁵

BËRJA E SAJIT NDËRMJET SAFASË DHE MERVES

Pas lirimit nga tavafi, është sunet të bëhet menjëherë saji. Për kryerjen e sajit nuk kushtëzohet pastërtia, që do thotë se saji i gruas me cikël menstrual dhe lehonë është i drejtë dhe i ligjshëm. Para se të arrihet në Safa, është mustehab të lexohet ajeti 158 nga kaptina El Bekare.

Gruaja, sikur edhe burri, edhe kur të gjendet te Safaja edhe kur gjendet te Merveja, është e referuar të bëjë dua-lutje. Kur ajo është te Safaja, bën lutje duke u kthyer me fytyrë kah Qabeja, e falënderon Allahun e Plotfuqishëm dhe e lavdëron Atë, merr tekbire dhe e përsërit dhikrin me tekbire nga tri herë dhe thotë La ilahe il-lallah, dërgon salavat Pejgamberit a.s., pastaj lutet për myslimanët dhe për vete për çfarë të dëshirojë. Mandej, niset drejt Merves duke ecur me ecje normale, duke bërë dhikër dhe duke u lutur.

Gruaja nuk vrapon kur të arrihet te shtylla e gjelbër, ngase kjo është specifike për burrat. Kur të arrijë në Merve, ajo vepron njëjtë si në Safa, siç është kthimi me fytyrë nga Qabeja, marrja e tekbirit, bërja dhikër dhe dua. Kështu duhet bërë shtatë rrathë. Ajo fillon nga Safaja dhe përfundon në Merve. Kjo ecje prej Safasë deri në Merve është një rreth, ndërsa kthimi prej Merves deri në Safa është rrethi i dytë.

Pas përfundimit të sajit, është mustehab të falen dy rekate namaz, në Mesxhidul Haram dhe nuk falen në Merve.⁶

QËNDRIMI NË ARAFAT

Gjatë rrugës për në Arafat thuhet telbija, tekbiri, duatë dhe salavatet. Kur personi të gjendet përballë malit Xhebelurr Rrahmeh, i cili ndodhet në Arafat, bën dua dhe kërkon falje për mëkatet e bëra, pastaj thotë telbijen derisa të arrijë në Arafat.

Në Arafat, koha kalohet duke bërë dua, dhikër, telbije dhe salavate për Pejgamberin a.s., kërkohet falje për vete, për prindërit, për të afërmit, për të dashurit e tij dhe për të gjithë myslimanët. Në të nuk kushtëzohet pastërtia, kështu që edhe gruaja me cikël dhe lehoni bëjnë dhikër dhe dua. Çdo dua përsëritet nga tri herë, duaja fillohet me lavdërim Allahut, me tesbih dhe salavate për Pejgamberin a.s. dhe përmbyllet me to dhe amin. Kështu qëndrohet deri në perëndim të diellit dhe kohë pas kohe, gjatë duasë, thuhet telbija.⁷

SHKUARJA NË MUZDELIFE

Kur dielli të ketë perënduar, pa e falë akshamin, haxhilerët nisen për në Muzdelife. Në rrugën drejt Muzdelifes është

mustehab të thuhet telbija, tekbiret, duatë, të kërkohet falje për mëkatet, dhe t'i dërgohen salavate Pejgamberit a.s..

Akshami dhe jacia falen në Muzdelife, jo në Arafat apo gjatë rrugës për në Muzdelife, ndërsa është synet që haxhiu natën ta kalojë në Muzdelife deri në agim, pos për ata që janë të dobët, siç janë të sëmurët, të moshuarit dhe femrat. Prandaj, gruaja nuk obligohet me kurrfarë kompensimi nëse për shkak të tollovisë largohet nga Muzdelifeja dhe nuk qëndron në të.

Nata në Muzdelife kalohet me namaz, dhikër, lexim Kurani dhe dua, ngase në të janë bashkuar nderi i kohës dhe i vendit.

Është mustehab që sabahu të falet menjëherë, posa të hyjë koha e tij. Deri pak para lindjes së diellit, aq sa mund t'i falin dy rekate, haxhiu bën dua, tekbire, telbije, e falënderon Allahun xh.sh., lavdëron Atë dhe kërkon nga Allahu çka të dëshirojë.⁸

SHKUARJA NË MINA

Në mëngjesin e ditës së Bajramit, haxhilerët, pak para lindjes së diellit, përafërsisht aq sa mund të falen dy rekate, është synet që të nisen nga Muzdelifeja për në Mina. Gjatë largimit, haxhiu bën sa me shumë telbije dhe dhikër, gjersa në Muzdelife është mustehab që haxhiu t'i marrë guralecët, me madhësi të bërthamës së hurmës ose sa të një kokrre fasuleje, për t'i hedhë në Xhemretul Akabe⁹. Në vijim do përmendim ritualet të cilat kryhen në Mina:

1. Hedhja e gurëve në Xhemretul Akabe

Kur në mëngjesin e ditës së parë të Kurban Bajramit, respektivisht më dhjetë dhulhixhe arrin në Mine, menjëherë niset kah Xhemretul Akabe dhe në të hidhen guralecët, të cilët janë mbledh në Muzdelife, një nga një,

njërin pas tjetrit. Gjatë hedhjes së çdo guri, merr tekbir dhe lutet dhe thotë: "Në emër të Zotit, Zoti është më i Madhi, për inat të shejtanit dhe kënaqësisë së Mëshiruesit. O Zot, bëje atë haxh të pranuar, një përpjekje falënderuese dhe mëkat të falur!" E, pas hedhjes së gurëve, haxhiu nuk ndalet aty për të bërë dua, por këtë e bën duke ecur dhe, këtë ditë, nuk gjuan gurë të tjerë.¹⁰

2. Therja e kurbanit

Pasi që haxhiu hedh guralecët në Xhemretul Akabe ditën e parë të Kurban Bajramit, ai e therë kurbanin (hedjin). Për mufridin ky kurban është synet, ndërsa për ka'rinin dhe mutemetiun është vaxhib. Por, nëse nuk kanë mundësi për të therë kurban, atëherë ata janë të obliguar të agjërojnë. Therja e kurbaneve dhe pagesa e tij tashmë menaxhohet nga vetë

"Në emër të
Zotit, Zoti
është më i
Madhi, për inat
të shejtanit dhe
kënaqësisë së
Mëshiruesit. O
Zot, bëje atë
haxh të
pranuar, një
përpjekje
falënderuese
dhe mëkat të
falur!"

organizatorët e haxhit që d.m.th. te ne nga Bashkësia Islame e Kosovës.

3. Qethja e flokëve

Pas therjes së kurbanit, gruaja shkurton flokët në sasi të majave të gishtave, ndërsa rroja e kokës për gruan është mekruh tahrime, përveç nëse është e domosdoshme.

Koha e shkurtimit të flokëve është në ditët e therjes së kurbanit, e që janë dita e dhjetë, e njëmbëdhjetë dhe e dymbëdhjetë, brenda hapësirës që përfshinë haremi. Koha fillon prej agimit të ditës së parë të Bajramit dhe zgjat deri në përfundim të diellit të ditës së tretë. Pas kësaj, haxhiut i lejohet gjithçka që i është ndaluar gjatë ihramit, pos kontaktit intim dhe para hyrjes që shpie në të, të cilat nuk lejohen derisa të bëhet tavafuz zijareh.¹¹

TAVAFUZ ZIJAREH (TAVAFUL IFADA)

Pas hedhjes së guralecëve në ditën e parë të Kurban Bajramit, pas therjes së kurbanit dhe pas shkurtimit të flokëve, haxhiu është më mirë të shkojë në Mekë po këtë ditë dhe ta bëjë tavafuz zijareh. Koha e tavafuz zijareh fillon prej agimit të vërtetë të ditës së Kurban Bajramit e vazhdon deri në përfundim të diellit të ditës së dymbëdhjetë të dhulhixhes. Gruaja nuk obligohet me kurrfarë kompensimi nëse për shkak të ciklit menstrual apo lehonisë e shtyn tavafuz zijareh edhe jashtë ditëve të teshrikut.

Pastërtia është vaxhib i tavafit dhe nuk është kusht për vlefshmërinë e tij. Por, edhe pse pastërtia nuk është kusht për vlefshmërinë e tavafit, megjithatë gruaja me cikël menstrual apo lehoni nuk i lejohet ta kryejë tavafin në këtë gjendje. Ajo në fakt ose mund të përdorë barëra që ta prolongojë ardhjen e ciklit menstrual deri pas haxhit dhe kjo pa asnjë të keqe është e lejuar për të, ose nëse asaj i paraqitet cikli menstrual para kryerjes së tavafuz zijareh, dhe i pamundësohet të presë derisa të pastrohet (për shkak të terminëve të udhëtimit e largimit nga Meka), ajo e bën tavafin ashtu me cikël menstrual dhe mandej largohet nga Meka. E nëse ajo e kryen tavafuz zijareh në këtë gjendje, tavafi i saj është i pranuar, por ajo obligohet me therje të një bagëtie (lopë apo deve).¹²

Pas tavafit, haxhiu i falë dy rekatë prapa Mekami Ibrahimit apo në ndonjë vend tjetër nëse nuk është e mundur, pastaj e bën sijn në qoftë se nuk e ka bërë para tavafit, dhe kështu me kryerjen e tavafuz zijareh i lejohet edhe kontakti intim.¹³

HEDHJA E GURALECËVE NË XHEMERATE

Në ditën e dytë të Bajramit (njëmbëdhjetë dhulhixhe), haxhiu i hedh guralecët në tri xhemeratet. Së pari i hedh shtatë guralecë në xhemren e vogël, që ndodhet në afërsi të xhamisë El Hajf. Me rastin e hedhjes së guralecëve kthehet nga Kibla dhe fillon t'i hedhë guralecët me dorën e djathtë. Gjatë hedhjes së secilit guralecë, thotë Allahu Ekber. Pas kësaj, shkon te xhemra e mesme dhe vepron njësoj si tek e

para. Pastaj, shkon te xhemra e madhe, e cila quhet Xhemretul Akabe dhe vepron njësoj siç ka vepruar ditën e parë, duke mos u ndalur fare për të bërë dua, por bënë dua duke ecur. Pastaj, të nesërmen, që është dita e tretë e Bajramit (dymbëdhjetë dhulhixhe), pas zenitit, i hedhë nga shtatë guralecë në secilën prej tri xhemreve.

Nuk është e qortueshme nëse për shkak të tollovisë e shtyn hedhjen e gurëve jashtë kohës në të cilën është e preferuar hedhja e tyre.¹⁴

TAVAFI I LAMTUMIRËS (TAVAFUL VEDA APO TAVAFUS SADER)

Pas përfundimit të hedhjes së guralecëve, haxhiu shkon në Mekë. Haxhiu në Mekë qëndron deri ditën e udhëtimit. Para largimit nga Meka, personi e bënë tavafin e lamtumirës, i cili quhet tavaful veda ose tavafus sader. Kryerja e këtij tavafi është vaxhib për haxhiun jo mekas, ndërsa nuk është vaxhib për gruan me cikël menstrual apo lehonë.

Pas këtij tavafi, haxhiu falë dy rekatë pas Mekami Ibrahimit apo diku tjetër, pastaj shkon te Zenzemi dhe pi ujë prej tij, i afrohet Qabesë nëse nuk është turmë dhe afër saj bën lutje, posaçërisht te dyert e Qabesë. Gruaja me cikël menstrual qëndron në derë të Haremit dhe aty bën dua, pastaj largohet nga Meka.¹⁵

- Shih: Kasani, el Bedai, 2/143, Bedrudin el Ajni, el Binajeh, 4/167, Ibën Nuxhejm, el Bahru err Rraik, 2/344, Zejleiu, Tebjinu el Hakaik, 2/8, etj.
- Shih: el Bahr el Amik, 1/637, el Meslek el Mutekassit, fq.32 dhe 36, el Xhevhere, 1/151, el Binajeh, 4/170.
- Shih: el Hidajeh, 1/135, Tebjinu el Hakaik, 2/9, el Xhevhere, 1/151, el Bahr el Amik, 1/644-645, Fet'hu el Kadir, 2/432-433, Lubabu el Menasik, fq.84, el Hedijetu el Alajeh, fq.231, etj.
- Shih: et Tebjin ve hashijetuhu, 2/15, el Bahru err Rraik, 2/350-351, Mexhma el Enhur, 1/271-272, Fet'h babi el Inajeh, 3/43-44, Lubabu el Menasik, fq.101-103, el Meslek el Mutekassit, fq.53-56, etj.
- Et Tebjin, 2/15, el Bahru err Rraik, 2/351-356, Lubabu el Menasik, fq.103-107, ed Durr el Muhtar ve hashijetuhu, 2/493-496, el Meslek el Mutekassit, fq.56-62, el Hedijetu el Alajeh, fq.236-238, etj.
- Lubabu el Menasik, fq.129-130, Fet'hu el Kadir, 2/460.
- Et Tebjin, 2/23, Fet'hu el Kadir, 2/247-468, Lubabu el Menasik, fq.133-138, el Meslek el Mutekassit, fq. 91-100, etj.
- Shih: el Bedai, 2/136, el Muhit, 2/428-429, et Tebjin, 2/28-29, el Xhevhere, 1/157-158, el Bahru err Rraik, 2/368, Lubabu el Menasik, fq.143-149, en Nehru el Faik, 2/85-86, ed Durr el Muhtar ve hashijetuhu, 2/508-509, el Meslek el Mutekassit, fq.105-110, etj.
- Xhemreh është vendi në cilin hidhen gurët.
- Lubabu el Menasik, fq.149-152, el Meslek el Mutekassit, fq.110-112, etj.
- Shih: Durrer el Hukam, 1/229, el Bahru err Rraik, 2/372, Lubabu el Menasik, fq.153-155, ed Durr el Muhtar ve hashijetuhu, 2/515-516, el Meslek el Mutekassit, fq.113-116, etj.
- Shih: Tebjinu el Hakaik, 2/58-59, el Hidajeh, 1/181, Fet'hu el Kadir, 3/161.
- Lubabu el Menasik, fq.156-157, el Meslek el Mutekassit, fq.116-117, etj.
- Shih: el Bedai, 2/159-160, el Hidajeh, 1/146-147, el Ihtijar, 1/154-155, el Inajeh, 2/497-498, el Xhevhere, 1/160-161, el Binajeh, 4/253-257, Durrer el Hukam, 1/230-231, etj.
- Shih: et Tebjin, 2/35-36, el Bahru err Rraik, 2/376-377, Lubabu el Menasik, fq.169-171, el Meslek el Mutekassit, fq.127-130, etj.



Haxhi për tjetrin (bedeli)

Mr. sc. Bahri Curri

Të zëvendësuarit në haxh, apo i ashtuquajtur *haxhi bedel*, kohëve të fundit, është shtuar bukur shumë, andaj kjo dhe shtrihet nevojën e trajtimit të kësaj çështjeje si dhe të shikohet legjitimitimi i kësaj çështjeje.

A thua a lejohet përgjithësisht kryerja e haxhillëkut për tjetrin, qoftë i gjallë apo i vdekur? Apo lejohet vetëm për të vdekurin? E nëse lejohet për të gjallin, atëherë a lejohet vetëm për atë që s'ka mundësi fizikisht ta kryejë vetë haxhillëkun (për personin me paafësi fizike)?, apo lejimi përfshinë edhe atë me mundësi fizike? A kushtëzohet që bedeli të jetë nga i njëjti vend, apo jo?, e shumë çështje të tjera të ndërlidhura me këtë.

Lidhur me këtë, kanë ardhur disa hadithe që flasin për kryerjen e haxhillëkut për tjetrin. Disa ndërlidhen me personin e gjallë, por që është i paafë fizikisht për ta kryer vetë haxhillëkun, e disa ndërlidhen me personin e vdekur, e disa janë të përgjithshme (pa kushtëzime).

Hadithi që flet për personin e gjallë, por me pamundësi fizike për ta kryer vetë haxhillëkun, përcillet nga Ibën Abbasi r.a., i cili thotë: “Në vitin e Haxhit të Lamtumirës, erdhi një grua e fisit Hath'am dhe pyeti: “O i Dërguari i Allahut! Haxhi, të cilin Allahu ua ka bërë obligim robërve të Tij, babanë tim e ka gjetur të thyer në moshë, saqë nuk mund të qëndrojë as mbi shalë (mbi kafshë). A i llogaritet atij nëse unë e bëj haxhillëkun për të?” “Po”, - i tha Pejgamberi a.s.” (Buhariu, 1854).

Hadithi që flet për të vdekurin përcillet po ashtu nga Ibën Abbasi r.a., ku tregon se një grua nga fisi Xhuhejne erdhi te Pejgamberi a.s. dhe i tha: “Nëna ime qe betuar për ta bërë haxhillëkun, por ajo vdiq përpara se ta bënte atë. A mund ta bëj unë haxhillëkun për të?” Pejgamberi a.s. iu përgjigj: “Po, bëje haxhillëkun për të. Sikur nëna jote të kishte borxh, a do ta shlyeje ti atë (borxh) për të? Kështu pra, shlyeje borxhin e Allahut, pasi Ai ka më tepër të drejtë për t'u paguar.” (Buhariu, 1852).

A thua a lejohet përgjithësisht kryerja e haxhillëkut për tjetrin, qoftë i gjallë apo i vdekur? Apo lejohet vetëm për të vdekurin?

Hadithi që është i përgjithshëm, e nuk e specifikon për të gjallë apo për të vdekur, përcillet po ashtu nga Ibën Abbasi r.a., ku tregon se i Dërguari i Allahut a.s. e kishte dëgjuar një person duke thënë: “Lebbejke an Shubrume”. I Dërguari i Allahut a.s. e pyeti: “Kush është Shubrume?” Ai iu përgjigj: “Një i afërm i imi.” Pejgamberi a.s. i tha: “A e ke bërë haxhillëkun ndonjëherë më parë (për vete)?” Tha: “Jo.” Atëherë i tha: “Bëje këtë haxhillëk për vete, e pastaj (herën tjetër) e bën haxhillëkun për Shubrumen!” (Ibën Maxhe, 2903).

Në dritën e këtyre haditheve dhe argumenteve të tjera që nuk u cekën, dijetarët kanë përmendur një sërë çështjesh të ndërlidhura me haxhin bedel. Andaj mund t'i përmbledhim si vijon:

1. Janë pesë kushte për obligueshmërinë e haxhillëkut: Islami, mendja, mosha madhore, liria dhe mundësia. Mundësia përfshinë: furnizimin, transportin, sigurinë e rrugës, shëndetin, mundësinë e lëvizjes që nënkupton kohën e mjaftueshme për arritjen dhe kryerjen e ceremonive të haxhillëkut ashtu si e kanë definuar dijetarët e fikhut.

Sa i përket shëndetit, në të kushtëzohet fuqia me të cilën e përballon transportin (udhëtimin) pa ndonjë mundim të rëndë. E tërë kjo ka të bëjë me mundësinë që lidhet personalisht me vetë njeriun që dëshiron ta kryejë haxhillëkun. Pra ekziston edhe një mundësi e një natyre tjetër që arrihet përmes dikujt tjetër. Kjo ka të bëjë me atë person që nuk mund ta kryejë haxhillëkun vetë personalisht për shkak të ndonjë pengese, si sëmundja e pashërueshme, pleqëria e thellë, por ka pasuri dhe ka kush e bën haxhillëkun në vend të tij. Kjo me një fjalë tjetër quhet bedel. Të këtij mendimi janë Ebu Hanifeja, Shafiu dhe Ahmedi. Ndërsa Maliku (e bashkë me të edhe Lejthi) mendon, e që është edhe mendimi i mbështetur në medhhebin maliki, që haxhillëku nuk pranon zëvendësim për të gjallin, qoftë me arsye apo pa arsye, edhe pse në disa raste e lejojnë haxhillëkun për të

vdekurin që ka vdekur duke e pasur obligim haxhin farz, por për të gjallin asses.

Hanefitë lidhur me shëndetin dhe gjendjen e mirë fizike thonë se haxhillëku nuk obligohet për të sëmurin, për atë që ka sëmundje të pashërueshme (kronike), për invalidin (të gjymtin), për të verbëtin (ky është mendimi më i njohur i Ebu Hanifes në këtë, por dijetarët e medhhebit hanefi kanë edhe mendime të tjera lidhur me këtë), për plakun e thyer në moshë që nuk ka mundësi udhëtimi, për të burgosurin, për atë që pengohet nga një apo tjetër arsye për ta bërë haxhillëkun, si pengimi nga pushteti zullumqar etj..



2. Bedeli për haxhillëk nuk mund të porositet (autorizohet) nga personi që nuk e ka obligim haxhin. Përndryshe ai është i pavlefshëm.

3. Nga këto hadithe dhe transmetime të tjera, vërtetohet se haxhillëku për tjetrin është i lejuar dhe shpërblimi për të i arrin atij. Pra bedeli bëhet në këto raste:

- Nëse personi e ka pasur obligim haxhillëkun, por nuk ka arritur që ta kryejë atë dhe ka vdekur.

- Nëse personi e ka obligim haxhillëkun, por është i sëmurë me sëmundje të pashërueshme dhe nuk ka mundësi që ta përballojë udhëtimin.

- Nëse personi është i moshuar dhe është i dobët, nuk mundet që të udhëtojë dhe t'i kryejë ritet të cilat kërkohen gjatë qëndrimit atje.

E pamundësia (pengesa e paevitueshme) është paaftësia për ta kryer haxhin vetë personalisht për shkak të pleqërisë së thellë, moshës së thyer dhe sëmundjes së pashërueshme.

4. Haxhillëku nuk kryhet me bedel për personin e gjallë e të shëndoshë. Pra, personi që ka mundësi materiale dhe shëndetësore për të shkuar vetë në haxhin obligativ, nuk i lejohet që të dërgojë dikë tjetër bedel për ta kryer haxhin për të, por obligohet që ta bëjë vetë këtë. Ibën Mundhiri, në librin e tij "El-Ixhma'u", fq. 59, tregon se për këtë ka ixhma (konsensus) të dijetarët. Ibën Haxheri cek më tej fjalën e Ibën Mundhirit, se ky ixhma është për haxhin farz, ndërsa për haxhin nafile vullnetar, Ebu Hanife e lejon një gjë të tillë, për dallim nga Shafiu që nuk e lejon fare, ndërsa nga Ahmedi vijnë dy transmetime (mendime), njëra mohuese e tjetra pohuese, por në medhheb anohet kah mendimi mohues.

Kjo ngërthen në vete një çështje problematike të bedeli në haxhin vullnetar, ku shumë pasanikë, të cilët e kanë kryer vetë personalisht haxhin obligativ, mirëpo viteve të tjera mund të angazhojnë bedela për haxhin nafile në emër të tyre,

ngase ata vetë janë të zënë me bizneset dhe aktivitetet e tyre. E kjo e zbeh rëndësinë e haxhit dhe mallëngjimin e tyre për vizitën në vendet e shenjta. Prandaj shumica e dijetarëve janë kundër një veprimi të tillë.

Ed Dehlevij nga hanefitë thotë: "Ibadetet janë disa llojesh:

1. Janë të natyrës pasurore-financiare, sikur zekati, kefareti, kurban, që mund të kryhen edhe nga personi tjetër; 2. Janë të natyrës fizike, sikur namazi dhe agjërimi, që nuk mund të kryhen për një person tjetër; 3. Janë të natyrës fizike e pasurore, sikur që është haxhi, dhe mund të kryhen nga një person tjetër, vetëm atëherë kur personi i obliguar me to nuk është në

gjendje që t'i kryejë vetë ato."

5. Nijeti i haxhillëkut nga bedeli duhet të bëhet në emër të atij që e ka porositur (autorizuar).

6. Personi i cili dërgohet si bedel për ta kryer haxhillëkun duhet që fillimisht ai vetë ta ketë të kryer haxhin, e pastaj ta bëjë këtë për tjetrin, ndryshe nuk rekomandohet sipas hanefive, të cilët mendojnë se bedeli (zëvendësuesi) i plotëson kushtet e haxhit, pra është mysliman dhe i shëndoshë mendërisht, lejohet që ta bëjë haxhillëkun për tjetrin edhe pse vetë nuk e ka kryer haxhin më parë. Kjo dhe quhet haxhi sarure (të bësh haxhin bedel për tjetrin pa e bërë fillimisht haxhin për vete). Sipas hanefive, kjo është mekruh tenzihen sa i përket porositësit (personi i obliguar me haxh), ndërsa është mekruh tahrimen, sa i përket kryesit-bedelit. Këtë qëndrim e arsyetojnë me hadithin e gruas nga fisi Hath'am, të cilës i tha Pejgamberi a.s.: "Bëje haxhillëkun për babanë tënd!" pa e pyetur atë se a e ka bërë ajo haxhillëkun për vete më parë. Megjithatë edhe hanefitë nuk e preferojnë një veprim të tillë, vetëm se e lejuan këtë veprim, duke e dënuar rëndë dhe afuar shumë afër ndalesës. Ndërsa sipas shafive dhe hanbelive, një gjë e tillë nuk lejohet, përderisa Maliku, veprimin e tillë, në rast se dikush e bën haxhin për tjetrin para se ta bëjë për vete, e sheh si të papëlqyer, për dallim prej Shafiu dhe Ahmedin, të cilët mendojnë se nëse ndodh një gjë e tillë, haxhi bedel i llogaritet atij që e ka kryer e jo atij për të cilin është nisur!

7. Personi që e ka mundësinë materiale për haxhin obligativ, por që nuk e ka mundësinë e arsyeshme fizike për ta kryer vetë haxhillëkun, shumica e dijetarëve (Ebu Hanife, Shafiu, Ahmedi dhe të tjerët) thonë se ai obligohet që ta angazhojë një bedel për kryerjen e haxhillëkut.

Për personin që e kishte mundësinë për ta kryer haxhin vetë, mirëpo e zuri vdekja pa e kryer atë, në rast se nuk ka lënë testament, sipas Ebu Hanifes familja nuk obligohet me

kryerjen e haxhit për të, por nëse e bëjnë është punë e mirë, përderisa Shafiu dhe Ahmed, mendojnë se pasardhësit e tij obligohen ta kryejnë haxhin për të nga pasuria e tij e lënë trashëgim.

8. Bedeli a vlen vetëm nëse niset nga vendi i njëjtë i porositesit, apo vlen nga kudo që niset, me kusht që nijeti të bëhet para mikatit të vlefshëm? Disa kushtëzojnë që bedeli të niset nga vendi i porositesit. Hanefitë thonë që nëse porositesi ka caktuar vendin prej nga të bëhet nisja, duhet të respektohet ai vendim, e nëse jo, atëherë nisja bëhet nga vendi i porositesit. Kështu mendojnë edhe hanbelitë. E disa të tjerë, sikur shafitë, nuk e kushtëzojnë këtë, por vlen nga mikati i caktuar për haxh, madje-madje vlen edhe nga banorët e Mekës, të cilët janë brenda mikatit, por që e bëjnë nijetin nga shtëpitë e tyre.

9. Nëse bedeli, e bën ndonjë shkelje të ihramit që pasohet me ndëshkim, si prerja e thonjeve, shkulja e qimeve etj., shpagimi për këtë i obligohet atij nga pasuria e tij personale. Po edhe nëse bën ndonjë veprim që e prish haxhin në tërësi, atëherë barra e përgjegjësisë bie mbi të (bedelin), i cili duhet t'ia kompensojë shpenzimet porositesit në mënyrë që t'i mundësohet atij përsëritja e haxhillëkut.

10. Shpërblimi i haxhit bedel (sevapi), a i takon personit që e ka porositur, apo zëvendësuesit? Ibën Hazmi thotë: "Transmetohet nga Ebu Davudi, i cili thotë: "I thashë Seid ibën el Musejib: "O Ebu Muhamed, kujt i takon shpërblimi, atij që bën haxhin me porosi-bedelit, apo porositesit?" Ai u përgjigj: "Allahu i Lartësuar është i gjerë që t'i përfshijë që të dytë (me shpërblim)." Ibën Hazmi thotë: "Saktë ka folur Seid ibën el Musejib."

Mirëpo mund të themi, sikur që e përmend edhe Uthejmini e shumë dijetarë të tjerë, se shpërblimi për veprat që kanë të bëjnë me haxhin i shkon porositesit për të cilin bëhet haxhi. Ndërsa veprat e tjera jashtë haxhit, si namazi në Harem, leximi i Kuranit, tavafet shtesë etj., i takojnë zëvendësuesit.

11. A ka efekt gjinia e bedelit? Pra, a lejohet që femra të shkojë bedel për mashkullin, dhe anasjelltas? Dijetarët thonë që kjo s'ka aspak pengesë dhe lejohet, sikur që vërehet edhe në argumentet e mësipërme dhe në të tjera. Preferohet që bedel të shkojnë të afërmit, sikur fëmija për prindin etj., por edhe nëse e angazhon ndonjë më të largët, s'ka dert.

12. Nuk lejohet gjatë kohës së haxhit që të bëhet haxh bedel, përveçse vetëm për një person, e jo më shumë.

13. Disa pyesin se a vlen shpërblimi për bedelin, sikurse për atë që e kryen haxhillëkun vetë, e ku thuhet në hadith për haxhin e pranuar se haxhiu kthehet i pastër sikur atë ditë që e ka lindur nëna e tij? Kjo çështje kthehet tek vullneti i Allahut, dhe nuk ka ndonjë argument që tregon për shpërblim të tillë për bedelin.

14. A lejohet që bedeli ta angazhojë një bedel tjetër në vend të vetes? Dijetarët thonë se nuk lejohet një gjë e tillë, përveçse me lejen e porositesit, qoftë me një shumë më të vogël apo më të madhe. E nëse e bën pa lejen e tij, atëherë haxhi është i pavlefshëm dhe duhet që t'ia kthejë paratë e haxhit porositesit.

15. Duhet të kërkohet që zëvendësuesi (bedeli) të jetë njeri i mirë, i devotshëm, i sinqertë dhe që i njeh mirë rregullat e fesë e edhe të haxhit, si dhe t'ia dijë vlerën ibadetit dhe vendeve të shenjta. Po ashtu duhet të jetë i besueshëm për kryerjen e duhur të riteve të haxhillëkut.

16. Shpenzimet që i bën bedeli për kryerjen e haxhillëkut bëhen nga pasuria e porositesit. Madje disa dijetarë thonë që edhe nëse i mbetet diçka nga të hollat, duhet kthyer te porositesi. Kjo ngase qëllimi i bedelit është që ky veprim të jetë i sinqertë për Allahun dhe t'ia ndihmojë vëllait të tij të paafte fizikisht që ta kryejë haxhillëkun, si dhe të synojë afrimin tek Allahu me ibadet, dua e dhikër në vendet e shenjta. Bedelit duhet dhënë paratë që do t'i shpenzojë për furnizimin e tij gjatë kohës së kryerjes së haxhillëkut dhe gjatë rrugës. Marrja me pagë për shkak të kryerjes së haxhillëkut nuk është e lejuar, sepse zënia me pagë për kryerjen e ibadetit nuk është e lejuar pos në domosdoshmëri, ndërsa në haxh nuk ka asnjë domosdoshmëri, sepse bedelit mund t'i japë pasurinë në mënyrë të thjeshtë, pa kurrfarë zënieje me gojë.

Por kjo nuk e pengon që të marrë një shpërblim apo dhuratë nga ana e porositesit në mënyrë të vullnetshme e me qejf. Mirëpo vërejmë se shumë njerëz e kanë bërë biznes këtë punë dhe nuk e kanë për synim ibadetin, por përfitimin material, andaj kjo sipas disa dijetarëve është e papëlqyeshme, ngase ibadetin po e shfrytëzojnë për përfitim material, andaj edhe nuk ka shpërblim për ata njerëz në ahiret për këtë veprim të tyre.

1. Alauddin Ebu Bekr bin Mesud el Kasani, *Bedaiu es Sanai'i fi Tertib esh Sherai'i*, (Bejrut-Liban: Dar el Kutub el Ilmijeti, 1418 h - 1997) 3/37-58.
2. Dhafer Ahmed et Tehanevij, *I'la'u es-Sunen*, (Karaçi-Pakistan: Idaretu el-Kuran ve el-Ulum el-Islamijeti, 1415 h) 10/462-466.
3. Ebu Zekerijja Muhjiddin bin Sheref en Nevevij, *Kitab el-Mexhm'u i Sherh el-Muhedhdheb li esh-Shirazi*, (Bejrut-Liban: Dar Ihjai et-Turath el-Arebij, 1422 h - 2001) 7/34-68 dhe 7/69-83.
4. Ebu el Velid Muhamed bin Ahmed bin Muhamed bin Ahmed ibën Rushd el Kurtubij, *Bidajetu el-Muxhtehid ve Nihajetu el-Muktesid*, (Bejrut-Liban: Dar el-Kutub el-Ilmijeti, 1416 h - 1996) 3/246-259.
5. Ebu Muhamed Abdullah bin Ahmed bin Muhamed bin Kudamete, *El-Mugni*, (Rijad-Arabia Saudite: Mektebetu err-Rrijad el-Hadithetu, 1401 h - 1981) 3/217-247.
6. Dr. Vehbete ez Zuhajli, *El-Fikh el-Islamijj ve Edil-letuhu*, (Damask-Siri: Dar el-Fikr, 1428 h - 2007) 3/2082-2120.
7. Seid bin Abdulkadir Bashenfer, *El-Mugni fi Fikh el-Haxhxe ve el-Umreti*, (Bejrut-Liban: Dar Ibn Hazm, 1421 h - 2001) fq. 14-19, dhe fq. 36-55.
8. Ahmed ibën Alij ibën Haxher el-Askalanij, *Fet'h el-Bari bi Sherh Sahih el-Buhari*, (Kajro-Egjip: Dar err-Rejan li et-Turath, 1407 h - 1986) 4/77-84.
9. Es-Sejjid Sabik, *Fikh es-Sunneti*, (Kansas City-USA: Sheriketu Menar ed-Duvelijjeti, dhe Kajro: El-Fet'h li el-l'am el-Arebijj, 1416 h - 1995) 1/636-648.
10. Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, *Fikhu hanefi*, (Cyrih-Zvicër: Fondacioni i Rinisë Islame, prill 2011) 1/607-611.
11. Bahri Curri, *Gjurmë pene, shkrime dhe përkthime 1992-2003*, Prishtinë-Kosovë, dhjetor, 2014, fq. 309-316.
12. Es-Serxhanij, Dr. Ragib. "Haxhxe el-bedel, davabit ve ahkam" (parë për herë të fundit më 25.04.2023) https://islamstory.com/ar/artical/3408409/حج-البدل?fbclid=IeAR09oYvizNQg8LXcUJ0s4nMj200PPeN8DN13rkdBV3XY14xBHiepy_jYj7g
13. Mahmud, Abaj Muahmmmed. "Haxhxe el-bedel ev el-inabetu fi el-haxhxe" (parë për herë të fundit më 25.04.2023) <https://islaonline.net/حج-البدل?amp&fbclid=IeAR1-lvEzDZA05ZeZ2mDF17AqEj5SyFkOmx3HKeq-XMRoIRH3v6aVIXjud04>
14. "Davabit ve ahkam haxhxe el-bedel". (parë për herë të fundit më 25.04.2023) <https://islamqa.info>.


Haxhi, udhëtimi më i bukur i jetës me të cilin e fitojmë Xhenetin

Mihana Goga – Bekteshi

Menjëherë pas përfundimit të muajit Ramazan, besimtarët myslimanë që kanë mundësi të mira materiale e shëndetësore, fillojnë të planifikojnë se si t'i përgjigjen Zotit të tyre me adhurimin tjetër të radhës. Ata entuziazmohen për një adhurim i cili iu obligohet vetëm një herë në jetë, haxhin. Ai duhet dhe mund të kryhet vetëm në kohën, muajt e tij. Muajt e haxhit, e të cilët Allahu ia përcaktuar janë: shevali, dhulkade dhe dhjetë ditët e para të dhulhixhjes. Për vlerën e këtyre muajve dhe veprimeve që duhet të shmanget haxhiu prej tyre në ta, Allahu na tha: *“Haxhi është në muajt e caktuar e kush bën (ia fillon të zbatojë) haxhin në këta muaj, nuk duhet ofruar gruas, nuk bën të merr nëpër këmbë dispozitat e Sheriatit, as nuk duhet shkaktuar grindje. Çka punoni nga e mira, Allahu e di për to. Dhe përgatituni me furnizim (për rrugë), e furnizimi më i mirë është devotshmëria, e ju të zotët e mendjes kini dronë Time.”* (El Bekare,197).

Nëse objektivi kryesor i agjëruesit ishte arritja e devotshmërisë, atëherë edhe haxhi, si një detyrë jo pak e mundimshme fizikisht, e synon po këtë synim, që të bëhemi të devotshëm.

Është madhështore shkuarja në haxh për myslimanin, ngase ai gjatë namazit, pesë herë në ditë e drejton fytyrën e vet nga Qabeja e bekuar, kështu që ai/ajo tërë jetën e vet e lidh me kiblën, e cila është simbol i adhurimit, e cila gjendet në Mekën e Shenjtë, e mu aty është edhe vendlindja e Muhamedit a.s.. Aty është xhamia e parë e ndërtuar në tokë, të cilën Zoti xh.sh. e ka bërë vend ku duhet t'i bëhet adhurim vetëm Atij. Për këtë arsye, haxhi prezanton dëshirën e çdo myslimani, që vazhdimisht rritet dhe kurrë nuk zvogëlohet deri kur të realizohet. Për më tepër, haxhi është një shtyllë prej pesë



shtyllave të Islamit. Haxhi është adhurim fizik në njërin aspekt, por edhe me pasuri në një aspekt tjetër.

Ashtu si të gjithë urdhrat e Zotit xh.sh., edhe urdhri për të shkuar në haxh përmban shumë urtësi. Zoti xh.sh. në Kuranin fisnik thotë: "...Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabesë) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi tek ajo, e kush e mohon (obligimin e haxhit le ta dijë se) Allahu është i Pavarur dhe nuk është i nevojshëm për (ibadetin që bëjnë) njerëzit." (Ali Imran, 97).

Tubimi dhe bashkimi i myslimanëve të ardhur nga vende të ndryshme, me raca të ndryshme dhe që flasin gjuhë të ndryshme në një vend dhe për një qëllim, duke iu drejtuar Allahut me lutje, falje dhe adhurim me një gjuhë të përbashkët, forcon vëllazërimin dhe unitetin islam.

Kur është pyetur Pejgamberi ynë i dashur, Muhamedi a.s., për veprat më madhështore dhe për punët më me vlerë, në hadithin të cilin e transmeton Ebu Hurejra r.a., ai a.s. është përgjigjur: "Besimi në Allahun dhe Pejgamberin e Tij." "E pas kësaj?" – e pyetën përsëri? "Lufta për hir Allahut." – tha ai. "E pas kësaj?" – e pyetën përsëri. "Haxhi që kryhet sipas normave (pa gabime) dhe pranohet tek Allahu."

Veshja e myslimanëve me rrobën e quajtur ihram, cilado qoftë gjendja materiale e tyre, i pasur apo i varfër, e ringjallë në shpirtin e tyre idenë e barazisë dhe të qëndrimit në mahsher – vendtubimin para Allahut në Ditën e Gjykimit. Në anën tjetër, udhëtimi i haxhit është mundësi që besimtari të shtojë diturinë, ngase atje mund të takohet e të dëgjojë nga dijetarët, të kultivojë mirësjelljen, si dhe të kalitë shprehinë e bashkëpunimit reciprok në raste të vështirësive.

*"Ai i cili kryen
haxhin për hir të
Allahut, duke u
larguar nga gjërat
që e prishin haxhin
dhe që nuk ka bërë
ndonjë mëkat tjetër,
do të kthehet (nga
haxhi) si ditën që e
ka lindur nëna."*

(Hadith)

Se çfarë vlerash ka haxhi, flasin një numër i madh i haditheve të Pejgamberit a.s., ndër të cilët po veçojmë hadithin të cilin e transmeton Ebu Hurejra r.a., i cili ka thënë: "Në një rast, kur Pejgamberi a.s. mbajti hytben, ai tha: "O popull! Allahu u ka urdhëruar të vizitoni Qabenë, dhe ju vizitoheni!" Pastaj, njëri e pyeti: "O i Dërguari i Allahut, a për çdo vit a?" Ky heshti për një kohë, ndërsa ky e bëri pyetjen tri herë. "Po të isha përgjigjur "po", kjo do të bëhej si detyrë e domosdoshme – dhe ju këtë – tha Pejgamberi, më vonë nuk do të ishit në gjendje ta kryeni." Mandej ka thënë: "Kur unë ju lë të qetë, më lini edhe ju mua të qetë." Popujt që kanë qenë para jush janë shkatërruar për shkak se kanë pyetur shumë dhe nuk janë pajtuar me pejgamberët e tyre. Nëse iu urdhërojnë diçka, kryeni sa të mundeni, e kur t'ju ndalojnë diçka, lëreni atë!"

Ebu Hurejra r.a. ka thënë: "E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. që ka thënë: "Ai i cili kryen haxhin për hir të Allahut, duke u larguar nga gjërat që e prishin haxhin dhe që nuk ka bërë ndonjë mëkat tjetër, do të kthehet (nga haxhi) si ditën që e ka lindur nëna."

Prandaj nuk duhet harruar se për haxhin e pranuar nuk ka shpërblim tjetër veç Xhenetit. Ndërsa vetë haxhitë janë "miqtë" e të dashurit të Zotit. Nëse e lusin, Ai u përgjigjet, e nëse i kërkojnë diçka, Ai ua jep, dhe nëse e lusin që t'ua falë gjynahet, Ai do t'ua falë.

Lusim Allahun xh.sh. që të gjithë myslimanëve t'ua mundësojë që të kryejnë këtë ibadet dhe shtyllë të fesë islame dhe ta vizitojnë kiblen e tyre – Qabenë e bekuar, drejt së cilës falen pesë herë në ditë!



Komentimi i sures El-Fet'h (5)

MISIONI I PEJGAMBERIT A.S., DHE KUPTIMI I BESATIMIT – BEJ'ATU-R-RRIDVAN

Sabri Bajgora

إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ شَاهِدًا وَمُبَشِّرًا وَنَذِيرًا ﴿٨﴾ لَتُؤْمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ
وَتُعَزِّرُوهُ وَتُوَقِّرُوهُ وَتُسَبِّحُوهُ بُكْرَةً وَأَصِيلًا ﴿٩﴾ إِنَّ الَّذِينَ يُبَايِعُونَكَ
إِنَّمَا يُبَايِعُونَ اللَّهَ يَدُ اللَّهِ فَوْقَ أَيْدِيهِمْ فَمَنْ نَكَثَ فَإِنَّمَا يَنْكُثُ عَلَى
نَفْسِهِ يَوْمَئِذٍ أَوْفَى بِمَا عَاهَدَ عَلَيْهِ اللَّهُ فَمَنْ أَتِيهِ أَجْرًا عَظِيمًا ﴿١٠﴾

“Ne të dërguam ty si dëshmues, si lajmëtar përgëzues dhe si qortues, që ta besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, që ta përkrahni e ta nderoni atë (Muhamedin) dhe që ta lartësoni Atë (Allahun) mëngjes e mbrëmje. Ata që të japin besën ty, në të vërtetë, i japin besën Allahut. Dora (kënaqësia) e Allahut është mbi duart e tyre! Kush e shkel besën, e shkel në dëm të vetes, ndërsa kush e mban besën që i ka dhënë Allahut, Ai ka për t'i dhënë atij shpërblim të madh.” - (El-Fet'h, 8-10).

LIDHJA E KËTYRE AJETEVE ME ATO PARAPRAKE

Nga ajetet paraprake, (1-3), mësuam për mirësitë dhe veçantitë e kësaj marrëveshjeje për të Dërguarin a.s., ndërsa nga ajetet (4-7), mësuam për gjurmët e kësaj marrëveshjeje për sahabët e tij, si dhe pasojat për mynafikët dhe idhujtarët, kurse tash, në këto ajete, qartësohet misioni i Pejgamberit a.s. si dëshmues, përgëzues dhe paralajmërues për t'i nxjerrë njerëzit nga errësirat e kufrit në dritën e imanit. I Dërguari i Allahut përveç ndihmës së Allahut, pranë vetes kishte edhe shokët e tij besnikë, të cilët ishin besatuar se ishin të gatshëm të flijoheshin me jetët e tyre për kauzën e shenjtë islame.

KOMENT:

8. Ne të dërguam ty si dëshmues, si lajmëtar përgëzues dhe si qortues

Ky ajet, si dhe disa të tillë të ngjashëm në Kuran, janë ajete që flasin në mënyrë të drejtpërdrejtë për përgjegjësinë e të Dërguarit a.s., që ta kumtojë Shpalljen nga i Lartmadhërishti, tek ymeti i tij. Por, ky mision i shenjtë, përveç të tjerash, nënkupton se Allahu i Madhërishtëm, nuk e ka dërguar Muhamedin a.s. si dëshmues vetëm për ymetin islam, po edhe për të ymetet e tjera, te të cilët dërgoi pejgamberë, kohë pas kohe. I Plotfuqishmi na sqaron se i Dërguari a.s., erdhi si lajmëtar përgëzues për besimtarët, të cilët i pret Xheneti si shpërblim, por në të njëjtën kohë na e bën me dije se i



Dërguari a.s. ka ardhur edhe si qortues dhe tërheqës i vërejtjes, në mënyrë që njerëzit të ndërgjegjësohen dhe të vetëdijësohen se nuk ka të adhuruar tjetër pos Allahut, dhe se rruga e vetme e shpëtimit është besimi i pastër në Të.

Në lidhje me pjesën e ajetit, “Ne të dërguam ty si dëshmues...”, dijetarët kanë dhënë disa mendime, ndër të cilat do të veçonim:

- Ne të dërguam ty o Muhamed si dëshmues tek ymeti yt, detyrë të cilën ai e kreu me nder dhe përgjegjësi të plotë, sepse i Dërguari i Allahut vërtet e përcolli amanetin dhe shpalljen te ne në mënyrën më të mirë të mundshme. Madje në lidhje me këtë konstatim, kemi edhe çastet e dëlirësisë shpirtërore gjatë hytbesë lamtumirëse, kur i Dërguari a.s., me lot në sy iu drejtua haxhive të pranishëm, duke iu thënë: “A e kreu dhe a e përcolla amanetin e Allahut te ju?” Kur sahabët e pranishëm njëzëri e pohuan këtë gjë, atëherë ai iu drejtua Allahut, duke thënë: “O Allah, Ti je dëshmitari im se unë e përcolla amanetin Tënd te ta”.

- Një mendim tjetër është se fjala “dëshmues” nënkupton se të Dërguarit a.s., edhe pas vdekjes së tij i paraqiten veprat e ymetit. Në lidhje me këtë i Dërguari a.s. ka thënë: “Jeta ime është mirësi për ju, do të flisni (për të tjerët) po edhe (të tjerët) do të flasin për ju. Por gjithashtu edhe vdekja ime është mirësi për ju. (Pas vdekjes sime), do të më

Muhamedi a.s. si vula e krejt profetëve, si më madhështori prej tyre me Shpalljen e fundit qiellore, përveç që do të jetë dëshmues para Allahut për ymetin e tij, do të jetë dëshmues edhe për të gjithë vëllezërit e tij pejgamberë para tij,

paraqiten veprat e juaja. Nëse shoh (vepra) të mira, e falënderoj Allahun e nëse shoh të këqija, do t'i kërkoj Allahut falje për ju.”¹

- Dhe mendimi i tretë, po ashtu i pranuar gjerësisht në mesin e dijetarëve është se i Dërguari a.s. do të dëshmojë edhe për misionin e pejgamberëve të tjerë tek ymetet e tyre. Muhamedi a.s. si vula e krejt profetëve, si më madhështori prej tyre me Shpalljen e fundit qiellore, përveç që do të jetë dëshmues para Allahut për ymetin e tij, do të jetë dëshmues edhe për të gjithë vëllezërit e tij pejgamberë para tij, kur në Ditën e Gjykimit do të dëshmojë se ata e kishin kryer amanetin me të cilin i kishte ngarkuar i Lartrmadhërishmi. Ashtu siç ka ardhur në disa ajete kuranore po edhe në disa hadithe, popujt e pejgamberëve të mëparshëm do ta mohojnë para Allahut se atyre u qe tërhequr vërejtja nga pejgamberët e dërguar te ta, por, për dëlirësinë dhe besnikërinë e tyre do të dëshmojë Muhamedi a.s. Allahu xh.sh. në lidhje me këtë thotë: “Si do të bëhet kur, për çdo popull, Ne do të sjellim dëshmitarë, ndërsa ty (Muhamed)do të të sjellim dëshmitarë për të gjithë ata” - (En Nisaë, 41); dhe “Atë Ditë, kur do të sjellim kundër çdo populli dëshmitarë nga mesi i tyre, kurse ty do të të sjellim dëshmitar kundër këtyre” - (En Nahl, 89).

Përveç këtyre ajeteve që dëshmojnë në lidhje me këtë çështje, kemi edhe hadithin e Resulullahut s.a.v.s., të cilin e transmeton Imam Ahmedi nga Ebu Seid el Hudriu të



ketë thënë: Ka thënë i Dërguari i Allahut a.s.: “Në Ditën e Gjykimit do të vjen Nuhu a.s. dhe ymeti i tij, e Allahu do t’i thotë: A e ke kumtuar Shpalljen Time. Ai do të thotë: “Po o Zoti im.” Ai do t’i drejtohet popullit të tij: “A ua ka kumtuar ky Shpalljen Time?” Ata do të thonë: “Jo, neve nuk na ka ardhur asnjë i dërguar.” Atëherë i thuhet atij: “A ka dikush që dëshmon për ty”, e ai (Nuhu a.s.) do të thotë: “Muhamedi a.s., dhe ymeti e tij”, dhe unë do të dëshmojë për të se e ka kumtuar Shpalljen.”²

Në lidhje me këtë po ashtu kemi transmetimin nga Abdu bin Hamid dhe Ibn Xheriri e këta nga Katadeja, i cili në lidhje me këtë ajet thotë se: “Muhamedi a.s., do të jetë dëshmues për ymetin e vet dhe dëshmues për pejgamberët e tjerë para tij, se ata e kanë kumtuar shpalljen Allahut te ta.”³

Sikur në suren El Ahzab, po ashtu edhe në këtë sure janë përmendur disa nga detyrat apo obligimet me të cilat është ngarkuar i Dërguari i Allahut nga Fuqiploti. Përderisa në suren El Ahzab, në ajetet 45-46: “O ti Pejgamber! Ne të dërguam ty si dëshmues, si lajmëtar përgëzues dhe si qortues; dhe Thirrës në rrugën e Allahut, me lejen e Tij, dhe si pishtar ndriçues”, janë të përmendura pesë obligime të Pejgamberit a.s.: dëshmues, lajmëtar përgëzues, qortues, thirrës në rrugën e Allahut dhe pishtar ndriçues, tash në këtë sure, El Fet’h, i kemi të përmendura vetëm tri obligimet e para: dëshmues, lajmëtar përgëzues dhe qortues. Arsyeja pse në suren El Ahzab, janë përmendur më shumë detyra dhe obligime të të Dërguarit a.s. në krahasim me suren El Feth, është fakti se surja El Ahzab, pothuajse në tërësi i është kushtuar Pejgamberit a.s. dhe gjendjeve të tij⁴, kurse surja El Fet’h është fokusuar më tepër në Marrëveshjen e Hudejbijes, përfshirë këtu frytet dhe pasojat e saj.

9. që ta besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, që ta përkrahni e ta nderoni atë (Muhamedin) dhe që ta lartësoni Atë (Allahun) mëngjes e mbrëmje.

Ky ajet i drejtohet ymetit islam në përgjithësi, dhe në veçanti atyre besimtarëve sypatrembur me porosinë që ta besojnë bindshëm Allahun, të besojnë të Dërguarin e Allahut, të cilin Ai e dërgoi mëshirë për të gjitha botët, për njerëzit dhe xhinët, deri në Ditën e Gjykimit. Besimtarët porositen që ta përkrahin e ta nderojnë të Dërguarin a.s., sepse vetëm kështu feja e Allahut dhe besimi i drejtë do të triumfojë mbi besimet e kota. Dhe në fund të ajetit, ata porositen që ta madhërojnë e ta lartësojnë Allahun, mëngjes e mbrëmje, sepse qëllimi i krijimit tonë është njohja e Allahut si Zot dhe Krijues i vetëm i kësaj ekzistence.⁵

10. Ata që të japin besën ty, në të vërtetë, i japin besën Allahut. “Dora” (Kënaqësia-Fuqia) e Allahut është mbi duart e tyre! Kush e shkel besën, e shkel në dëm

të vetes, ndërsa kush e mban besën që i ka dhënë Allahut, Ai ka për t’i dhënë atij shpërblim të madh.

Ky ajet, na rikthen edhe njëherë kujtesën në atë ngjarje të lavdishme, të cilën e ka përjetësuar edhe vetë Allahu xh.sh. në Kuranin famëlartë, “Bej’atu-rr-Rridvan”, kur besimtarët ia dhanë besën një nga një të Dërguarit të Allahut, se nuk do të ktheheshin në Medinë, pa marrë hak për Uthmanin dhe shoqëruesit që ishin me të, duke iu besatur atij se do të vdisnin e nuk do të ktheheshin prapa. Ky besatim i tyre, nënkuptonte se ata kishin vendosur që të vazhdonin para në lartësimin e Fjalës së Allahut. Nëse do të vdisnin në këtë mision, do ta arrinin kënaqësinë e Allahut dhe gradën e shehidit, e nëse do të mbetnin gjallë, do t’i gëzoheshin fitores dhe ngadhënjimit mbi kufrin dhe shirkun. Pikërisht, për këtë arsye, ata që ishin besatur nën hijen e pemës në Hudejbije, janë të lavdëruar tek Allahut, për shkak të besimit dhe guximit të tyre që të përballen me sfidat më të rënda në rrugën e Zotit. Allahu në lidhje me këta njerëz, në ajetin e 18 të kësaj sureje, El Fet’h thotë: “Vërtet Allahu që i kënaqur me besimtarët, kur ata, nën hijen e asaj peme, të jepnin besën. Ai e dinte çfarë kishte në zemrat e tyre, prandaj u dhuroi qetësi dhe i përgëzoi me një fitore të afërt (çlirimin e Hajberit).”

Këta që u besatuan nën hijen e pemës, kishin një respekt dhe reputacion të madh në mesin e besimtarëve në vite në vijim. Veteranët e Bedrit, pastaj këta që u besatuan në Hudejbije dhe pjesëmarrësit në çlirimin e Mekës, do të ngelin përherë si heronjtë më të dashur për të gjithë brezat e myslimanëve deri në Ditën e Gjykimit. Allahu që i kënaqur ndaj tyre, prandaj edhe thotë se kënaqësia e Allahut është mbi ta. Ata që e mbajnë këtë besë dhe premtim të dhënë Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të kenë shpërblime të mëdha në Xhenetet e amshueshme, kurse ata që e thyjnë këtë besatim dhe premtim, i pret ndëshkimi i rreptë në Ahiret.

Nga shënimet historike, thuhet se në këtë ditë, nga të gjithë sahabët, që gjendeshin me të Dërguarin e Allahut, në Hudejbije, që të gjithë ishin besatur, përveç njërit, Xhedd bin Kajsit. Tregon Xhabiri r.a. dhe thotë: “Ia dhamë besën të Dërguarit të Allahut nën pemë, se do të vdisnim e nuk do të iknim asnjëri (prej betejës). Askush prej nesh nuk e shkeli besën e dhënë përveç Xhedd bin Kajsit, i cili ishte mynafik dhe ishte fshehur nën barkun e devesë së tij, dhe nuk ishte bashkuar me turmën.”⁶

Në këtë ajet, kemi të bëjmë edhe me një çështje mjaft të rëndësishme nga aspekti akaidologjik, sepse në të, në formë alegorike është përmendur “Dora” e Allahut. Disa prej dijetarëve, që veten e quajnë “selefistë”, anojnë kah ajo se Allahu ka gjymtyrë, si dorë, sy, gjunjë etj., por në fund e arsyetojnë këtë interpretim të tyre me fjalët: “Mirëpo jo ashtu siç mund ta perceptojë mendja jonë”. Këta njerëz, në sferën e

cilësive të Allahut, janë bazuar vetëm në aspektin e jashtëm të fjalës, dhe nuk janë mbështetur fare në tekstet që u japin kuptim adekuat cilësive të Zotit, xh.sh., e në këtë rast edhe “Dorës”.

Huxhetul Islam, Imam el Gazali, sqaron shumë saktë se kuptimet e këtyre fjalëve (që kanë të bëjnë me cilësitë haberije - informative) me kuptimin e tyre të njohur alegorik, janë shumë të qarta dhe të kuptueshme. Nga këtu nuk ka dyshim se “selefu-s-salih”, më së miri e kuptonin gjuhën, trajtat dhe figurat, dhe pa dyshim që këto fjalë i kuptonin sipas kuptimeve metaforike të kuptueshme dhe shpesh të përdorura. Vallësi mund të paramendohet se ata që ia dhanë besatimin të Dërguarit nën hijen e pemës, kur e lexonin fjalën e Allahut: “Ata që të japin besën ty, në të vërtetë, i japin besën Allahut. “Dora” (Kënaqësia) e Allahut është mbi duart e tyre!” – (El Fet’h, 10), fjalën “Dorë” e kanë kuptuar vërtet si gjymtyrë e jo si ndihmë, fuqi, kënaqësi apo pushtet të Allahut dhe kudret të Tij?! Në fakt, kjo sqarohet fare thjesht edhe në vazhdimin e ajetit, me kërcënimin se ai që e thyen zotimin, e thyen vetëm në dëm të vetes.⁷

Edhe Sejjid Kutbi e përshkruan këtë pamje të besatimit në Hudejbije si një prej skenave më madhështore të besimit në Allahun. “Ata besimtarë që i vendosnin duart e tyre mbi duart e bekuara të Resulullahut a.s., ishin të bindur me zemër e me shpirt se në fakt, po a jepnin besën edhe Allahut, sepse Ai është mbikëqyrësi dhe përcjellësi i çdo gjëje që ndodh në ekzistencë, e në këtë rast edhe i besatimit në Hudejbije.”⁸

Për shkak të kësaj që u tha më lart, ne e marrim për të saktë metodologjinë e Maturidiut dhe të Gazaliut, dhe e mendojmë se sahabët - shokët e Muhamedit a.s., kanë komentuar sipas kuptimit metaforik çdoherë kur kuptimi i parë, i fjalëpërfjalshëm, ka qenë joadekuat.

POROSIA E KËTYRE AJETEVE

- Përgjegjësitë e të Dërguarit të Allahut të përmendura në këto ajete janë tri:

1. Dëshmia e tij për ymetin e vet dhe për të gjithë pejgamberët e dërguar para tij, se e kishin kryer amanetin dhe misionin e tyre të ngarkuar nga Allahu xh.sh.

Sahabët - shokët e Muhamedit a.s., kanë komentuar sipas kuptimit metaforik çdoherë kur kuptimi i parë, i fjalëpërfjalshëm, ka qenë joadekuat.

2. Përgëzues i besimtarëve të cilët e besuan Allahun dhe të Dërguarin e Tij, me Xhenet.

3. Qortues dhe tërheqës i vërejtjes për ata që e mohojnë Allahun dhe besimin e drejtë me ndëshkim në zjarr të Xhehenemit.

- Qëllimi më i lartë i dërgimit të pejgamberëve nga ana e Allahut te njerëzit, është vetëdijesimi i njerëzve që të besojnë Krijuesin e vetëm-Allahun xh.sh., t'i pasojnë të Dërguarit e Tij dhe ta ngadhënjë fenë të cilën ua ka zgjedhur i Lartmadhërishti Kjo nënkupton madhërimin dhe lartësimin e Tij nga ana e besimtarëve, me namaz dhe dhikër, mëngjes e mbrëmje.

- Ata që u besatuan në Hudejbije se do të luftojnë kundër kurejshëve, deri në vdekje, ata në fakt ia dhanë besën Allahut, prandaj edhe Allahu që i kënaqur ndaj tyre në këtë botë, dhe do t'i shpërblejë me mirësi të shumta në Ahiret.

- Në këtë ajet, ku përshkruhet në mënyrë alegorike se “Dora e Allahut”: është mbi duart e tyre, dijetarët më eminentë të Ehli Sunetit, Maturidiu, Eshariu, Tahaviu, Gazaliu e të tjerë, e sqarojnë se në pyetje është fuqia, ngadhënjimi, kënaqësia apo mirësia e Allahut, sepse është e palogjikshme t'i përshkruhet Allahut gjymtyrë sikur e njerëzve, kur Ai është i zhveshur nga çdo përngjasim apo

shëmbëllim me krijesat.

- Ata që e thyejnë besën e dhënë Allahut, do t'i presë hidhërimi i Tij dhe ndëshkimi në këtë dynja dhe në Ahiret, e kush u mban besën e dhënë Allahut do të shpërblehet në Ahiret me mirësitë e panumërta të Xhenetit. - vijon -

1 Hadithin e transmeton Bezzari nga Abdullah Ibn Mesudi. Ndonëse hadithi është i kategorisë “*daif*”, lejohet përcjellja e tij në sferën e “*Tergibit dhe Terhibit*”. Shih *Musnedin* e Bezzarit, (1/397).

2 Sahihul Buhari, nr. 3339, hadith ‘*sahih*’; Shih në lidhje me këtë edhe hadithin nr. 4487 po ashtu në Sahihun e Buhariut, hadith “*sahih*”.

3 *Tefsir suretil Fet’h*, f. 70.

4 *Et-Tefsirul Munir*, vëll. 26, f. 490.

5 Ibrahim bin Muhamed Melisi, *Et-Tenasuku-l mevduiju fi sureti-l Fet’h*, Mekë, 1434 h., ff. 262-263.

6 *Et-Tefsiru-l Munir*, vëll. 26, f. 487.

7 Naim Tërnavë, *Shkenca e Ilmul Kelamit-Parimet bazë*, Prishtinë, 2023, ff. 258-259.

8 Sejjid Kutb, *Fi Dhilali-l Kuran*, Kajro-Bejrut, vëll. VI, 2003, ff. 3322.

Pranimi dhe shpërndarja e informacionit në këndvështrimin e ajetit të 6-të të kaptinës Huxhurat

Dr. Valmire Batatina

HYRJE

Sot, platformat e mediave sociale plotësojnë ndjeshëm nevojat e komunikimit dhe informacioneve të përdoruesve të saj. Megjithatë, objektivi i drejtuesve dhe ekzistenca e profileve të rreme të përdoruesve, ngre dyshime për vërtetësinë e përmbajtjes së asaj që komunikohet te të tjerët. Duke u nisur nga ky këndvështrim, në Kuranin fisnik, gjejmë në kaptinën Huxhurat, në versetin e gjashtë, urdhërohet që lajmet e sjella nga një njeri jo i drejtë (fasik) të hetohen tërësisht për të mos dëmtuar njerëzit e pafajshëm. Edhe pse përdoruesit e rrjeteve sociale, statusi fetar dhe moral i të cilëve nuk dihet, nuk mund të përshkruhen drejtpërdrejt si njerëz të padrejtë, është e sigurt se ata janë të paktën njerëz të panjohur që mund të jenë edhe jo të ndërgjegjshëm. Për këtë, edhe lajmi që ata përcjellin mund të konsiderohet në kuadër të ajetit përkatës, ngase ata me pëlqimin, shpërndarjen ose plasimin e lajmeve të pavërteta në platforma të ndryshme sociale me apo pa vetëdije, u shkaktojnë dëm material ose moral njerëzve të pafajshëm, gjë që bie ndesh me parimet fetare islame.

INTERPRETIMI I AJETIT TË GJASHTË TË KAPTINËS HUXHURAT

Kaptina Huxhurat, edhe pse është e shkurtër, ka një përmbajtje madhështore, sepse përmbledh çështje të një edukate të përrjetshme, është baza e një qytetërimi të lartë, madje nga disa interpretues të Kuranit njihet edhe si kaptina e moralit. Maksima “O ju që besuat”¹ e përsëritur pesë herë në këtë kaptinë, thekson edukatën që duhet të kultivojnë besimtarët në raport me Krijuesin e tyre dhe Pejgamberin a.s., duke mos vendosur për asgjë para se të konsultohen me Kuranin dhe Pejgamberin a.s., të mos ngrenë zërin dhe të mos ngërmohen pranë tij, ngase niveli dhe autoriteti i tij është i lartë, e jo si i njerëzve të tjerë të rëndomtë. Po ashtu, ajo thërret ata që në raport me njerëzit të jenë të kujdesshëm duke mos i vënë veshin çdo thënie, lajmi, e posaçërisht kur ajo e ka burimin prej ndonjë njeriu të padrejtë, të përpiqen për pajtim ndërmjet palëve të përçara e të ngatërruara dhe të mos tallen me njëri-tjetrin, të mos përgojnë, të mos vëzhgojnë çështjet intime të tjetrit, si dhe të mos formojnë bindje negative ndaj tjetrit. Përderisa maksima “O ju që besuat”- tregon faktin se Allahu i Madhëruar i thërret besimtarët në emër të besimit, emër i cili i

Edhe pse përdoruesit e rrjeteve sociale, statusi fetar dhe moral i të cilëve nuk dihet, nuk mund të përshkruhen drejtpërdrejt si njerëz të padrejtë, është e sigurt se ata janë të paktën njerëz të panjohur që mund të jenë edhe jo të ndërgjegjshëm.



veçon ata nga të tjerët, u kujton deklaratën e shehadetit dhe obligushmërinë e zbatimit të normave,² me pasthirmën “O ju njerëz”³ u vërteton origjinën e përbashkët të të gjithë njerëzve.

Krahas parimeve të ndershmërisë, drejtësisë, paqes, respektit të ndërsjellë dhe tolerancës, të cilat zgjidhin nga rrënjët shumë probleme sociale, në këtë kaptinë është dhënë një paralajmërim që mos të i vihet veshi çdo thënieje: “O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm ju sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë.”⁴ Pra, udhëzon besimtarët që të jenë të durueshëm dhe t’i kushtojnë vëmendje saktësisë së thënieve që shkojnë e rikthehen mes tyre, në mënyrë që të mos prishet rendi shoqëror dhe të mos hyjë mes tyre përçarja dhe mosmarrëveshja për shkak të gjërave jo të vërteta.⁵ Ngase kërcënimi më i madh për themelet e shoqërisë islame është mbështetja në thënie me burim të mjegullt dhe në marrjen e vendimeve kundër njëri-tjetrit duke u bazuar në to pa i shqyrtuar siç duhet.

SHKAKU I ZBRITJES SË AJETIT

Në literaturën e tefsirit, si shkak i zbritjes së këtij verseti kuranor, përmendet se Harith bin Darar Huzai, pas pranimit të Islamit, i thotë Pejgamberit a.s. se do të shkojë te populli i tij t’i thërras në fe, nëse pranojnë do ta mbledhë zekatin e tyre. Me të kuptuar se ata kishin pranuar Islamit dhe kishin dhënë zekatin, Pejgamberi a.s. e dërgon Velid ibni Akabën që ta sjellë zekatin. Velidi nisat, por i frikësuar kthehet në gjysmë të rrugës dhe shkon te Pejgamberi a.s. me lajm të rremë se Harithi deshi ta vrasë dhe nuk i dha zekatin. Pejgamberi a.s. e dërgoi një ekip kundër Harithit, por posa dalin ata prej Medinës, e takojnë atë duke sjellë zekatin. Me këtë rast

kuptohet se Velidi kishte gënjer”⁶ Sipas komentatorit Er Razi, ky ajet u shpall në kuptim të përgjithshëm për të theksuar se fjala e të pandërgjegjshmit nuk duhet besuar dhe se duhet shqyrtuar mirë në mënyrë që të mos dërgojë deri te polemika dhe përçarja e besimtarëve. Përveç kësaj, ai thekson se nuk ka asnjë shpjegim në Kuran apo hadithe se ky ajet është shpallur vetëm për këtë ngjarje.⁷ Pra besimtarët duhet të jenë mendjemprehtë dhe vigjilentë, nuk duhet të nxitojnë në pranimin e ndonjë thënie a lajmi, pa e shqyrtuar atë ngase ai mund të mos jetë i vërtetë e si rrjedhojë ata të bien pre e tij.

LIDHMËRIA E DISA KONCEPTEVE TË PËRMENDURA NË AJET ME LAJMET JOREALE

Në versetin e gjashtë të kaptinës Huxhurat, zënë vend disa koncepte, si: fasik, nebe dhe tebejjun, të cilat në ditët e sotme mund të shqyrtohen brenda kontekstit të informimit dhe janë kyçe për burimin e lajmeve dhe mënyrën e pranimin dhe perceptimit të tyre në këndvështrimin kuranor. I Madhërishmi ka thënë: “O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm (fasik)...” Koncepti “fasik” që në periudhën paraislamike i përdorur në masë të madhe për bimët dhe kafshët në leksik ka kuptimin “të thyesh, të nxjerrësh diçka nga vetja e saj, të kalosh një kufi të caktuar” etj.⁸ Ndërsa në periudhën islame, ky koncept fitoi një kuptim më të veçantë si “lajthitje nga rruga e drejtë, dhe mosbindje ndaj urdhrave të Allahut”, dhe me këtë shprehje në formën “fasik” filluan të përshkruhen si politeistët, çifutët, të krishterët dhe hipokritët, po ashtu edhe myslimanët që veprojnë kundër urdhrave të Zotit.⁹ Komentatori Kurtubiu, përkufizon fasikun si “një individ që gënjen, bën mëkate haptazi dhe nuk ka turp nga Krijuesi i tij”.¹⁰ Nisur nga ky fakt, meqenëse fasik paraqet individin që bën mëkate duke mos zbatuar urdhrat e Zotit

dhe është i zhveshur nga cilësitë e së vërtetës dhe ndershmërisë, në këtë koncept përfshihen edhe ata që shpifin për njëritjetrin po ashtu edhe ata që u përcjellin të tjerëve lajme, saktësia e të cilave nuk dihet. Andaj një besimtar që nuk shqyrton thëniet e sjella nga një “fasik”, nuk mund të mbrohet nga gënjeshttrat, shpifjet dhe mizoria të cilat janë vet llojet e fiskut. Në ditët e sotme, me përhapjen e llogarive të shumta të dyshimta në mediat sociale, është vënë në dyshim edhe saktësia e informacioneve që shpërndahen gjithandej nga individë të panjohur e që në mësimet islame nuk pranohen si të sakta dhe njihen si “mexhhulu’l-ajn” – lajme të një individi të panjohur. Ndërsa urtësia e përgjithshme që vihet në pah në këtë ajet është fakti që besimtarët duhet të jenë përherë vigjilentë e të matur në filtrimin e thënieve, e posaçërisht kur ato kanë burim nga ndonjë njeri që nuk është aq i drejtë apo ndjeshmëritë fetare të të cilit nuk i dihen dhe të mos bëjnë gjykime dhe të ndërmarin veprime në bazë të tyre.

Zoti i Madhërisëm në këtë verset kuranor shprehjen “nebe” e sjellë në formë të pashquar që ka kuptimin lajm (pra çfarëdo lajmi), dhe thekson se duhet të kihet kujdes nga të gjitha llojet e lajmeve të sjella nga kushdo që ka cilësi të liga. Thua se thuhet: “Hulumtoni, shqyrtoni çdo lajm/thënie që iu transmetohet nga individë të pandërgjegjshëm.”¹¹ Ngase çdo lajm/thënie, burimi i të cilit është i pasigurt dhe i paqartë konsiderohet si dyshimtë. Të imitosh diçka thjesht duke thënë se të tjerët po e bëjnë atë, pa dije, do të thotë t’i nënshtrosh hamendjeve, gjë që është e ndaluar në Kuran.¹² E.v., mjedisi tërheqës i shoqërisë apo i mediave sociale dhe fakti që shumë njerëz ndajnë të njëjtën gjë nuk duhet të jenë faktorë që një besimtar të shpërndajë atë që nuk është i sigurt në vërtetësinë ose saktësinë e saj. Sepse aty ku nuk ka të dhëna të sigurta, flet hamendja dhe ajo shpesh mund ta çojë njeriun drejt gabimit dhe mëkatit. E në Kuran, në lidhje me këtë thuhet: “O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat...”¹³ Si rrjedhojë, mund të konsistohet se plasimi i lajmeve/thënieve, saktësia e të cilave nuk është e sigurt bëhet shkak për dëmtimin e individit dhe shoqërisë, veprime këto që nuk janë të parëndësishme te Zoti. Këtë e vërtetojnë dhe ajetet,¹⁴ të cilat flasin mbi shfaqësinë e Aishes r.a., për të cilën hipokritët filluan një propagandë të djallëzuar, gjegjësisht e akuzuan atë për shkelje kurore. Këto ajete konsiderohen jashtëzakonisht të rëndësishme për të treguar qëndrimin që duhet të mbajnë besimtarët përballë lajmeve/informacioneve të trilluara dhe të pasakta.

Më pas rrëfimi në këtë ajet vazhdon duke treguar për edukatën në pranimin e informacionit të tillë: “Nëse ndonjë i pandërgjegjshëm ju sjell ndonjë lajm, ju shqyrtojeni mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë.”¹⁵ Ibën Kajimi, pas

sqarimit të konceptit “tebejjenu” në vargun kuranor, thekson se Zoti i Madhërisëm nuk ka urdhëruar mospranimin dhe mohimin e menjëhershëm të lajmit të sjellë nga i pandërgjegjshmi, apo në kuptimin më të gjerë nga individë të panjohur, por ka urdhëruar kërkimin dhe vërtetimin e saktësisë së tij në bazë të argumenteve të tjera përreth dhe më pastaj të veprohet me të.¹⁶ Rrjedhimisht është pjesë e besimit të shqyrtohet saktësia e thënieve para se të veprohet me të. Këtë e dëshmon dhe vetë maksima “o ju që besuat”, me të cilën fillon ky ajet kuranor. Prandaj besimtari duhet ditur se mos shqyrtimi i saktësisë së një lajmi dhe plasimi i tij te të tjerët duke dëmtuar individin e pafajshëm është shkak i shumë përçarjeve brenda shoqërisë dhe bie ndesh me parimet islame. Në lidhje me këtë, në Kuran thuhet: “Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse dëgjimi, shikimi dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.”¹⁷ Zoti i Madhërisëm me këtë ajet, paralajmëron njeriun që të mos flasë për diçka që nuk e di dhe të mos veprojë me gjëra që nuk ka njohuri mbi saktësinë e tyre.¹⁸ E gjithë kjo, udhëzon besimtarët në mos nxitimin për të besuar dhe shpërndarë lajmin e dëgjuar ose shkruar nga individë të pandërgjegjshëm apo të panjohur të cilëve nuk u dihet përkatësia dhe qëllimi final.

Nga mësimet që nxirren nga ky ajet mund të konstatohet se përveç shpërndarjes së informatave direkte e të zakonshme, edhe ato në rrjetet sociale të bëra nga individë që njihen si “fasik” dhe të dyshimtë duhet të filtrohen nga ana e besimtarëve. Në të njëjtën kohë, përveç shpifjes, pëlqimi i lajmeve, përveç nëse verifikohen nga burime të besueshme, shpërndarja e tyre dhe në këtë mënyrë shkaktimi i dëmit material ose moral ndaj të tjerëve është padrejtësi ndaj tyre dhe sjellë dëme të mëdha në shoqëri. Duke pasur parasysh se të gjitha llojet e komunikimit po zhvendosen me shpejtësi drejt mjediseve virtuale, myslimanët duhet të kenë parasysh që t’u përmbahen rregullave fetare dhe morale, siç bëjnë në jetën e tyre reale.

1 Huxhurat, 49/1, 2, 6, 11, 12.

2 Ebussuud, Irshadu’l-Akli’s-Selim, v. VIII/115.

3 Huxhurat, 49/13.

4 Huxhurat, 49/6.

5 Abdullah Siraxheuddin, Havle Tefsiru sureti’l-Huxhurat, fq. 67

6 Taberi, Xhamiu’l-bejan, XXI/350-352.

7 Razi, Mefatihul’l-Gayb, XXVIII/119.

8 El Xheheri, Es Sihah, v. IV/1543; El Isfahani, El Mufredat, fq.381.

9 Nesefi, Medarik, v. III/351.

10 Kurtubi, El Xhamiu’l-Ahkam, XIX/368.

11 Zemahsheri, El Keshshaf, V/1035.

12 En’am, 6/116, 148; Junus, 10/36, 66; Huxhurat, 49/12; Nexhm, 53/23, 28.

13 Huxhurat, 49/12.

14 Nur, 24/15.

15 Huxhurat, 49/6.

16 Ibën Kajjim el Xhevzi, Bedai’ut-Tefsir, v. III/6.

17 Isra, 17/36.

18 Maverdi, En Nuket, v. III/243; Kurtubi, El Xhamiu’l-Ahkam, v. XIII/77.

Morali islam përballë sfidës së modernitetit

Ervin Kylafku

Dinamika dhe ndryshimi është atribut i krijesave, fundja Allahu, pandryshueshmërinë e ka lënë si ekskluzivitet i qenies së Tij. Ndërsa ne njerëzit jemi pandashmërisht pjesë e transformimeve. Edhe nëse mundohemi të tregohemi stoikë ndaj një mori qëndrimesh apo rregullash të trashëguara që kanë sistemuar jetën dikur, prapë nuk ia dalim dot. Me hyrjen në epokën e ndryshimeve të mëdha, bota është shndërruar në një fshat të vogël siç i thonë fjalës. Konceptet për jetën si dhe shumë ide të cilat ishin të pa negociuara më parë, sot konsiderohen të vjetërsuara dhe pjesë e muzeut të memories së historisë.

Teknologjia ka afruar çdo largësi, globalizmi nga ana e tij ka shembur kufijtë ndarës. Çdo gjë është më afër se kurrë, kufijtë tashmë janë vetëm imagjinarë. Vlerësimi për çdo gjë ka ndryshuar, po a vlen të thuhet kjo edhe për moralin? Por ç'është morali, cili është përkufizimi i tij? Thuhet që kjo fjalë e ka origjinën nga latinishtja *moralis* që janë veset, doket dhe zakonet, ndërsa sipas fjalorit të gjuhës shqipe, morali është “tërësia e parimeve, e normave dhe e rregullave që janë krijuar e ndryshojnë historikisht në kushte të caktuara ekonomiko-shoqërore dhe që përcaktojnë sjelljen e veprimtarinë e njerëzve në shoqëri”.¹ Pra kemi të bëjmë me rregulla, parime ose norma të sjelljes të paravendosura nga një shoqëri, bashkësi, dhe të pranuar nga njerëzit për mënyrën e tyre të sjelljes dhe të zbatueshme nga ata. Ndërsa në gjuhën arabe, termi “moral” i përshtatet fjala “khuluk”,² që në kuptimin leksikor do të thotë “shprehje, natyrë, karakter”. Që nënkupton ato karakteristika të jetësuar te njerëzit, të cilat i japin atyre mundësinë, që në kushte normale, pa u ushtruar mbi ta asnjë

formë presioni të bëjnë lirshmërisht zgjedhjet e tyre.

Thuhet që njeriu si qenie ndryshon çdo pesë vjet, pra nuk është më ai të cilin njihnim më parë. Kjo sepse qelizat e trupit të tij rigjenerohen si pasoje e proceseve lindje-vdekje të këtyre qelizave. Po ashtu ne jemi qenie që marrim dhe japim nga mjedisi ku jetojmë dhe është shumë e natyrshme që, sipas psikoanalistit Fromm, karakteri apo natyra jonë të pësojë disa “modifikime”, nëse do më lejohet ta quaj kështu. “Kjo në kundërshtim me dogmën mjaft të përhapur psikoanaliste, sipas së cilës mjedisi rrethues shkakton ndryshime thelbësore në zhvillimin e individit në foshnjëri dhe në fëmijërinë e hershme, kurse në të ardhmen karakteri, tashmë i formuar praktikisht, nuk ndryshon nën ndikimin e ngjarjeve të jashtme”.³ Fromm vendos theksin te fakti se “ka një shumicë shembujsh të asaj se ndryshimet rrënjësore të mjedisit rrethues çojnë drejt ndryshimesh thelbësore në sjelljen e njeriut: forcat negative pushojnë së marri mbështetje, kurse ato pozitive mbështeten dhe nxiten”.⁴

Çdo gjë është
më afër se
kurrë, kufijtë
tashmë janë
vetëm
imagjinarë.
Vlerësimi për
çdo gjë ka
ndryshuar, po
a vlen të
thuhet kjo
edhe për
moralin?

Normalisht që njerëzit kanë qenë aktorë të ndryshimeve strukturore sociale sa herë që kushtet social-ekonomike si dhe politike ia kushtëzonin atë. Ishin njëkohësisht edhe pjesë e lëvizjeve demografike në kërkim të një jete më të mirë. Myslimanët nuk përjashtohen gjithashtu nga ky fakt. Ata populluan edhe hapësira të cilat ishin të reja kulturalisht për ta, janë ballafaquar me koncepte të tjera për jetën, të panjohura më parë, me religjione të reja. Myslimanët janë njerëz me gjurmë në historinë e njerëzimit, veçanërisht në kontinentin evropian. Një përmbledhje të tillë brilante rreth kontributit të tyre na e sjell në memorie Lion Fojhtvanger në

hyrjen e romanit të tij “Çifutka e Toledos” ku tregon se zotërinjtë e rinj (myslimanët) kontribuuan si në infrastrukturën e qyteteve të Spanjës, por edhe në shkenca. Ata përkthyen po ashtu edhe mjaft vepra të filozofisë si dhe të lëmenjve të tjerë, duke mos përjashtuar asgjë, madje edhe Torën, librin e shenjtë të hebrenjve. Spanja u shndërrua në kryeqendrën e botës asokohe, arabishtja ishte gjuha e aristokracisë. Ata nuk dhuruan vetëm, por edhe morën, huazuan çdo kontribut njerëzor që ishte i dobishëm dhe që konsiderohej vlerë e shtuar. Dhe kjo ndodhi në çdo kohë, por sidomos në kohën e modernizmit, fillimet e të cilit datojnë disa shekuj më parë, ku kontributi i myslimanëve në këtë fashë të historisë kishte filluar turrjen. Ata ia kishin lënë stafetën e kërkimeve shkencore evropianëve, të cilët ishin divorcuar nga kisha dhe çdo gjë që lidhej me religionin sepse çdo marrëdhënie mes kishës dhe modernizmit e konsideronin në antagonizëm të skajshëm.

Natyrshëm lind një pyetje, se çfarë është modernizmi të cilin evropianët e kërkonin medoemos, qoftë edhe me gjakun e tyre? Pse donin t’ia zhvishnin kishës pushtetin e saj dhe kontrollin mbi çdo qelizë të shoqërisë si dhe çdo akt të individëve të saj? Pse kërkonin që çdo dukuri t’i gjenin përgjigje në arsye dhe jo në shkrimet e shenjta? Si dhe kur ka filluar kjo periudhë? Anthony Giddens, një nga sociologët më në zë bashkëkohorë, në librin e tij “Pasoja të modernizmit”, thotë: “Moderniteti u referohet modeleve të jetës shoqërore ose organizmave, të cilat u shfaqën në Evropë rreth shekullit XVII dhe u përhapën gjatë kësaj periudhe pothuajse anekënd botës.”⁵


Modernizmi që konsiderohet mënyrë jo-tradicionale jetese dhe organizimi shoqëror ka lidhje me Iluminizmin Evropian, periudhë që karakterizohej si largim nga besimi te Zoti dhe rritja e besimit tek arsyeja. Fillimisht kjo nënkuptonte kërkimin e burimit të së vërtetës jo më tek arsyeja hyjnore, por te vëzhgimi empirik dhe te mendimi racional. Në një kuptim më të përgjithshëm, modernizmi shënon ndërprerjen e rendit tradicional dhe shkëputjen nga tradita, nga mënyra tradicionale e të menduarit, të sjelljes dhe të organizimit institucional të shoqërisë, të cilat mbështeteshin në marrëdhëniet farefisnore, në ontologjinë fetare dhe në praktikatat tradicionale që ishin në mënyrë inherente (të qenësishme) konservatore.⁶

Kjo periudhë përshkruhet nga Fromm te libri i tij “Arratisje nga liria” si anatomizim i institucioneve, pra shpërbërja e

Modernizmi që konsiderohet mënyrë jo-tradicionale jetese dhe organizimi shoqëror ka lidhje me Iluminizmin Evropian, periudhë që karakterizohej si largim nga besimi te Zoti dhe rritja e besimit tek arsyeja.

tyre. Njeriu modern për të krijuar pavarësi prej çdo modeli të vjetër thërrmoi gjithçka në emër të lirisë, u shkëput nga farefisi, krijoi një mënyrë shumë individuale besimi, u largua nga familja, kisha, klasa e tij sociale, kufizimet që ia kishte vendosur më parë morali fetar dhe shoqëror. Ai krijoi një perceptim të ri për jetën, familjen, shoqërinë, fenë. Ky ishte rezultat i shumë shkaqeve, por mund të veçohet nga më kryesoret pushtetin që ushtronte kisha dhe kleri mbi çdo fashë të shoqërisë, pengesën që i bënte ajo zbulimeve shkencore, diturive të reja dhe refuzimin e çdo komenti të dukurive natyrore jashtë atij religjioz. U kryen shumë krime në emër të Zotit e për pasojë njerëzit u angazhuan seriozisht për të braktisur atë “zot” dhe shkrimet e shenjta që kleri i ofronte njerëzve.

Këto zhvillime si dhe të tjera social-ekonomike dobësuan lidhjet e forta shoqërore dhe njeriu u struk brenda familjes së tij për të shprehur interes më tepër për njerëzit më të afërt. Por nga ana tjetër, ky individ përbëhet nga dy pjesë esenciale, trupi dhe shpirti. Ndërkohë që ai do të largohej edhe nga bashkësia që i ofronte ushqimin shpirtëror, njeriu do të kërkojë për alternativën e munguar. Dhe për ta qetësuar shpirtin e tij nga lodhja, si dhe për ta bërë atë të ndihet i lumtur, do të angazhohej të përmbushte




dëshirat e tij me fantazitë më të shthurura. Megjithatë, ky individualizëm i tejskajshëm në emër të lirisë, kishte koston e tij, ai u ndie i vetmuar, i frikësuar për të ardhmen e tij, sepse i mungonte mbështetja e fisit, shoqërisë, miqve, bashkësia që purifikonin shpirtin e tyre së bashku në faltore. Njeriu modern u përball me sfida që i shkaktuan kriza të forta shpirtërore, morale, fetare, ekonomike, të cilat nuk i përkisnin një segmenti të caktuar kohor, por që e shoqërojnë ende në ditët tona, ndoshta me shumë se në çdo kohë tjetër. Po myslimanët a janë duke u përballur veçanërisht me krizat e moralit? E nëse edhe ata janë pjesë e transformimeve shoqërore që synojnë edhe moralin, si duhet t'i shmangen deformimeve të tij? Normalisht myslimanët janë të urdhëruar që të jenë pjesë integrale e shoqërisë, e jo të veçuar ose të izoluar.

Të jesh aktiv do të thotë që të përballesh çdo ditë me sfidat e arsimit, kulturës fetare dhe me sjelljen. Do të thotë të kesh gjurmët tua në ruajtjen e të natyrshmes dhe njerëzores nga çrregullimi i madh që po i ndodh turmës. Të angazhohen në betejat të reja, në fusha gjithnjë e më të ashpra, sidomos në ato që quhen politikatat e identitetit, e të cilat inkurajojnë pakicat që të dëgjohen ose edhe të favorizohen. Por jo vetëm të dëgjohen e të inkurajohen, por edhe t'i imponojnë pjesës tjetër të njerëzve, që janë në fakt shumicë, të gëlltisnin pretendimet e reja të pavërtetuara shkencërisht. Procesi i çrregullimit të kulturës është duke përparuar frikshëm me hapa shumë të pabesueshëm, sidomos kur ai mbështetet nga grupe interesi, që nxjerrin përfitime nga ky proces. Megjithatë, myslimani që jeton në kohën e modernizmit, duhet të ndihet privilegjuar, sepse ai ka mbështetjen e duhur për t'i përballuar me sukses këto sfida të vështira. Ai ka librin e Zotit, Kuranin, që i ka rezistuar ndryshimeve dhe falsifikimit. Zoti ia kujton atij këtë fakt, ku në ajetin 9 të sures Hixhr thotë: “Ne e kemi zbritur Kuranin dhe Ne do e mbrojmë atë.” Dhe padyshim, përderisa ai ka qëndruar autentik, në përmbajtjen e tij, myslimani përveç të tjerash gjen koncepte morale që nuk i tjetërson dot koha dhe rrethanat shoqërore. Këto koncepte janë burimi i tij kryesor i ushqimit të shpirtit dhe mendjes, si dhe orientim për t'u rreshtuar në anën e duhur në kohë trazirash dhe shthurjesh që sfidojnë moralin.

PARA SË GJITHASH, MORALI ISLAM ËSHTË ME BURIMIN HYJNOR

Mund të thuhet se të gjitha parimet e Kuranit, tek i cili shpalosen në formë fjalësh të gjitha të vërtetat që ekzistojnë në univers, mund të reduktohen në dy grupe: a) parimet e besimit monoteist islam në Allahun si Zoti i vetëm universit dhe: b) parimet ose rregullat morale. Madje, që të dyja këto baza synojnë moralin, sepse të gjitha urdhrat janë, në të njëjtën kohë, domosdoshmëri rregullash morale, por edhe ndalimet janë gjërat që bien në kundërshtim me këto rregulla.



Për këtë arsye që, kur e kanë pyetur Aishen, pas vdekjes së Profetit, se si ishte morali i tij, ajo u është përgjigjur: “Morali i tij ka qenë Kurani!”⁷⁷

Në fakt, edhe Pejgamberi a.s. vetë, duke u shprehur si në vijim, pothuajse e ka fokusuar te morali shkaku e dërgimit të tij: “Unë jam dërguar vetëm për ta plotësuar moralin e lartë!”⁷⁸

Edhe Kurani në shumë pjesë të tij jep shembuj konkretë mbi moralin. Allahu thotë në suren Enbija, ajeti 107: “Fali njerëzit! Urdhëroi për të mirë ata dhe kthejua shpinën injorantëve!” Ndërsa në suren Fusilet, ajeti 34-35 thuhet: “Dhe e mira me të keqen nuk mund të barazohen! Dhe largoje ti të keqen me anë të më së mirës! Dhe atëherë do të shohësh që personi që ka ndonjë armiqësi ndaj teje, të bëhet si një mik i ngushtë!”

Po ashtu në suren Huxhurat, ajeti 12 thuhet: “O ju që keni besuar! Ruhuni nga pandehmat, sepse disa pandehma janë rënduese. As hetime mos bëni dhe mos e merrni nëpër gojë njëri-tjetrin pas shpine! A mos dëshironi të hani mishin e vëllait të vdekur? Pra, u neveritët! Atëherë, pra, kini frikë Allahun, sepse Allahu është pranues i pendësës dhe shpërblyes!”

MORALI NË ISLAM MBËSHTETET NË ARSYEN

Filozofët racionalistë të cilët e konsiderojnë arsyen një lloj “zoti” që ka një fuqi të pakufizuar, pranojnë për bazë të sjelljeve morale, “lirinë e vullnetit” dhe “aftësinë zgjedhëse”.

Kjo pikëpamje është parashtruar nga Islami shekuj më parë prej tyre. Vetëm se arsyeja nuk zotëron fuqi të pakufizuar siç mendojnë ata. Kjo sepse, sipas këndvështrimit islam, arsyeja duhet të vlerësohet nga një burim absolut informacioni. Megjithatë mes arsyes (akl) dhe informacionit absolut të

përcjellë (nakl), nuk ka ndonjë kundërvënie apo kontradiktë. Vetëm se në informacionin e përcjellë ka shprehje, pohime dhe deklarata që e kapërcejnë arsyen, që dalin jashtë kompetencës dhe fuqisë së arsyes. Si rrjedhojë, besimi realizohet me vërtetim jo me arsye, por me zemër. Megjithëkëtë, në shprehjet, pohimet dhe deklaratat e informacionit të përcjellë që është produkt i shpalljes hyjnore, ekziston një paralelizëm me arsyen. Edhe urdhrat morale janë të këtij lloji. Kuptimi i kësaj është që çdo gjë e miraton arsyeja e kulluar e pa korruptuar, është morale, dhe çdo gjë nuk e miraton ajo, është jo morale. Duke e pranuar këtë, botëkuptimi islami vë edhe një kusht tjetër për vlerësimin e akteve: qëllimin për se kryhen.

Profeti a.s. ka theksuar: “Aktet janë sipas qëllimeve.”⁹ Dhe po ashtu ka thënë: “Qëllimi i besimtarit është më i dobishëm se akti i tij.”¹⁰ Ai po ashtu ka porositur: “Allahu i Lartë nuk pranon tjetër akt përveç atij të kryer vetëm e vetëm për pëlqim të Tij!”¹¹ Rregullat morale janë si një mbështjellëse, si një kornizë për konkluzionet juridiko-fetare. Sepse qëllimi përfundimtar i Islamit është t’i bëjë njerëzit të arrijnë në një qytetërim virtytesh, pavarësisht karakterit social të shoqërisë ku jeton ai, si dhe epokës, qoftë moderne apo edhe nëse nuk i ka arritur standardet e shoqërisë moderne. Këto virtyte realizohen në saxe të nivelit të lartë moral të sjelljeve. Qëllimi i besimit dhe adhurimeve është që, duke e përforcuar besimin tek Allahu dhe duke e rrënjësuar në zemër, krahas dashurisë për Të, edhe frikën prej Tij, të sigurohet realizimi i sjelljeve morale me vullnet të lirë.

MORALI ISLAM KA PRIORITET SOCIAL

Në Islam u është kushtuar një rëndësi e veçantë sjelljeve morale që u sigurojnë dobi të gjithë shoqërisë. Nga ana tjetër, në Islam, përgjegjësia është individuale, domethënë, çdo njeri meriton shpërblim ose ndëshkim për aktin ose veprimtarinë e vet personale. Megjithëkëtë, kur rezultatet e veprimtarisë së dikujt prekin për mirë apo për keq të tjerët, kjo situatë përbën përjashtim për rregullin si më sipër. Këtu vlen të përmendet një hadith profetik i cili tregon një përjashtim lidhur me akte dhe veprime, dobia apo dëmi i të cilave përfshin edhe të tjerë: “Kush i hap rrugën një veprimi të mirë, ai do të marrë shpërblimin e asaj vepe dhe shpërblimin e atyre që do të veprojnë me të, pa iu pakësuar gjë prej tyre. E ndërsa kush i hap rrugën një veprimi të lig, ai do të marrë shpërblimin e asaj vepe dhe shpërblimin e atyre që do të veprojnë me të, pa iu pakësuar gjë prej tyre.”¹² Pra përgjegjësia nuk është vetëm individuale, ajo bëhet akoma më e madhe kur e mira ose liga masivizohet. Po të vihet re me kujdes, atyre të cilëve nuk u mbyllet libri i punëve, por vazhdojnë të fitojnë të mira sikur të ishin në veprim, janë ata që, me veprat e tyre të cilat vazhdojnë të shërbejnë, vazhdojnë të bëhen të dobishëm për gjithë shoqërinë.

MORALI NË ISLAM ËSHTË MBROJTËS I DINJITETIT TË INDIVIDIT

Në çdo situatë, ruajtja e personalitetit të njeriut është kusht. Shumë urdhra islamë janë formuluar për të mbrojtur seriozitetin dhe dinjitetin e besimtarëve. Për shembull, besimi islam nuk e inkurajon kërkimin e lëmshës, e megjithëkëtë ka ndaluar pengimin e lypsarëve. Nga ana tjetër ka nxitur dhe inkurajuar cilësinë e dhënësit duke deklaruar se “dora që jep është më e çmuar se dora që merr”.¹³ Përveç dhënies të detyrueshme, si për shembull zekati, kjo fe e cila urdhëron të mbahen gjallë lidhjet farefisnore si dhe të ndihmohen njerëzit e afërm, të varfrit dhe udhëtarët. Edhe mënyrën e dhënies së ndihmës e ka treguar në një mënyrë që i mbron dinjitetin e marrësit, ku thuhet se “sadikanë në fillim e merr Allahu”.¹⁴

Pra, në konkluzion të asaj që u përmend më lart, Islami i porositi pasuesit e tij që t’u përmbahen udhëzimeve të dritës hyjnore, të jenë solidarë, të dobishëm, t’i kryejnë obligimet ndaj Allahut së bashku si dhe të bëjnë punë komunitare, të mos jenë individual, që të përballojnë rrymën e fortë të asimilimit fetar, kulturor, moral. Kurani ofron një paketë udhëzimesh, të cilat e bëjnë myslimanin imun në çdo kohë dhe hapësirë ndaj çdo ideologjie, fryme dhe mentaliteti. Ata duke qenë pasues rigorozë të mësimave të Kuranit famëlartë, koncepteve për individin dhe shoqërinë, raportet që këta duhet të ndërtojnë së bashku, atëherë shoqëria jonë bashkë me individët e saj, do t’i shmangen ndikimit esencial të transformimeve shoqërore dhe do t’i shpëtojnë vetmisë, varfërisë shpirtërore, frikës nga e ardhmja, shthurjes morale, si dhe asimilimit kulturor dhe religjioz. Dhe për më tepër, besimtari do pajiset me imunitetin e mjaftueshëm për të përballuar sfidat e epokës sonë të modernizmit.

- 1 Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 1980, fq 1165.
- 2 Mexhudin el Fejruz Abadi, *El Kamusul Muhijt*, Bejrut, Dar el Fikr Publishing, 2008, 793.
- 3 Erich Fromm, *Të kesh apo të jesh*, Tiranë, Shtëpia Botuese “Fan Noli”, 2008, 124.
- 4 Po aty.
- 5 Anthony Giddens, *Pasojat e modernizmit*, Tiranë, UETPRESS, 2013, 1.
- 6 Po aty, xiii.
- 7 Ahmed ibën Hanbel, *El Musned*, Kajro, Darul Hadith, 1995, 24482.
- 8 Muhamed ibën Idris el Buhari, *El Edul Mufred*, Damask, Dar Ibën Kethir, 2007, 273.
- 9 Muhamed ibën Ismail el Buhari, *Sahihul Buhari*, Riad, Darussalam, 1999, 1.
- 10 Ebul Kasim et Taberani, *Muxhemu el Kebir*, Kajro, Ibën Tejmiye publishing, 5942.
- 11 Ahmed ibën Shuajb en Nesai, *Sunenu Nesai*, Riad, Darul Hadarah, 2015, 3140.
- 12 Ebul Husejn Muslim en Nejsaburi, *Sahihu Muslim*, Riad, Darussalam, 2000, 1116.
- 13 Muhamed ibën Ismail el Buhari, *Sahihul Buhari*, Riad, Darussalam, 1999, 1427.
- 14 Muhamed ibën Ismail el Buhari, *Sahihul Buhari*, Riad, Darussalam, 1999, 1410.

Inteligjenca Artificiale – IA, dilemat, problemet dhe e ardhmja

Prof. ass. dr. Ferdi Kamberi

Historia e njerëzimit është e mbushur me plotë ide, ngjarje, probleme, sfida, zhvillime, luftëra, ngritje dhe rënie, të cilat e kanë përcjellë njerëzimin gjatë tërë këtij cikli historik deri më sot. Padyshim se me zbulimin e rrotës, njerëzimi në aspektin progresiv është zhvilluar dhe ka filluar të krijojë një stad tjetër të zhvillimit, i cili ka qenë bartësi ose motori kryesor për zhvillimet e tjera. Zhvillimi i dytë i rëndësishëm merret zbulimi i makës me avull nga James Watt në vitin 1650 në Angli, i cili dha një hov të madh në zhvillimin e industrializimit, zhvillimin ekonomik dhe zhvillimeve të përgjithshme deri në shekullin XX. Pas kësaj, kemi periudhën e fordizmit dhe post-fordizmit, si periudha të cilat patën ndikim jashtëzakonisht të lartë në ‘boomin’ ekonomik deri në vitet 80-ta, ku atëherë fillojnë zhvillimet e reja sidomos përdorimi i teknologjive të reja të cilat dikur as që ishin menduar. Zhvillimet nga vitet 90-ta e deri më tani si duket janë shndërruar në një ‘*revolucion tekniko-teknologjik dhe informatik*’, të cilat përveç që kanë sjellë risi anembanë botës, padyshim se me vete mbartin edhe një mori paqartësish, sfida, e probleme të theksuara, për të cilat ndoshta njerëzimi nuk është ende gati, por megjithatë ato po ndodhin! Së pari, shpërfaqja e Covid-19 në një ose tjetrën mënyrë ishte edhe një test për botën bashkëkohore që të përgatitën për dekadat e ardhshme për adoptimin e një forme të re të komunikimit, teknologjisë, zhvillimit dhe sfidave. Së dyti, ky test pothuajse u bë faktik me rastin e lansimit të IA-së ose Inteligjencës Artificiale, e cila tashmë ka shtrirë rrënjët e saj në mbarë botën. Por çka në të

Zhvillimet nga vitet 90-ta e deri më tani si duket janë shndërruar në një ‘*revolucion tekniko-teknologjik dhe informatik*’, të cilat përveç që kanë sjellë risi anembanë botës, padyshim se me vete mbartin edhe një mori paqartësish, sfida, e probleme të theksuara, për të cilat ndoshta njerëzimi nuk është ende gati

vërtetë është Inteligjenca Artificiale? Cilat janë efektet e saj? Si do të ndikon në krizat globale? Cilat janë përparësitë apo dobësitë? Po dilemat? Apo kjo nuk është e gjitha? Janë disa pyetje të cilat aktualisht janë ngritur si formë e hipotezave në diskursin sociologjik global. Qysh herët, Johan Gunther, kishte theksuar se “si rezultat i zhvillimeve të fundit në epokën e digjitalizimi, njerëzit mund të ndahen në dy kategori: a) Vendasit digjital dhe b) Imigrantët digjital. Në grupin e parë hyjnë personat të cilët janë rritur me teknologjinë informative, sidomos me atë virtuale, ndërsa në të dytin ata me moshë më të vjetër, të cilët e kanë problem përshtatjen me zhvillimet rapide të kësaj teknologjie”¹ Ndaj, këto zhvillime të cilat po ndodhin sot janë vazhdimësi e zhvillimeve dhe të cilat me siguri se do të sjellin ndryshime të mëdha, si në aspektin individual po ashtu edhe atë kolektiv. Inteligjenca Artificiale nuk është edhe e re, pasi ajo është pasuese e një sërë programeve apo sistemeve të krijuara më parë, si: TURING TEST në vitin 1950, A. I. BORN në vitin 1955, UNIMATE në vitin 1961, ELIZA në vitin 1964, SHAKEY në vitin 1966, DEEP BLUE 1997, KISMET në vitin 1998, AIBO në vitin 1999, ROOMBA në vitin 2002, SIRI në vitin 2011, WATSON në

vitin 2011, EUGENE në vitin 2014, ALEXA në vitin 2014, TAY në vitin 2016 dhe ALPHAGO në vitin 2017”². Inteligjenca Artificiale – AI, është simulimi i proceseve të inteligjencës njerëzore nga makinat apo sistemet kompjuterike. Në fakt, IA i “referohet sistemeve që shfaqin sjellje inteligjente duke analizuar mjedisin e tyre dhe duke

ndërmarrë veprime – me një farë mase autonomie – për të arritur qëllime specifike”.³ IA e njohur ndryshe edhe si ‘ChatGPT’ tashmë është një realitet i cili është duke ndodhur anembanë botës. Janë me dhjetëra sajte të cilat kanë një sistem të tillë, por edhe një mori e aplikacioneve si në sistemin e IOS-it po ashtu edhe në sistemin e Android-it. Disa prej tyre mund t’i nënvizojmë, si: *YesIA, IACHat, Bing, Jarvis, AskIA, ChatIA, AIChat, ChatGPT*, etj., të cilat kanë lehtësuar punën e njerëzimit në përgjithësi. Ky sistem është i lehtë e i qasshëm dhe në të mund të kenë qasje të gjithë qytetarët. Sistemi është një mundësi e mirë për të ndihmuar njerëzit dhe shoqërinë në përgjithësi për zgjidhjen e problemeve komplekse, detyrave, gabimeve gjuhësore dhe teknike, marrjen e informatave të ndryshme, parashtrimin e pyetjeve të shumta, e kështu me radhë. Për përdorimin e sistemit nevojitet interneti dhe një nga sajtet apo aplikacionet, disa nga to kanë një pagesë minimale, kurse tjerat janë edhe falas.

EFEKTET, SHKATHËSITË DHE TIPAT E IA-SË

Një ndër qëllimet kryesore të AI-së padyshim se është lehtësimi i punës së njeriut, ku mjafton që të hymë në këto rrjete dhe të pyesim rreth temave të ndryshme që nga feja e deri tek inteligjenca artificiale dhe do t’i marrim ato informata dhe atë edhe në gjuhën shqipe. Studimet tregojnë se pesë shkathësitë kryesore të IA-së janë:

1. Interaktivi; 2. Shërbimet; 3. Analiza; 4. Njohuritë/dijet; dhe 5. Monitorimi.⁴

E para, ky sistem mundëson që të komunikoni me inteligjencën artificiale, t’i bëni pyetje dhe të merrni përgjigje. Së dyti, ofron shërbime, mjafton që të shkruajmë një paragraf apo më shumë qoftë në gjuhën shqipe apo për korrigjim në gjuhën angleze dhe do të befasonemi për shërbimin e ofruar nga IA. Së treti, analizimi i të dhënave, ku sistemi mundëson të dhëna të reja dhe trende aktuale në nivel global. Ky fakt ndihmon shumë shkencëtarët, studiuesit, studentët, individët e ndryshëm, por edhe qytetarë të thjeshtë të kenë qasje në shumë informata, për të cilat dikur as që kanë imagjinuar. IA “i bën sistemet qendrore shumë herë më efikase se sa sistemet e shpërndara, sepse të nxënit automatik funksionon më mirë kur ka një sasi më të madhe të informacionit për të analizuar”.⁵ Një hap tjetër me rëndësi janë edhe njohuritë që ka sistemi, megjithëse në disa raste kur ka informacion të limituar, thekson se ky informacion është i kufizuar dhe nuk ka mundësi për më shumë informacion. Në fund, është edhe procesi i monitorimit përmes së cilës ka qasje në monitorimet e ‘të dhënave’ të bizneseve, programeve, pasqyrave të ndryshme financiare, si dhe të dhënave të tjera relevante për të cilat njeriu sot ka nevojë. Ndërsa, sa u përket tipave ose llojeve të AI-së, studimet theksojnë për katër forma të këtij sistemi, si:

IA reaktive - përdor algoritme për të optimizuar rezultatet bazuar në një grup të dhënash.

IA me memorie të kufizuar - mund të përshtatet me përvojën e kaluar ose të përditësohet në bazë të vëzhgimeve ose të dhënave të reja.

Inteligjenca artificiale e teorisë së mendjes - është plotësisht e adaptueshme dhe ka një aftësi të gjerë për të mësuar dhe mbajtur përvojat e kaluara.

Inteligjenca artificiale e vetëdijshme - siç sugjeron emri, bëhen të ndjeshme dhe të vetëdijshme për ekzistencën e tyre”.⁶

Së fundi, është lansuar edhe modeli ‘GTP4 - <https://www.gpt-4insight.com>’, një sistem mjaft i avancuar sesa sistemet e mëparshme, e i cili kryen punë të mëdha pothuajse në çdo aspekt. Në rastin e Kosovës, shohim se ky sistem është adaptuar shumë me lehtësi pasi që Kosova edhe shfrytëzon internetin qysh herët dhe në raport me vendet tjera prin për nga shfrytëzimi i internetit. Të dhënat nga platforma ‘DatePortale’ nënvizojnë se “në janar të vitit 2023 në Kosovë kishte 1.60 milionë përdorues të internetit. Shkalla e penetrimit të internetit në Kosovë ishte 96.6% e popullsisë së përgjithshme në fillim të vitit 2023. Analiza e Kepios tregon se përdoruesit e internetit në Kosovë janë rritur për 3,773 (+0.2%) ndërmjet 2022 dhe 2023”.⁷ Duke parë rolin dhe rëndësinë që ka interneti dhe shfrytëzimin e tij nga ana e shoqërisë kosovare, si dhe së fundi fluksin e migrimeve dhe mungesën e fuqisë punëtore, së fundi bizneset kosovare kanë filluar që punëtorët t’i zëvendësojnë me robot të cilët kanë AI. Kësisoj, një kompani që furnizon Kosovën me robot ka theksuar se “për dy vite i kanë funksionalizuar 10 robotë, të cilët më punën e tyre e kanë shtuar fitimin e



kompanive e po ashtu e kanë rritur edhe numrin e punëtorëve në këto biznese. Njëri nga prodhuesit vendor tregon se me instalimin e robotit i ka zëvendësuar 4 punëtorë, të cilët po kryejnë punë të tjera në kompani e nuk po detyrohen që për 8 orë në punë të zhvendosin thasë me peshë 25 kilogramësh.⁸ Ndoshta ka të drejtë Friedman kur thekson se “robotikët janë projektuar qartë për zëvendësimin e krahut të punës. Qëllimi i parë do të jetë zëvendësimi i krahut të punës që nuk është më i disponueshëm. Qëllimi i dytë do të jetë për të këmbyer krahun e punës të disponueshme për të mbështetur robotikët. Qëllimi i tretë nga ku fillon problemi do të jetë zëvendësimi i drejtpërdrejtë i punëtorëve”.⁹ Kjo tregon se gradualisht këta robotë, falë teknologjisë së fundit do të zëvendësohen me njerëz dhe do të kryejnë procese të shpejta, të cilat ndoshta njeriut do t’i duhej më shumë kohë dhe energji për të njëjtin proces, por që do të paguhej më pak.

PROBLEMET, SFIDAT DHE E ARDHMJA

Deri më tani pamë vetëm një rën anë të medaljes së IA -së, profitet, përparësitë dhe padyshim se më e rëndësishmja është dhënia e informatave dhe shërbimeve të ndryshme për të cilat ka pasur nevojë njeriu. Në anën tjetër, shumë studime nënvizojnë edhe problemet dhe sfidat me të cilat do të ballafaqohet njerëzimi në ardhmen apo siç thotë filozofi frëng, Derrida, duke parë duke pritur ndodhitë të cilat do të ndodhin. Një nga shqetësimet më të mëdha “në lidhje me Inteligjencën Artificiale është frika e humbjes së vendeve të punës. Automatizimi që rrit inteligjencën artificiale po shkakton gjithashtu humbje të mëdha të vendeve të punës në mbarë botën. Sipas një artikulli të Forbes, parashikohet se deri në vitin 2025, automatizimi do të shkaktojë humbjen e 85 milionë vendeve të punës. Automatizimi i armëve është gjithashtu një arsye e madhe që njerëzit shqetësohen për të ardhmen e Inteligjencës Artificiale”.¹⁰ Ideja që armët mund të përdoren për të kërkuar dhe shënjestruar dikë me udhëzime të para-programuara dhe keqpërdorimi i kësaj nga qeveritë ose mafiozët ose intelijenca artificiale mashtruese mund të jetë diçka shumë vdekjeprurëse dhe shkatërruese.¹¹ Megjithatë, shumë informata janë të rreme dhe shpeshherë qëllimi i tyre është jo i mirë, manipulues dhe ato kanë qëllim që të përhapin panik. Por, një gjë është më se e sigurt, se shoqëria e shekullit XXI konsiderohet si shoqëria më e avancuar deri më tani dhe kjo falë teknologjisë informative, respektivisht

Sipas një artikulli të Forbes, parashikohet se deri në vitin 2025, automatizimi do të shkaktojë humbjen e 85 milionë vendeve të punës.

internetit i cili për sociologët është një ‘shkop magjik’ dhe i cili po krijon ura lidhëse bashkëpunimi në shumë sfera me mikro dhe makro kulturat globale. Prandaj, si përfundim mund të nënvizojmë se Intelijenca Artificiale është një sistem i nevojshëm i kohës, i cili do t’ju mundëson njerëzve dhe shoqërisë në përgjithësi shumë progresse të avancuara përfshirë: komunikimin, idetë, fjalimet TED, përkthimet, korrektimin, informatat, të dhëna të tjera primare, sekondare dhe terciare, si dhe një mori të shërbimeve, të cilat do të jenë një ndihmesë e madhe për shoqërinë e shekullit XXI. Ndërsa, në anën tjetër, keqpërdorimi i IA-së mund të ndikojë te njerëzit në një pasiguri sociale, t’i shkatërrojë ndërtimet dhe urat sociale në mes të kulturave dhe shoqërive të ndryshme, mund të ndikojë që njerëzit të jetojnë në një kuti të vogël globale, pakënaqësi ndaj qeverive dhe trazira sociale, humbje të

vendeve të punës, si dhe probleme të tjera. Në fund, e ardhmja, suksesi apo dështimi do të varen nga ne, nëse ne si qenie sociale – biologjike lejojmë që të manipulohet dhe të dhënat të bien në duar të atyre që mund të manipulojnë me to, atëherë vërtetë do të kemi probleme dhe pasoja të mëdha, nëse jo atëherë njerëzimi do të mund të arrijë në piedestalet më të larta të shkencës, kulturës, shëndetësisë, teknologjisë, ekonomisë dhe zhvillimit të përgjithshëm shoqëror.

1 Gunther, Johan, Vendasit digjitalë dhe imigrantët digjitalë, Prishtinë, Konet, 2008, 25.

2 University of Cincinnati: “AN INTRODUCTION TO ARTIFICIAL INTELLIGENCE”, <https://www.uc.edu>, 2020: <https://www.uc.edu/content/dam/uc/ce/docs>. (Për herë të fundit qasur më 30.04.2023).

3 Boucher, Philip, Artificial intelligence: How does it work, why does it matter, and what can we do about it?, (Brussels: European Parliament), 2.

4 University of Cincinnati: “AN INTRODUCTION TO ARTIFICIAL INTELLIGENCE”, <https://www.uc.edu>. (Për herë të fundit qasur më 30.04.2023).

5 Harari N., Yuval, 21 Leksione për Shekullin 21, Tiranë, Botart, 66.

6 Frankenfield, Jake: “Artificial Intelligence: What It Is and How It Is Used”, <https://www.investopedia.com> 04 Prill, 2023: <https://www.investopedia.com>. (Për herë të fundit qasur më 30.04.2023).

7 DatePortal: “Digital 2023: Kosovo”, <https://datareportal.com> 14 Shkurt, 2023: <https://datareportal.com>. (Për herë të fundit qasur më 01.05.2023).

8 Llozani, Liridon: “A po i zëvendësojnë robotët punëtorët në Kosovë?”, www.dukagjini.com, 26 Prill, 2023: <https://www.dukagjini.com>. (Për herë të fundit qasur më 01.05.2023).

9 Friedman, George, 100 vitet e ardhshme – Parashikim për Shekullin XXI, (Tiranë: Plejad), 374.

10 Saha, Dibbyo, A Brief Introduction to Artificial Intelligence, (Toronto: Ryerson University), 6-7.

11 Po aty.

Rrugëtimi shpirtëror drejt së vërtetës hyjnore

Mimoza Sinani

Terri i hollë i mbrëmjes tashmë kishte filluar të pushtonte dhomën. Heshtja e saj kishte diçka të çuditshme dhe fytyra e saj tregonte se ajo ndrynte diçka në shpirt. Një plogështi e jashtëzakonshme ia përshkroi trupin. Çdo gjë iu duk e çuditshme, madje edhe vetja. I erdhi më mirë të rrinte pranë dritares dhe u mbështet në mbështetësen e madhe të karriges.

Hodhi vështrimin nëpër dhomë. Të gjitha sendet iu dukën me një pamje të pikëlluar dhe të strukura në qetësinë e vet. Edhe ajo hyri e u struk më brenda në lëkurën e vet.

Një tis i vazhdueshëm shqetësimi dhe një mjegull e padukshme trishtimi dukej në sytë vjeshtorë të saj. Zhurma e erës që trazoi qetësinë e dhomës së saj e bëri edhe më shurdhuese zhurmën e heshtjes së saj. Qetësia ishte qepur me penjtë e kësaj heshtjeje të rëndë dhe të palëvizshme. I pëlqente të meditonte dhe të zhytej në trazirat shpirtërore, dilemat, misteret.

Kishte dëshirë të përsiaste me veten. Ndjeu se po delironte e ulur aty pranë dritares e rrëmbyer nga kujtimet që rendnin në kohë. Mendimet e saj po shtegtonin në një depo kujtimesh që tashmë iu dukën sikur kundërmonin aromë vjetërsie.

Një rrymë ajri trazoi syprinën e ujshme të kujtimeve dhe e përfshiu në afshin e tyre. Ndjeu mërmërimën e mendimeve dhe iu duk se jehona e tyre u përhap në eter.

Kërkonte të lexonte fragmente të bukura të jetës, por ato shushuritnin me një gjuhë të pakuptimtë, thuj fantazmagorike.

Një heshtje e tejdukshme endej nëpër dhomë. Heshtjen e saj nuk e trazoi as fëshfërima e gjetheve që sikur përpiquej të griste perden e qetësisë. Rrezet e mekura të hënës dukeshin si të skllavëruara nga zërat misteriozë të qiejve.


Kujtimet e shtrydhura në morsën e kujtesës filluan të avullonin dhe t'i përplaseshin humnerave të shpirtit.

Qëndronte e pafuqishme përpara asaj hapësire aq të pakufishme që ngrihej mbi greminat e shpirtit.

Një enigmë e mbërthyer dhe e burgosur brenda saj kërkonte të rendte, të çmbështillej e të çlirohej. Në atë çast, mendimet iu ndalën, iu këputën dhe iu shterën. Por dëshira nuk e la. Dësh ta vazhdojë kërkimin, por mendimet iu përzien dhe iu shndërruan në një shkarravinë kolosale të pakuptimtë vijash të ndryshme, si hieroglifë të pakuptueshëm, që lakonin, dredhonin e zhdukeshin në labirinte pa rrugëdalje.

Çdo gjë iu duk tepër e ngatërruar, nuk shihte tjetër përveçse një pështjellimi të pashoq. Por ishte e sigurt se edhe te labirintet pa fund e pa krye gjendej një rrugëdalje.





Syprina e ujshme e kujtimeve të saj u përfshi nga trazirat e një ere të papritur. Ishte bërë pre e mendimeve të kaluara që tërhiqeshin për t'u rikthyer prapë si fosile që ringjallen. Hijet e së kaluarës po i afroreshin duke u luhatur nga erërat e kohës. Ishte zhytur në ujërat e thella të deteve të zemrës dhe i dukej së bashkë me të edhe e tërë bota ishte zhytur në një natë universale.

Iu duk vetja e zbrazët, e shkretë, e zhytur në terrishte. Po jetonte në skutat e një vetmie trishtuese si një trumcak i vetmuar në një holokaust dimri.

Objektet e natyrës nuk përbënin asgjë më shumë sesa figura të pajeta pjesëmarrëse në një paradë të pakuptimtë. Ekzistenca në tërësinë e saj ishte fragmentarizuar dhe pjesët e saj, të shkëputura nga shpirtërorja, ishin të huaja për njëra-tjetrën.

Në fëmijëri kishte krijuar imazhin e saj për jetën, plot mahnitje e rrëzëllime yjësie, plot ishuj ekzotikë valëzues e shkumues, plot dritësi e nanurisë, plot fosforeshencë dhe pllaja ëndrrash, plot shkëmbinj koralesh të zhytur në ujëra transparente tërë dritë e ngjyra, plot pranvera me kurora lulesh përrallore, plot agime mëngjesore me ngjyrë mermeri të trëndafiltë, por më pas plot drithërima trembjeje dhe enigma.

Universi i librave të mrekullueshëm artistikë, të autorëve të shquar klasikë e modernë, dhe tingujt e ëmbël të "Flautit magjik", "Bukuroshes së fjetur", "Liqenit të Mjellmave" dhe simfonive të tjera melodioze, ishin si zëra sirene që e kishin magjepsur deri atëherë.

Mendimet po i luanin një vals të trishtë. Lumturia e dikurshme iu duk si një mirazh dhe shtojzovallë që ikën tepër shpejt. Jeta i dukej aq absurde me ditë që zinin ndryshk, e muaj që pikonin lot. Iu duk vetja si një rreze e purpurt

përballë reve të zeza e të rënda, si një lule e sapodalë sipër barit të freskët përballë tankeve të hekurta të luftës.

Shkurtësia e jetës i ishte bërë e pafundme nga prania në të e misterit të vetvetes. Hapja e derës së vetvetes i dukej më e rëndësishme dhe më e guximshme se hapja e çdo dere tjetër, qoftë ajo edhe dera e një kasaforte të mbyllur me shifra të koduara, në të cilën ruheshin thesaret dhe xhevahiret e kësaj bote. Hapja e kësaj dera do ta çonte drejt një të panjohure të njohur që prekej, shihej, fotografohej, kurse ajo që fshihte dera e vetvetes nuk shihej, nuk prekej e as nuk filmohej.

Tendosja iu shkallëzua në një makth alarmant. Ndjeu regëtimat e shpjeta të zemrës që ia drithëruan trupin si një rrëmet sizmik. Ndihej si një qenie hibride mes një mjedisi të dyzuar. Ndiente se erozioni po e gërryente brenda vetes.

I mbledhi kujtimet e saj të shkuara, i groposi si relikte në katafalkun e ëndrrave të saj dhe ua fali flatrave të harresës.

Iu bë se po humbiste brenda vorbullës së dhimbjeve të vdekjes dhe po përpiquej ta çlironte kështjellën e shpirtit nga magjepsjet e Circes. Iu duk se shpirti iu zbardh nga mendimet e thinjura. Pulëbardhat e shpirtit kapën fijet e shkëputura të tij dhe po përpiquehin të fluturonin larg ferrit dantian, larg humnerave të frikshme që kishte projektuar Luciferi.

Gjithçka që i kishte dhënë gëzim e lumturi deri atëherë ishte tretur e zhvlerësuar ashtu si astrologjia babilonase përballë zbulimeve të dishepujve të Keplerit.

Shqetësimi i saj filloi të shprehej në një mjegullnajë të lehtë lotësh. Qepallat iu vesuan nga lotët. Ndjeu pulsën t'i rrihte si fëshfërima e përplasjes së krahëve të një pëllumbeshe të plagosur. Shkulmet e vajit që dilyn nga shpirti drithëronin edhe xhamat.

Drithërimat e saj reflektonin në xhamat e dritares portretin e saj të shformuar nga frika.

Hodhi vështrimin nga dritarja. Jashtë hapej qielli i mbushur me yje tërë shkëlqim. Pjesët e fytyrës që ndriçoheshin nga hëna hidhnin një hije të zbehtë mbi pjesët e tjera duke e mbuluar atë me një vello dritë-hije, dhe fytyra i kishte marrë një shprehje pafajësie. Lotët e frymëzuan dhe ia bleruan shpirtin e shkatërruar, ashtu si pranvera bleron natyrën pas dimrit të acartë.

Papritur një vetëdije hyjnore e mbushi qenien e saj duke davaritur frikën e duke e orientuar në rrugën drejt jetës.

Filloi të bëhej një me ndjenjat e veta dhe të provojë ëmbëlsinë e hyrjes në brendësinë e vet. Kur hyri brenda origjinës së vet, kur arriti të takohej me brendësinë e saj, ajo gjeti dikë tjetër që e donte shumë dhe e kuptoi se ekziston një Zot që e kish krijuar atë dhe botën e saj të brendshme.

Shpirti i saj vazhdimisht pretendonte dhe synonte botën më të lartë shpirtërore, botën e panjohur nga e cila kishte të njohura vetëm disa vegime të cilat shpërndaheshin përpara

se të paraqiteshin. Atëherë e kuptoi se ajo botë e panjohur, një refleks shkëlqimi të së cilës e kishte vërejtur në melodinë e ëmbël dhe në tregimin gjenial, dhe që në momentet e inspirimit e kishte ndier aromën e saj, ishte shumë më e fuqishme se kjo botë materiale. Shkëmbi i akullt i egolatriisë brenda shpirtit të saj filloi të shkrijë.

Ishte një kërkim i pareshtur i përgjigjes së kësaj enigme për t'u kthyer sërish në unitetin e përkryer të zanafillës së parajsës së humbur, të rilidhjes përsëri me kordonin amënor.

I dukej sikur ishte duke gërmuar pusin me gjilpërë, por në fakt sapo kishte filluar të qëndiste në gjergjefin e saj lulet e para të besimit.

Pesha e zhdukjes së përjetshme iu hoq dhe arriti të ndiejë dimensionin e pafundësisë së ngulitur brenda thelbit të vet.

Engjëjt e bardhë që i prekën membranën e kujtesës iu përplasën në honet e subkoshienës si kone drite.

Arriti të perceptojë rrugën dhe destinacionin që kalon nëpërmjet varrit drejt pafundësisë dhe në udhëtimin e saj misterioz e vërteta hyjnore ishte drejtuesja e saj drejt vendit të përjetësisë. Njohja hyjnore, që e grisi perden e hedhur në fytyrën e vdekjes dhe vdekshmërisë, ia tregoi varrin si një sallon pritjeje të botës së lumturisë së amshuar dhe e çoi zemrën e saj të etur për lumturi që të pinte në burimin e eliksirit të pavdekshmërisë.


Pas shtrëngatës, në detin ku kishin ulëritur dhe buçitur furtunat dhe dallgët, tani sundonte vetëm një zë i dëlirë dhe i ëmbël. I tërë deti kishte rënë në qetësi i magjepsur nga ky tingull hyjnor që ende brenda hapësirave të tij të pakufishëm.

Arriti të kuptojë domethënien e të fshehtave që qëndronin prapa vellos së ekzistencës dhe besimi te Zoti ia ndryshoi dëshirat dhe mendimet.

Shkëlqeu e tëra e ndezur nga një dritë e brendshme. Një ndjenjë e fuqishme dhe sublime ia përshkroi tërë kurmin.

Kapilarët e boshatisur nëpërmjet të cilave organizmit të saj i shpërndahej energjia filluan të furnizoheshin sërish. Ishte njëlloj si lindja e një dielli në një botë ku kishte munguar ajri.

Ndjeu se dalëngadalë po përfshihej nga procesi rrezatues i përsosjes. Ndjeu shkëlqimin e mirësisë dhe vetja iu duk më e bukur, më e mirë.



Dashuria e pafundme për Krijuesin si një oazë llamburitës shprese i dha forcë.

Kjo vetëdije hyjnore tani ishte gjithçka për të: bota, jeta, lumturia, e tashmja tokësore dhe e ardhmja qiellore.

Filloi të përjetojë kënaqësinë që i dhuronte lutja drejtuar Krijuesit kur rrezet e dritës akoma nuk e kishin çarë perden e natës dhe filloi të freskojë zemrën e zhuritur në lumenjtë e përjetësisë.

Në shpirtin e saj reshën shirat e frymëzimit. Filloi t'i lutet Allahut: "Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve ...Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm Te Ti ndihmë kërkojmë!"

Fjalët e dala nga goja e saj, të kapura dorë për dorë u ngritën duke vallëzuar deri në qiellin e shtatë, trokitën dhe hynë në portën e Mëshiruesit.

Edhe pse përjashta do të frynin e shfrynin rrebeshe, ajo do t'i ujiste dhe kultivonte me kujdes rrënjët delikate dhe të brishta të filizit të besimit që hibridët të mos e hibridizonin pemën e sapo mbjellë të imanit të saj.

Dashuria për Krijuesin madhështor reshi mbi shpirtin e saj ashtu si reshin shirat e begatë të pranverës mbi tokën e mbetur djerrë dhe ajo u rrok pas stinës së trëndafilte të frymës islame.

Qielli i pakufishëm u ndriçua nga drita e kulluar e diellit. Hëna po voziste si velë drejt viseve të largëta të botës. Vellot e mjegullave u përhapën dhe mënjantuan dantellat e mëndafshta të reve. Rrezja e dritës filloi të pushtojë hap pas hapi zonat e hijesuara. Syprina e kaltër e refleksive të qiellit iu derdh mbi fytyrë dhe fashat e ëmbla të dritës depërtuan nëpër dritare. Hodhi vështrimin nga kaltërsia e qiellit, ngriti dorën lart ta prehtë atë, dhe gishtërinjtë ndien freskinë e ajrit. Ajri ishte i tejdukshëm dhe konturet e pemëve të veshura në të gjelbër dukeshin qartë. Një gjelbërim i ëmbël i lundronte në sy. Mori frymë thellë e etur dhe iu duk sikur nuk do ngopej edhe po të thithte tërë ajrin e hapësirës. Vështrimi i saj i kadifenjtë si një rreze e purpurt sodiste dritësinë e agimit. Tingujt dhe cicërimat që mbushnin hapësirën rezononin me një akustikë të ëmbël. Dëgjonte një përzierje tingujsh akustikë dhe metafizikë.

Ishte çliruar plotësisht nga hallkat e ftohta të së kaluarës dhe përgjonte zërin e paqte të së ardhmes.

Dijetarët shqiptarë në revistën “Hëna e Re”

Sadik Mehmeti

Revista “Hëna e Re” është revistë që përveç për lexuesit dhe besimtarët e saj, botohet edhe për klasën ilmiye, për informimin e tyre me jetën fetare islame dhe kulturore në vendin e tyre dhe më gjerë.

HYRJE

Në vitin 1987, shtypit islam në hapësirat shqiptare, pas revistës “Takvimi” (1970), “Edukata islame” (1971) dhe “Dituria Islame” (1986), që botoheshin në Prishtinë si organe të Bashkësisë Islame të Kosovës, i shtohet edhe revista “Hëna e Re” e Shkupit, organ i ish-Meshihatit të BI-së së Maqedonisë, sot Rijaseti i Bashkësisë Islame në Maqedoninë e Veriut. Në të vërtetë, “Hëna e Re” nga numri 1/1987 e deri në numrin 33/1991, ka qenë gazetë dhe është botuar në tri gjuhë (shqip, turqisht dhe maqedonisht) me emrin “el-Hilal” (“Hëna e Re”)¹, ndërsa më pastaj është bërë revistë dhe ka dalë në gjuhën shqipe, siç edhe vazhdon edhe sot e kësaj dite kur ka arritur të nxjerrë 277 numra (mars 2023).

Kjo revistë informative, kulturore, islame, që në fillet e daljes së saj kishte për synim t’u përgjigjej kërkesave të besimtarëve islamë, në radhë të parë në territorin e Maqedonisë, në rrethanat e reja të kohës dhe të plotësonte zbrazëtirën e krijuar në këtë drejtim. Mirëpo, revista “Hëna e Re” nuk u kufizua vetëm në botimin e temave të ndryshme të doktrinės islame, porse si kërkesë e kohës, ajo botoi edhe tema nga historia, kultura, trashëgimia, ekonomia, etj., duke u bërë kështu një tribunë e përgjithshme mendimit shqiptarë në këto hapësira dhe jo vetëm.

Në revistën “Hëna e Re”, një vend me rëndësi, dhe kjo është e natyrshme, zënë edhe temat për ulematë tanë më të hershëm, temat për ndriçimin dhe studimin e jetës dhe veprës së tyre, praninë e të cilave tema do ta trajtojmë në këtë vështrim tonin në vazhdim.

Tri janë arsyet kryesore se për se u përcaktova për këtë temë dhe për se pikërisht për dijetarët shqiptarë në revistën “Hëna e Re”.

E para, sepse revista “Hëna e Re” (do t’i referohemi në vazhdimësi si revistë, ndonëse në fillim sikurse u tha, ishte gazetë që dilte në tri gjuhë), është revistë të cilën e ka themeluar dhe e boton ish-Meshihati, sot Rijaseti i Bashkësisë Islame në Maqedoninë e Veriut, që nënkupton institucionin kryesor dhe më të lartin fetar islam ku ndërveprojnë elitat e ulemasë në këtë vend. Prandaj, për këtë arsye, siç edhe është e kuptueshme, revista do t’i kushtojë vëmendje në përmbajtjen e saj dhe do të konceptohet e tillë ku do të trajtojë ulemanë, myftinjë, myderrizët, imamët, hafëzët, mualimët, mësuesit fetarë,



madje edhe vetë reisul-ulemanë dhe të gjithë dijetarët e tjerë islamë të cilët duke vepruar jashtë klasës ilmije (pra, dijetarëve islamë) ndihmuan misionin e bashkësisë islame, përkatësisht ndihmuan misionin e fesë islame jo vetëm në vendin ku bohet revista, por gjithandej trojeve shqiptare dhe jo vetëm, sepse në “Hënën e Re” do të gjejmë vend edhe dijetarë përtej arealit shqiptar e në fqinjësi të tij dhe nga bota islame, por që këta të fundit nuk janë qëllimi ynë në këtë kumtesë.

Arsyeja e dytë se për se u përcaktova për këtë temë është fakti se në revistën “Hëna e Re”, si organ i institucionit më të lartë islam, me kontributet e tyre do të paraqiten klasa ilmije, të cilët pas themeluesit dhe botuesit, kanë meritat kryesore për mbarëvajtjen, suksesin dhe jetëgjatësinë e revistës. Fundja, revista “Hëna e Re” është revistë që përveç për lexuesit dhe besimtarët e saj, botohet edhe për klasën ilmije, për informimin e tyre me jetën fetare islame dhe kulturore në vendin e tyre dhe më gjerë. Pikërisht për këtë, në kumtesën tonë nuk kemi parasysh vetëm ata dijetarë për të cilët është shkruar në “Hënën e Re”, por edhe dijetarët të cilët kanë shkruar në këtë revistë.

Ekziston edhe arsyeja e tretë për se jam përcaktuar për këtë temë, por këtë do ta themi në fund të këtij vështrimi.

Sidoqoftë, përmes një analize tekstuale të punimeve të botuar për dijetarët në “Hënën e Re” këto tri dekada e gjysmë të daljes së saj (1987-2022), kemi marrë në shqyrtim paraqitjen dhe trajtimin e dijetarëve shqiptarë në revistë, gjithnjë duke pasur parasysh se në një kumtesë si kjo nuk do të mund të përfshihen dhe as të trajtohen meritueshëm dhe në mënyrë të plotë të gjithë dijetarët tanë të pranishëm në faqet e revistës “Hëna e Re” dhe as ata dijetarë që kanë shkruar për dijetarët pararendës.

DIJETARË QË IU PËRGJIGJEN NEVOJAVE DHE SFIDAVE TË KOHËS

E kur jemi te dijetarët shqiptarë islamë, te klasa jonë ilmije, po e ritheksojmë një gjë të cilën e kanë thënë edhe të tjerët ndër ne se periudhat e arta të fesë islame ishin epoka të respektit të jashtëzakonshëm për librin, ulemanë dhe kontributet e tyre intelektuale. Në epokat e tilla u shquan dijetarë të cilët shkruan, kopjuan, përkthyen e shpërndanë libra, dije e dituri, por dolën edhe të tillë filantropë, bamirës e vakëflënës fisnikë e bujarë që themeluan biblioteka dhe institucione për përhapjen e arsimit dhe shkencës.

Edhe trojet tona nxorën dijetarë të shquar të cilët mundën dhe ditën se si t’u përgjigjeshin nevojave dhe sfidave të kohës

Edhe trojet
tona nxorën
dijetarë të
shquar të
cilët mundën
dhe ditën se
si t’u
përgjigjeshin
nevojave dhe
sfidave të
kohës në të
cilën jetuan e
vepruan.

në të cilën jetuan e vepruan. Ulemaja jonë i dha popullit siguri, përkrahje, inkurajim, besim, optimizëm, duke i këshilluar e duke ju prirë në ballë sa herë që qe paraqitur nevoja. Kur themi këtë, nuk nënkuptojmë vetëm detyrimet fetare dhe ndihmën shpirtërore që ata dhanë dhe kryen me kapacitet dhe shtrirje e përkushtim të plotë, por edhe rolin dhe veprimtarinë e tyre shoqëror për ruajtjen, kultivimin dhe ngritjen e vetëdijes fetare e kombëtare. Në të gjitha situatat kritike e në momente të rëndësishme dhe vendimtare që kaloi vendi ynë, ulematë ishin pararoja; ata udhëhoqën popullin dhe u vunë në krye të tij. Në rastin tjetër, ata ishin me njerëzit e tyre dhe ndanin fatin e tyre të përbashkët. Kjo është e lehtë për t’u dëshmuar e për t’u argumentuar në historinë tonë që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e këndej dhe sidomos pas 1912 dhe përgjatë periudhës komuniste, kur ulematë u persekutuan, u burgosën, u torturuan, u syrgjynosen, u dëbuan nga atdheu i tyre dhe u vranë. Për disa prej tyre dihet, por ka shumë të tjerë fatkeqësisht edhe janë harruar dhe për ta vështirë të dihet gjë. Informacione për disa dijetarë mund të gjenden ende vetëm në arkiva, që presin dorën

e studiuesve për t’i ndriçuar e për të shkruar monografi për ta, për të treguar kontributin e tyre në veprimtaritë misionare, në punën e bashkësisë islame dhe ruajtjen dhe zhvillimin e traditës islame ndër ne. Kohëve të fundit janë bërë përpjekje të rëndësishme për të theksuar rëndësinë e ulemasë në zhvillimin e kulturës dhe trashëgimisë islame ndër shqiptarët, por se kjo nuk është e mjaftueshme.² Nuk është e mjaftueshme sepse nuk mund të njihen rrethanat, koha, konteksti pa njohur vizionin, mendimin e klasës ilmije të një kohe a vendi të caktuar. E sikurse dihet, çdo vend ka specifikat e veta dhe se çdo komb islam duhet të ndjekë hapat e tij në fushën e kulturës e trashëgimisë fetare. Misri (kallamboqi), si begati dhe nimet i domosdoshëm për njeriun, është i njëjti misër si në Kanada, në Amerikë e gjithandej ku kultivohet, por se ai dallohet më përshtatjen konform kushteve klimatike dhe agronome të një vendi të caktuar dhe për këtë arsye, ai merr tipare të veçanta, specifike, ndaj dhe quhet me emër të veçantë që lidhet me vendin ku kultivohet. Kështu është edhe më dijetarët islamë shqiptarë, ata kanë bojë dhe aromë të veçantë nga dijetarët e tjerë, prandaj dhe i quajmë dijetarë shqiptarë, sepse ata edhe kanë rëndësi e peshë për ne më shumë se dijetarët që jetojnë në qendra e skaje të largëta të botës islame. Dijetarët tanë janë brendi yni origjinal, autokton.

“HËNA E RE” AFRIMUESE E DIJETARËVE DHE E KUJTIMIT PËR TA

Sidoqoftë, meqë tema e këtij punimi është analiza e teksteve për dijetarët shqiptarë të botuar në “Hënën e Re” gjatë tri dekadave e gjysmë të daljes së kësaj reviste, do të përpiqem të tregojmë se në çfarë mënyre dhe sa u afirmuan dijetarët tanë dhe sa u ushqye kultura e kujtimit të tyre në këtë revistë.

Që në fillim duhet thënë se, krahas temave të shumta nga teologjia, kultura, arti, shkenca dhe edukimi, revista “Hëna e Re” u ka kushtuar vëmendje të meritueshme ulemave dhe kontributit të tyre në kuptimin e përgjithshëm.

Për dijetarët shqiptarë në revistën “Hëna e Re” kanë shkruar autorët: Mahmut Hysa, Elez Ismaili, Hamdi Iljazi, Vehbi Behxheti, Shefqet Pllana, Aliriza Selmani, Sutki Malohoxha, Gazmend Shpuza, Ali Vishko, Muhamet Pirraku, Feti Mehdiu, Shefik Osmani, Nexhat Abazi, Ramadan Hoxha, Sotir Temo, Musa Kraja, J. Andoni, Mehmet Halimi, Ismail Ahmedi, Abdullah Hamiti, Abdullah Bytyqi, Rexhep Torte, Faik Kasollja, Adnan Emini, Enver Zeqiri, etj.

Kurse nga dijetarët tanë të trajtuar në revistë, janë: Rexhep Voka, Muhamet Kyçyk - Çami, Hafëz Ali Riza Ulqinaku, Hasan ef. Nahi, Sherif ef. Ahmeti, Haxhi Salih ef. Ferhati, Sali ef. Abazi, Haxhi Hafëz Shasivar Limani, Hfz. Sabri Koçi, Sulejman ef. Rexhepi, Rexhep ef. Boja, Adem ef. Emrullahu, Haxhi Shaip ef. Sherifi, Musa ef. Rrustemi, Hfz. Shefit Bajrami, Mulla Mahmud ef. Asllani, Vehbi ef. Ismaili, Tahir

ef. Lluka, Mulla Hasan Masurica, Hfz. Iljaz Iljazi, Jashar Erbara, Hoxhë Maxherra, Haki Sharovi, Hasan Kaleshi, Hafëz Ismet Dibra, Haxhi Ali Elbasani, Baba Ali Tomorri, Ferid Vokopola, Ruzhdi ef. Lata, Ibrahim Hasnaj, Medah Baba, Haki ef. Sermaxhaj, Hfz. Behxhet Latifi, Hoxhë Hasan Tahsini, Vehbi ef. Dibra, Said ef. Najdeni, Hafëz Ymer Shemsiu, Hafëz Ibrahim Dalliu, Hafëz Islam Bytyqi, Hafëz Ali Korça, Xhemail ef. Emini, Hamdi Ohri, Vexhi Buharaja, Hafëz Sherif Langu, Mulla Idriz Gjilani etj.

Gjatë hulumtimeve tona duke shfletuar faqet e revistës “Hëna e Re”, veçan nga numri 1/1987 e deri në numrin 161/2000, rezulton se:

Nga tekstet e botuara në “Hënën e Re”, vërehet se mjaftueshëm janë mbuluar më biografi të shkurtra dijetarët tanë. Biografite të tyre janë botuar më së shpeshti në përvjetorët e tyre të lindjes ose të vdekjes dhe atë shpeshherë, për të mos thënë në të shumtën e rasteve, nuk kanë autorë, por janë të nënshkruar nga redaksia. Në këto shkrime mund të lexojmë të dhëna përmbledhëse biografike dhe shënime të rëndësishme për punën, kontributin, angazhimin, reflektimet dhe ndikimin që ata kanë pasur te myslimanët dhe në mjedisin e përgjithshëm shoqëror. Këto biografi shpeshherë janë të shoqëruara edhe me fotografi të ulemave, që marrin vlerë ku e ku më të madhe.

Në “Hënën e Re”, po ashtu janë botuar në nivel të kënaqshëm, sidomos që nga numri 31/1991 e këndeje edhe



studime mbi jetën dhe veprën e dijetarëve tanë, duke botuar tekste të vlefshme në të cilat autorët diskutojnë dhe vënë në spikamë kontributin e ulemasë shqiptarë në kuptimin e përgjithshëm të tyre, duke dhënë vlerësime dhe interpretime shkencor për punën dhe misionin e tyre shumëdimensional.

Nga këto punime janë domethënëse prezantimet që i bëhen Rexhep ef. Vokës, një ndër dijetarët e shquar dhe nga më emblematikët e plejadës së ulemave shqiptarë në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, me prejardhje nga Tetova. Rexhep Vokë Tetova është personaliteti për të cilin më së shumti është shkruar në “Hënën e Re” dhe atë nga disa autorë e studiues tanë të shquar. Dhe kjo është kuptueshme, kur dihet veprimtaria fetare dhe kombëtare dhe kontributi shkrimor i Rexhep Vokës, por i cili për shkak të rrethanave të ndryshme ishte i anashkaluar, i anatemuar dhe i keq interpretuar.

Janë me rëndësi edhe shkrimet për dijetarët tanë të tjerë, si për Muhamet Çamin, Hafëz Ali Ulqinakun, Said ef. Najdenin, Hafëz Ali Korçën, Hafëz Ibrahim ef. Dalliu, Tahir ef. Llukën, Hfz. Ymer Shemsion etj., që lanë gjurmë të pashlyeshme në jetën kulturore të shqiptarëve dhe që kanë peshën e tyre të pakontestueshme edhe në letërsinë tonë.

Gjithashtu, janë me rëndësi edhe punimet për ata dijetarë tanë të cilët u vunë në ballë të proceseve të ndryshme për pavarësi, për shtetformim e kombformim, siç është Vehbi ef. Dibra, Ismet ef. Dibra, Mulla Idriz Gjilani, Ferit Vokopola, Hfz. Ali Korça, Sherif ef. Langu etj.

Të një rëndësie të veçantë janë edhe intervistat me prijësit e komuniteteve tona fetare, si Hfz. Sabri ef. Koçin (Kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar), Salih ef. Ferhatin (Myfti i Dibrës), Sulejman ef. Rexhepin (Reis i BFI të Maqedonisë së Veriut), Dr. Rexhep ef. Bojën (Kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës), Hfz. Shaqir ef. Fetahun (Reis i BFI të Maqedonisë së Veriut) etj., ku përmes tyre pasqyrohet jeta fetare islame, por edhe problemet, sfidat dhe sukseset e ulemasë shqiptare dhe nevoja e përmblidhjes së misionit të tyre konform kërkesave të kohës.

Sikurse shihet, “Hëna e Re” në shkrimet e saj për dijetarët, nuk ka trajtuar vetëm ulemanë nga një pjesë e caktuar e arealit shqiptar, por gjithandej trojeve shqiptare. Për më tepër, edhe autorët që kanë shkruar për dijetarët shqiptarë, vijnë nga treva të ndryshme të gjeografisë shqiptare.

Në “Hënën e re”, rezulton po ashtu të jenë trajtuar e prezantuar meritueshëm edhe sukseset e muhafizëve dhe

Një leksikon
i dijetarëve
shqiptarë,
nuk do të jetë
e mundur që
të bëhet pa u
konsultuar
shkrimet të
cilat janë
botuar në
revistën
“Hëna e Re”.

hafëzllarëve që ata kanë nxjerrë, sikundër që aty gjejmë të dhëna edhe për studentët tanë, përkatësisht për dijetarët e ardhshëm të cilët do të kenë diplomuar nëpër universitete të ndryshme të botës.

Vihet re po ashtu se në 30 numrat e parë të “Hënës e Re” dijetarët janë prezantuar më pak dhe kjo është e kuptueshme për shkak të ish-sistemit në të cilin kemi jetuar, kurse pas viti 1991 dhe hapjes së shqiptarëve, në faqet e revistës do të gjejmë punime e shkrime gjithnjë e më shumë ku do të trajtoheshin dijetarët tanë. Mirëpo, ky trend do të vazhdoj deri në vitin 2000, ku më pastaj kemi një mungesë prezantimi të dijetarëve tanë dhe një rritje të prezantimit të biografive të dijetarëve, disa prej tyre edhe minorë, nga vende të ndryshme të botës islame. “Hëna e Re” mendojmë se do të vazhdojë me trajtimin dhe publikimin e biografive të dijetarëve shqiptarë, sidomos kur tashmë dihet fakti se ndër shqiptarët ka pasur dijetarë të shquar të cilët me punën dhe veprën

e tyre i kanë tejkaluar kufijtë lokal të vendit dhe të trevës ku kanë lindur dhe duke i bërë nder atdheut dhe origjinës së tyre.

SI PËRFUNDIM

Në fund të këtij vështrimi themi se kurdo që të shkruhet (dhe një ditë gjithsesi që do të shkruhet) një leksikon i dijetarëve shqiptarë, nuk do të jetë e mundur që të bëhet pa u konsultuar shkrimet të cilat janë botuar në revistën “Hëna e Re”, sepse këto shkrime hedhin dritë dhe japin të dhëna të reja dhe plotësuese mbi një numër të konsiderueshëm të dijetarëve tanë të cilët jetuan në kohë dhe vende të ndryshme.

E pikërisht kjo pra, është edhe arsyeja e tretë se përse jam përcaktuar për temën “Dijetarët shqiptarë në revistën “Hëna e Re”.

1 Nga numri 1/1987 e deri në numrin 33/1991, ka qenë gazetë dhe është botuar në tri gjuhë (shqip, turqisht dhe maqedonisht). Shih më gjerësisht për përmbajtjen e këtyre numrave: Shaban Ramani, “Revista “Hëna e Re” (bibliografi 1987-2020), botoi: Bashkësia Fetare Islame e RMV, Shkup, 2020.

2 Kujtojmë këtu botimet: Grup autorësh, *100 personalitete shqiptare të kulturës islame (shek. XIX-XX)*, botoi: KMSH, Tiranë, 2012; enciklopedinë e autorëve Sadik Mehmeti, Hatixhe Ahmed, Ramadan Shkodra, “*Dijetarët Shqiptarë në Perandorinë Osmane sipas dokumenteve të Meshihatit të Lartë Osman (1880-1912)*”, botoi: Kryesia e BI të Kosovës, Prishtinë, 2021; Dr. Feti Mehdiu, *Hafizët tanë gjatë historisë (leksikon-shek. XVIII – 2010)*, Prishtinë, 2010; Faik Miftari, *Hafizët e Prizrenit 1912-2012*, Prizren, 2012; Mexhid Yveysi, *101 Personalitete (fetare, atdhetare, kulturore, letrare)*, Gjakovë, 2013; përmbledhjet nga konferencat shkencore: “*Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar*”, Tiranë, 2013; Konferenca shkencore: “*Kontributi i ulemave në ngritjen e çështjes kombëtare*”, BFIM, Shkup, 2013 etj.

Një vështrim filleve të literaturës islame në gjuhën shqipe në Kosovë (1)

Arbin Ahmeti

HYRJE

Për shkak të rrethanave shoqërore politike që kanë mbizotëruar në Kosovë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, jeta e shqiptarëve në përgjithësi dhe e popullatës myslimane në veçanti u vështirësua dukshëm, për shkak se sistemi i ri i cili po instalohej, ishte përveç të tjerash edhe një sistem që jo se nuk e favorizonte fenë, por ishte kundër saj. Për këtë arsye, riorganizimi i jetës institucionale të Bashkësisë Islame nuk ishte i lehtë, kur asgjë nuk shkonte në favorin e saj dhe të interesave të saj. Megjithatë, klasa e ulemasë shqiptare arriti që edhe në këto rrethana, të riorganizohej, të themelonte institucione të reja dhe të organizonte mbarëvajtjen e jetës fetare islame në Kosovë. Edhe për sa i përket literaturës islame në gjuhën shqipe, për arsyet që u përmenden, pati ngecje e pengesa, por të cilat u tejkaluan me shumë mund dhe sakrificë dhe tek në vitin 1957, për të parën herë në Kosovë, do të botohej me shkronja shqipe "*Ilmihali i vogël*", për njohuritë themelore të fesë islame.

Shikuar nga perspektiva e sotme, ky hap i ulemasë dhe prijësve të institucioneve tona islame, del të ketë qenë shumë i qëlluar dhe domethënës, sepse qe filluar me një doracak që shpjegonte themelet e fesë, që ofronte mundësinë që besimtarët t'i mësonin parimet e fesë islame në gjuhën shqipe, dhe përmes një doracaku të tillë, dalëngadalë, t'u hapej rruga dhe të përgatiteshin kushtet për botimin edhe të literaturës tjetër, e cila, për hir të së vërtetës, erdhi shumë ngadalë dhe me shumë vonesa, gjithnjë të kushtëzuara nga

faktorët shoqëro-politikë. Por, duhet pranuar se edhe elita islame shqiptare në atë kohë, nuk ishte akoma e gatshme për të ndërmarrë projekte më të mëdha se kaq, sepse ishte një elitë e themeluar, e formuar, e arsimuar në rrethana të tjera dhe në gjuhët tradicionale të studimeve të tyre (arabisht e osmanisht).

Për fillet e literaturës islame në gjuhën shqip në Kosovë,

kanë shkruar autorët e respektuar, Hajrullah ef. Hoxha dhe mr. Ramadan Shkodra, të cilët përveç se kanë periodizuar literaturën islame në gjuhën shqipe, ata kanë dhënë edhe konstatime të qëndrueshme shkencore, gjithnjë duke pasur parasysh rrethanat nëpër të cilat u botua kjo literaturë dhe nëpër të cilat kaloi Bashkësia Islame e Kosovës në veçanti dhe e gjithë popullata shqiptare në përgjithësi. Mbi bazën e këtyre rezultateve të këtyre autorëve dhe të punimeve të tyre, por edhe të literaturës tjetër dhe edhe të vërtetimeve të mia personale, është hartuar edhe ky punim yni.

ILMIHALI DHE MËSIMET E NAMAZIT – LITERATURA E PARË NË GJUHËN SHQIPE NË KOSOVË

Sikurse e thamë, pas Luftës së Dytë Botërore në Kosovë, përkatësisht në vitin 1948, u formua Bashkësia Islame e Kosovës, në krye të së cilës u vu myderrizi i shquar, h.fz. Bajram ef. Agani,¹ i cili e udhëhoqi atë deri në vitin 1960. Në këto vite, falë vizionit dhe largpamësisë së tij

Në vitin 1957,
për të parën herë
në Kosovë, do të
botohej me
shkronja shqipe
"*Ilmihali i vogël*",
për njohuritë
themelore të fesë
islame.

dhe të bashkëpunëtorëve e bashkëmen-dimtarëve të tij, në fillim, saktësisht në vitin 1951, u themelua Medreseja e Ulët Shqiptare e Prishtinës, që pa dyshim ishte një ndër veprimet më të rëndësishme të Bashkësisë Islame në atë kohë. Në vitin 1957, po me iniciativën e tij, u botua edhe doracaku “Ilmihali i vogël” për mësimet fillestare të fesë islame, i cili u përkthye nga gjuha serbokroate, botim që quhej asokohe, i Shoqatës së Ylemave për RSS-në në kuadër të BFI-së me seli në Prishtinë, që ishte një veprim tjetër po aq i rëndësishëm. Shoqata në fjalë, ishte përgjegjëse për veprimtarinë botuese në kuadër të këtij institucioni dhe e cila më këtë doracak, të cilit nuk i dihet as përpiluesi, as përkthyesi në gjuhën shqipe, nisi fillin e veprimtarisë botuese islame në Kosovë në gjuhën shqipe, për vazhduar deri më sot.²

Për sa i përket përmbajtjes, “Ilmihali i vogël” fillon me hyrje, ku parashtrohen disa pyetje të përgjithshme:

- Me çka fillojmë çdo punë të mirë?
- Çka ka krijue Zoti i Gjithfuqishëm përpos nesh dhe kësaj bote?
- Çka do të ndodhë kur do të vdesim ne dhe kur do të zhduket kjo botë?
- Çka do të ndodhë ditën e Gjykimit?
- Pse ekzistomë në këtë botë?³




Figura 1.1. Ballina e “Ilmihalit” (1957)

Pastaj në pjesët e tjera me radhë trajtohen çështjet e besimit islam (akaidit), duke filluar me besimin në Allahun xh.sh. të Vetmin dhe të pa shok, besimi në melaqet e Allahut xh.sh., në librat dhe pejgamberët a.s. (të zgjedhurit e Tij), besimin në Ditën e Gjykimit dhe në kadanë dhe kaderin e Allahut xh.sh.. Në kapitujt vijues flitet për ibadetet fetare.⁴ Si për fjalën e dëshmisë (shehadetin), namazin, zekatin dhe haxhin. Pastaj në pika të shkurtra në Ilmihal janë shtrirë çdo temë, si: namazi, abdesi, tejemumi etj..

Në kapitullin e fundit, në “Ilmihali i vogël”, flitet për mirësjelljen dhe detyrat e njeriut për Allahut xh.sh.. Detyrat e njerëzve mes vete, detyrat e familjarit me familjen e tyre, me fafësin, me Bashkësinë Islame, dhe në fund me shtetin e tij, të jetë përgjegjës për punët që i bën si njeri.

Në kopertinat e fundit të “Ilmihalit” lexojmë: U shtyp në dhjetor të vitit 1957. Tirazhi 25.000.⁵ Një tirazh kaq i madh, sidomos për kohën, tregon për nevojën dhe interesimin e etur të lexuesit shqiptar mysliman për t’i mësuar bazat e fesë islame në gjuhën shqipe. “Ilmihali i vogël” është ribotuar edhe dy herë të tjera, një herë në marsin e vitit 1958 me 15.000 ekzemplarë të tjerë dhe herën e dytë në Pejë, më 1997, ku me rastin e 40-vjetorit të botimit të parë të “Ilmihalit të vogël”, Këshilli i Bashkësisë Islame i Pejës ka ribotuar 1.000 ekzemplarë të Ilmihalit, të cilët u pritën shumë mirë nga lexuesit shqiptarë.

“Ilmihali i vogël” ka luajtur një rëndësi shumë të madhe te populli shqiptar, edhe pse një doracak i vogël, mirëpo te populli shqiptar hyri në histori të paharrueshme.

1. Në përmbajtje ishte shumë domethënëse, sepse tregonte për thelbin e Islamit në pika të shkurtra, dhe tjetra ishte se për herë të parë mësohej dhe lexohej në gjuhën shqipe, ku përfshinte një pjesë të madhe të lexuesve shqiptarë.

2. Nëse mund të themi fjalën e të urtëve tanë, ku thonë: “Punët e mëdha fillojnë nga punët e vogla me përplot bereqet”, edhe ky “Ilmihal i vogël” ishte me përplot bereqet.

3. Padyshim se Ilmihali u bë si një gurthemel i literaturës islame në trojet tona.

“Ilmihali i vogël” ka luajtur një rëndësi shumë të madhe te populli shqiptar, edhe pse një doracak i vogël, mirëpo te populli shqiptar hyri në histori të paharrueshme.




Figura 1.2. Ballina: “Mësimi i shkurtër mbi namazin dhe Jasini Sherifi” (1959)

4. Kështu filloi literatura e parë islame në gjuhën shqipe, duke filluar nga pak, e sot kemi me qindra libra nga fushat e ndryshme islame.

Dy vjet më vonë, pas botimit të Ilmihalit, po në Prishtinë, më 1959, botohet doracaku tjetër: “Mësimi i shkurtër mbi namazin dhe Jasini sherifi”, i përgatitura nga kryetari i atëhershëm i Bashkësisë Islame të Jugosllavisë, h. Sulejman Kemura, të cilin e kanë përkthyer nga gjuha boshnjake, hfz. Bajram ef. Agani dhe Mehmet Gjevari.⁶ Në këtë botim, është trajtuar gjerësisht mënyra e faljes së namazit dhe është përkthyer surja “El Fatiha” dhe surja e “Jasini sherifit”. Për shkak të kërkesave në terren, edhe ky libër u ribotua disa herë nga Shoqata e Ylemave dhe Bashkësia Islame e Kosovës.

Rëndësia e këtij botimi, qëndron në faktin se këtu janë shpjeguar kushtet dhe rregullat e namazit, farzit të parë të

myslimanëve dhe, po ashtu, janë dhënë në përkthim edhe dy suret e përmendura. Pas “Ilmihalit”, botimi i këtij libri, ishte më se i nevojshëm, sepse pasi që të njihet feja dhe parimet bazë të saj, duhet edhe praktikimi i fesë, dhe në radhë të parë duhet filluar me namazin. Një libër i tillë sikur ky, është i domosdoshëm edhe sot, sepse për një literaturë të tillë, gjithmonë ka nevojë lexuesi shqiptar mysliman, sidomos kur ajo botohet nga institucioni kryesor dhe përgjegjës për çështje të tilla, siç është Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Në ballinën e “Mësimi i shkurtër mbi namazin dhe Jasini Sherif”, është paraqitur një vizatim i Xhamisë së Madhe të Prishtinës, ashtu siç e ka parë artisti që e ka vizatuar atë, prandaj ky fakt natyrisht që ka domethënien e tij, sepse lexuesit shqiptar i ofrohet pamja e një objekti monumental islam në qendër të Prishtinës në një vepër me domethënie të veçantë, siç është mësimi i namazit në gjuhën shqipe. Mendojmë se edhe sot literatura dhe periodiku në gjuhën shqipe kanë nevojë dhe duhet që nëpër ballinat dhe faqet e tyre të kenë sa më shumë ilustrime dhe fotografi të monumenteve tona islame dhe t’i promovojnë vlerat tona islame autoktone.

(vijon)

- 1 Bajram ef. Agani ishte themelues i BI-së së Kosovës, themelues i Medresesë dhe i bibliotekës. Nismat për përkthimin e literaturës në gjuhën shqipe dhe një sërë ndërmarrjesh të tjera, shënojnë epokën e hafëz Bajram ef. Aganit dhe kur kësaj ia shtojmë edhe rrethanat e vështira në të cilat ai veproi, lirisht mund të themi se hafëz Bajram ef. Agani mbetet personaliteti më emblematic në historinë e re të BI-së së Kosovës.
- 2 Ramadan Shkodra, Bibliografi e revistës «Edukata Islame» (1971-2016), Prishtinë, 2017, f. 8.
- 3 Mr. Qemajl Morina, Myderriz Hfz. Bajram ef. Agani, Jeta dhe vepra (1899-1962), Prishtinë, 2015, f. 70, 71.
- 4 Ilmihal i vogël, f. 5.
- 5 Ibid, f.72.
- 6 Mehmet Gjevari ishte autori i Abetares së parë shqipe në Kosovë, mësuesi, pedagogu, dhe veterani i arsimit dhe përkthyes nga gjuha boshnjake e “Mësimi i shkurtër mbi namazin dhe jasini sherifi”. Ramadan Shkodra, Literatura Islame në gjuhën shqipe në Kosovë (1957-2017), fillat, tradita, sfidat dhe sukseset, përmbledhje kumtesash nga tryeza shkencore (Prishtinë, 27 dhjetor 2017), Prishtinë, 2019, f.72.



Hafëz Selim ef. Hoshi, myezini i njohur shqiptar i xhamisë së “Sulltan Fatihut” në Sarajevë

Bajro Perva

Shqiptarët në Sarajevë janë një nga pakicat kombëtare më në numër. Ata në kryeqytetin tonë, në Sarajevë dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë janë të pranishëm për disa shekuj. Sipas gjurmëve të shkruara, shqiptarët e parë kanë ardhur gjatë Perandorisë Osmane, kryesisht për shkak të gjendjes ekonomike, politike dhe shoqërore në territoret shqiptare, ndërsa kanë ardhur kryesisht nga Shqipëria Veriore. Gjatë kohë së Perandorisë Austro-Hungareze, numri i shqiptarëve dukshëm është zvogëluar. Sipas regjistrit të popullsisë së vitit 1910, vetëm 273 banorë në Bosnjë ishin që flisnin gjuhën shqipe.

Sipas vlerësimeve të shoqatave shqiptare, në hapësirën e Federatës, në vitin 2015, kanë jetuar në mes 7000-10.000 pjesëtarë të kësaj pakice kombëtare, ndërsa numri më i madh i tyre jetojnë në Sarajevë, Tuzëll, Zenicë, Mostar, Bihac etj..

Shqiptarët në Bosnjë dhe Hercegovinë kryesisht janë të përkatësisë së fesë islame dhe katolike, ndërsa te ky popull është karakteristikë se kurrë nuk kanë pasur konflikte ndërmjet vete në baza fetare. Shumë nga ta janë intelektualë dhe ndërmarrës të shquar. Me punën e tyre kanë fituar status të duhur në shtetin të cilin e kanë pranuar si të vetin.

Në Sarajevë jeton edhe familja shqiptare Hoshi. Para shtatëdhjetë vitesh, nga Gjakova ku kanë lindur, Gani dhe Ganimete Hoshi, janë shpërngulur në Sarajevë. Më parë kanë menduar të shpërnguleshin në Turqi, por nafaka i solli në Sarajevë, në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në qytetin buzë Miljackës, iu lindën katër djem e një vajzë. Krahës punës private, rahmetli Ganiu ishte edhe myezin në “Xhaminë e

Sipas regjistrit të popullsisë së vitit 1910, vetëm 273 banorë në Bosnjë ishin që flisnin gjuhën shqipe.

Begut” dhe të “Sulltan Fatihut”, me ç’rast ka përfutur miqësi të shumta. Ezani i tij ishte i veçantë dhe shumë i këndshëm për njerëzit të cilët e kanë dëgjuar. Tre djemtë e tij kanë vazhduar punën e biznesit familjar, ndërsa vetëm hafëz Selimi ka kryer Medresenë e “Gazi Husrev Beut” dhe ka vazhduar rrugën e babait të tij, atë të myezinit.

Tash e disa dekada është i lidhur me xhaminë e “Sulltan Fatihut”. Xhematlitë e kanë përcjellë me besnikëri misionin e tij vetëmohues në xhami, dhe me iniciativën e kolegut të tij, imamit hafëz Sadrudin ef. Isheriqit, kanë vendosur që për Ramazanin në ardhje, t’ia përgatisin një befasi të pazakontë. Kanë vendosur që për të dhe për bashkëshorten e tij, znj. Nuriye, t’ua paguajnë umren e Ramazanit. Të hollat për rrugën e tyre i kanë grumbulluar për një kohë të shkurtër,

ndërmjet namazit të drekës dhe ikindisë. Shpejtësia e grumbullimit të mjeteve financiare flet se sa hafëz Selimi dhe familje e tij janë të dashur për këtë xhematë sarajevase.

Lidhur me këtë lajm, kam vizituar familjen e hafëz Selim ef. Hoshit dhe nga dora e parë kam dashur të zbulojë detajet e këtij gjesti të pazakontë, se si ai dhe bashkëshortja e tij kanë reaguar kur kanë pranuar këtë lajm.

“Nga xhemati kanë pyetur fëmijët tanë se a kemi ne të dy pasaporta. Dhe pas saj kanë porositur që ne të dy patjetër të vijmë në mbrëmje në xhami. Imami hafëz Isheriqi më ka porositur që menjëherë të vijmë, pasi që do të ketë një ceremoni të vogël”. Ne kemi ardhur pa ditur se çfarë po përgatitej. Pas programit të shkurtër, hafëz Isheriqi më dha zarfin të lexoja se çka shkruan në të. Ndërsa në zarf shkruante:



Hafëz Selim ef. Hoshi

“Hedia - umra e Ramazanit nga xhematlitë dhe shokët e xhamisë së “Sulltan Fatihut”. Brenda në zarf ishte letra në të cilin shkruante: “Hafëz Selim ef. Hoshi dhe zonja Nuriye Hoshi, kjo është hedia nga xhematlitë dhe imami për tërë shërbimin tuaj në xhaminë e “Sulltan Fatihut” për gjatë gjithë këtyre viteve! Allahu ua bëftë kabull ibadetet dhe të na kujtoni edhe neve në duatë tuaja!”. Pyeta mos është ndonjë gabim! Të gjithë thanë që nuk është, dhe më pastaj ia nisën ilahisë emocionuese “Në Medine unë u nisa”, e cila nuk e lë askënd indiferent. “Kjo do të jetë mungesa ime e parë për Ramazan në Sarajevë.”

AMANETIN E MYEZINIT E KAM TRASHËGUAR NGA RAHMETLIU, BABAI IM, HAXHI GANIU

Hafëz Selimi më ka treguar për gjenezën e familjes Hoshi, për zhvillimin e saj, udhëtimet nëpër botë dhe kohë. “Prindërit e mi janë nga Kosova, nga qyteti i Gjakovës. Në Sarajevë kanë ardhur para 70 vitesh. Babai dhe xhaxhallarët e mi gjatë Luftës së Dytë Botërore kanë punuar si bukëpjekës për ushtrinë italiane në Shqipëri. Aq shumë fitonin sa që për një muaj kanë mundur të fitonin para sa për të ndërtuar një shtëpi. Në fund, një njeri ka ardhur në mirëbesim dhe u kanë thënë që të ktheheshin menjëherë në Kosovë, sepse komunistët e Enver Hoxhës do t’i vrisnin. I mblodhën plaçkat dhe ikën, ndërsa atje u mbeti i tërë fitimi. Një kohë kanë jetuar në Prizren. Babai këndonte ezanin në xhaminë e njohur të “Sinan Pashës” në Prizren. Kur kanë ardhur në Sarajevë, babai nga minarja e “Xhamisë së Begut” e ka thirrur ezanin. Kur këtë e ka dëgjuar Mujaga Merhemiqi, babës dhe dy vëllezërve të tij, të cilët kanë ardhur me të, ua ka lëshuar shtëpinë pa qira, që të banonin për pesë vjet. Por nga baba im ka kërkuar që për këto pesë vjet të jetë myezin. Babai dhe xhaxhallarët janë marrë me tregti. Babai ka shprehur dëshirën që pas ndërrimit jetë, në Ahiret të jetë i varrosur në Bosnjë.

Shumë e ka dashur Bosnjën. Ka folur se në Bosnjë janë myslimanët më të mirë në botë. Ka qenë i gëzuar pa masë kur e regjistrova Medresenë.”

NUK KA MËSUAR GJUHËN BOSHNJAKE, NË MËNYRË QË ME FËMIJËT E SAJ TË FLISTE SHQIP NË SHTËPI

Nëna e hafëz Selimit, Ganimetja, tashmë ka hyrë në moshën 95-vjeçare. Është mirë me shëndet. Është krenare me djalin e saj hafëz dhe me fëmijët e tjerë. Dëshiroja të dëgjoja edhe një pjesë të saj të tregimit familjar. Ka folur në shqip, ndërsa përkthimin e bënin hafëz Selimi dhe nusja Nuriya: “Sa po plakem më shumë, aq më shumë po më ngre dëshira që të kthehem në Kosovë. Këtu nuk kam bashkëmoshatare dhe shoqe (dikush i tha, me kaq vite sa ke, edhe atje nuk ke). Me qëllim nuk e kam mësuar gjuhën boshnjake, që në shtëpi të flas shqip, ashtu që fëmijët të mësojnë shqipen. Kështu që, sot djemtë dhe vajza ime, madje edhe nipat, flasin shqip.

Kur e kujtoj bashkëshortin, rahmetli Ganiun, më së shpeshti më bjerë ndërmend momentet kur ai i binte njerëzit për kafe në shtëpinë tonë. Cilido të njohur që e takonte rrugës e binte në shtëpi. Mua nuk më ka penguar. Kur ka vdekur, shoqet e mija më pyesnin për çfarë më së shumti më mungon, unë iu përgjigjsha: “Në fjalosjet e vogla të mëngjesit.”

Në rrëfimin e saj u ndërlihd edhe hafëz Selimi: “Nëna, për fat të keq, nuk ka shkuar në shkollë. Megjithatë, ishte jashtëzakonisht inteligjente dhe ka ditur të mësojë nga përvoja e jetës.” Kur me një rast ka dal në gazetë, i ka thirrur motrat e saj në Kosovë dhe u ka thënë: “Ju keni sado-kudo shkollë, unë nuk kam as një klasë të vetme, por unë dola në gazetë. Po ju, ku jeni ju!”

Burimi: stav.ba

Përktheu: Faik Miftari

Haxhi në kohë

ORGANIZIMI I HAXHIT NË KOHËN OSMANE DHE DISA TË DHËNA BURIMORE PËR HAXHILERËT E KOSOVËS GJATË SHEKULLIT XVIII-XX

Dr. Agron Islami

Kronikat osmane sjellin informacion se titulli “*Halife*”, kapo siç njihet në literaturën evropiane “*Kalif*” tek osmanët kishte filluar së përdoruri qysh nga koha e sundimit të Sulltan Muradit të Parë (1359-1389). Megjithatë ky titull, tek osmanët, nuk nënkuptonte pushtetin politik të halifes mbi të gjithë myslimanët e botës, por më shumë ishte epitë i një sundimtari lokal, i cili udhëhiqej me parimet e Sheriatit.¹

Ky realitet vazhdoi deri në vitin 1517, respektivisht deri në rënien e sundimit të Emevitëve në Egjipt, sundim i cili u shpërbë si rezultat i humbjes së këtyre të fundit karshi ushtrive osmane të udhëhequra nga Sulltan Selimi i Parë (1512-1520) në Merxhidabik (1516) dhe Ridanije (1517). Kështu, me shpërbërjen e dinastisë Emevite edhe kalifati/hilafeti kaloi në duart e sultanëve osman, të cilët udhëhiqnin me ligjin e Sheriatit. Nga këtu e tutje, Sulltan Selimi i Parë (1512-1520), i mbiquajtur Javuz, titujve të tij, ia shtoi edhe epitëtin më të ri Hâdimü'l-Haremejn-i Şerifejn, që nënkupton shërbëtorin e dy vendeve të Shenjta, atë të Mekës dhe të Medinës.²

Pas fitores dhe hyrjes në Kajro, Sulltan Selimi, nxori edhe fermanët e parë, të cilët kishin të bënin me tatime dhe me të drejtat që do të gëzonin banorët lokal, përderisa njihnin autoritetit shtetëror osman. Në të njëjtën kohë, ai sanxhakbeun e Karesinjve, Behram Beun, e emëroi për kryesues (emirulhaxh) të delegacioneve të vizitorëve të Qabesë.³


Menjëherë pas marrjes nën kontroll të Egjiptit, respektivisht më 3 korrik të vitit 1517, sultani mori njoftimin për ardhjen e djalit të Sherifit të Mekës, Ebu Numejit. Takimi në mes sultanit dhe përfaqësuesit të Mekës u realizua më 6 korrik. Sulltani e priti me nderime të larta djalin e sherifit, sa që kronistët shkruajnë se Ebu Numeji ishte ulur bashkë me sadriazamin (kryeministrin) dhe kadiasqerët osman karshi sultanit. Ebu Numeji kishte ardhur te sultani për të kumtuar gatishmërinë e njohjes së sundimit osman dhe autoritetin e sultanit.⁴ Njëherësh, përfaqësuesi i sherifit kishte specifikuar edhe kushtet dhe privilegjet që sultani duhej t'i kishte parasysh karshi vendeve të shenjta. Njëri ndër këto ishte edhe furnizimi i banorëve të Mekës dhe Medinës me grurë pa asnjë pagesë.

Si rezultat i këtij realiteti të ri politik, edhe organizimi i haxhit kaloi në përgjegjësinë e kalifit të ri, në këtë rast, sultanit osman, i cili në radhë të parë duhej të siguronte rrugët që çonin drejt dy vendeve të shenjta (Mekës e Medinës), që jo rrallëherë karvanët e haxhilerëve ishin cak i sulmeve të fshatarëve. Sipas shkresave zyrtare osmane nënkuptohet se, para se regjimenti ushtarak (surre Alaylari) të nisej për rrugë me dhurata për vendet e shenjta, lëshoheshin fermane për autoritetin osman të zonave nga kalonin haxhilerët të shoqëruar me regjimentet ushtarake osmane që të bënin përgatitjet e nevojshme për pritjen e kandidatëve për haxhi. Kjo nënkuptonte që të rritej niveli i sigurisë karshi sulmeve bandite, të bëheshin furnizimet e nevojshme me ushqime, të siguroheshin për vende të lira nëpër hane dhe menzile ku pushonin kandidatët për haxhi, ose pelegrinët.⁵

Me kalimin e titullit të kalifit te sultani osman, edhe kryeqendra e kalifatit u bë Stambolli, njëherësh kryeqytet i Dvletit Osman. Kështu dhe pikëtakimi më i madh kandidatëve për haxhi bëhej në Stamboll. Respektivisht, të interesuarit për të kryer haxhin, më 10 të muajit rexhep, duhej të ishin në Yskydari (qytezë e Stambollit), nga ku nisej karvani i haxhilerëve. Ky karvan përbëhej edhe nga shumë dhurata në ari dhe gjëra të tjera të çmueshme që sultani dhe familja e tij i dërgonte për banorët e vendeve të shenjta. Një traditë e cila ka zanafillën që nga Sulltan Bejaziti i Parë, i cili fronin e mori në Fushë Kosovë, pas betejës së parë të Kosovës të vitit 1389.⁶

Karvanët shoqëroheshin nga Jeniçer dhe Spahinjë osmanë, të cilët kishin për detyrë mbrojtjen e karvanëve nga sulmet e bandave të ndryshme gjatë rrugës. Sipas të dhënave zyrtare, karvani i haxhilerëve në kohën e sundimit të Sulltan Sylejmanit, i mbiquajtur Kanuni (ligjëvënës) përbëhej nga 150 jeniçerë dhe 100 spahinjë.⁷

Studiuesja e mirënjohur, Suraiya Faroqhi, ka vërtetuar se 2% e buxhetit qendror osman shpenzohej në mirëmbajtjen e ndërtesave në Meke dhe Medine, si dhe për sigurinë e rrugëve që kalonin karvanët e haxhilerëve. Dhe duke qenë se pas problemit të grupeve banditeske që sulmonin haxhilerët, problemi më i madh ishte siguri i ujit në thatësira e gadishullit me temperatura të larta. Andaj, administrata



Qabeja, gravurë e realizuar nga Berthauld

osmane në vazhdimësi përkujdesej në mirëmbajtjen e çezmave dhe puseve që ishin hapur nëpër menzile-vendpushimet që shërbenin për pushime dhe furnizime me ujë. Njëherësh, njëra nga kërkesat e sherifit të Mekës, që i ishte bërë Sulltan Selimit, ishte edhe investimi dhe mirëmbajtja e puseve me ujë të pijshëm për fshatarët në rrethinë të vendeve të shenjta.⁸

Rruga nëpër të cilën kalonte karvani i haxhilerëve fillonte në Yskyardar të Stambollit kalonte në Gebze, Eskishehir, Konja, Adana, Antakja, Halep për të shkuar drejt Shamit/Damaskut, i cili ishte edhe pikëtakim me haxhilerët e zonave të tjera të Arabisë. Ndërsa karvani i haxhilerëve që vinin nga Afrika Veriore pushimin e bënë në Kajro dhe më pas kalonin nëpër shkretëtirën arabe për të arritur në Hixhaz. Sipas një traktati anonim, të shkruar në vitin 1780, haxhilerët që vinin nga zonat e Rumelisë osmane, apo hapësirës së Ballkanit të sotëm, ndiqnin rrugën deri në Stamboll dhe nga aty kalonin nëpër

Damask drejt Hixhazit. Në këtë traktat janë përmendur 76 menzile-bujtina që përdorshin për pushime gjatë udhëtimit të gjatë rreth 3 muajsh që realizohej nga kandidatët për haxhi.⁹

Rrugëtimi deri në Sham/Damask bëhej me kafshë personale të pelegrinëve, apo kandidatëve për haxhi. Ndërsa nga këtu e tutje vazhdonin me deve, të cilat i merrnin me qira. Kjo bëhej edhe për shkak të klimës dhe deveja si kafshë e zonës që ishte, i përshtatej kësaj klime të nxehtë. Njëherësh duhet theksuar se, studiues të ndryshëm kanë sjell dëshmi se, pushimet e pelegrinëve deri në Damask bëheshin nëpër hane dhe menzile të veçanta që ishin ngritur pikërisht për këtë qëllim, mirëpo nga Damasku e deri në vendet e shenjta, këto pushime mund të jenë bërë nëpër çadra e shatorë të ndryshëm, meqë nuk ka dëshmi për ekzistimin e haneve në këto hapësira.¹⁰

Pas hapjes së kanalit të Suezit më 1869, udhëtimi për në vendet e shenjta mund të realizohej edhe me anije. Kjo bëhej nga Stambolli nëpërmjet Detit të Kuq në limanin e Xhides. Një formë tjetër e udhëtimit ishte edhe ajo me tren, hekurudhë e cila ishte projektuar nga ana e Sulltan Abdulhamitit të Dytë (1876-1909). Projekti i Sulltan Abdulhamitit synonte që fillimisht të bëhej hekurudha deri në Meke. Më pas të lidhet me Xhiden dhe si rrugë alternative të bëhet edhe rruga me hekurudhë nga Meka për në Akabe, Jemen, Nexhid dhe Bagdad. Kështu, me 1 shtator të vitit 1900, në Damask, kishin filluar punimet për ngritjen e hekurudhës, ku kishin marrë pjesë zyrtarë të shumtë osmanë, kori diplomatik i huaj dhe shumë media. Kjo hekurudhë, e cila ishte emëruar si hekurudha e Hixhazit, për shkak se bashkonte të gjithë myslimanët e zonës, përbënte rrezik të nivelit të lartë për fuqitë evropiane të huaja që kishin hartuar politika koloniale në këtë zonë. Karshi lëvizjeve për të penguar këtë projekt, sultani kishte paraparë që hapësirat nga do të kalonte rruga e trenit të popullohej vetëm me banorë të besimit islam. Kështu pas punimeve të vazhdueshme, me 27 gusht 1908, me prezencë të burokratëve osmanë dhe shumë mysafirëve nga diplomacia dhe media u lëshua dhe treni i parë nga Damasku

Emri	Vendvarrimi	V. i vdekjes
Haxhi Mustafa Tasholli, i biri i Alitashit nga Gadimeja ¹²	Oborri i Xhamisë së Gadimës	07.09.1726
Haxhi Mehmedi, i biri i Ahmedit ¹³	Varrezat e Prishtinës	1879
Sylejmani, i biri i haxhi Shabanit ¹⁴	Varrezat e fshatit Shtuticë, Drenas	1887
Mahmudi, i bir i haxhi Dautit ¹⁵	Varrezat e Stanocit të Poshtëm	1891
Mihon Osman Aga, i biri i haxhi Hazirit ¹⁶	Dhoma e artefakteve në Muzeun e Vushtrrisë	
Haxhi Ahmedi, i biri i Hysejnit ¹⁷	Oborri i xhamisë së Milloshevs	
Jakup efendiu, i biri i haxhi Mehmedit ¹⁸	Sadovinë e Çerkezve – Viti	1876
Haxhi Bajram Efendiu, i biri i Ahmedit ¹⁹	Oborri i Xhamisë - Ferizaj	1886
Haxhi Ahmedi, i biri i Munish Agës ²⁰	Oborri i Xhamisë në Reçak	1902

për në Medine. Si rezultat i kësaj hekurudhe, rruga e cila merrte rreth 40 ditë me deve, tani arrihej me vetëm 72 orë, por që, me rrëzimin e sulltanit nga pushteti më 1909, projekti mbeti i parealizuar, madje u pasivizua edhe rruga Damask-Medine, si rezultat i luftërave dhe bombardimit të një pjesë të hekurudhës nga ana e anglezëve.¹¹

HAXHILERËT NGA KOSOVA GJATË SHEK. XVIII-XX

Ashtu siç u cek më lartë, vizitorët e vendeve të shenjta nga hapësira e Ballkanit ndiqnin itinerarin rrugor nga vendlindja e tyre, në Stamboll dhe nga aty bëheshin bashkë me kandidatët e tjerë dhe vazhdonin drejt Damaskut. Fakti që mungojnë regjistrat e kadinjve osmanë të Kazave - gjykatave të Kosovës, nuk mund të kemi informacione mbi numrin e saktë të haxhilerëve, ngase siç dihet, kandidatët për haxhi, pasi që i bënin të gjitha përgatitjet, linin një testament të shkruar, të cilin e zyrtarizonin te kadiu. Ky testament bënte fjalë për pasurinë dhe në rast se vdiste gjatë rrugës, tregonte në detaje se çfarë do bëhej me këtë pasuri. Sipas studimeve të deritanishme, të bëra nga të dhënat e sixhileve nënkuptohet se, këta regjistra përmbajnë të dhëna edhe për testamente të kandidatëve të cilët kishin vdekur pasi që kishin bërë testamentin dhe nuk kishin arritur të marrin rrugën për në haxh.

Duke qenë se studiuësja, Suraiya Faroqhi, në studimin e saj të detajuar, përveç testamenteve ka marrë për bazë edhe titullin haxhi të palëve që kanë qenë pjesë e vendimeve të ndryshe të lëshuara nga kaditë, qoftë si dëshmitar të një gjyqi, apo të përfshirë në vendime që për tematikë kanë shitblerjen, apo edhe vendimet që kanë të bëjnë me shkelje, ka krijuar një standard shkencor që na mundëson edhe neve të bëjmë identifikimin e haxhilerëve nga Kosova. Për ta bërë këtë identifikim, kemi përdorur të dhënat e epitafeve me mbishkrim osman, të gjetura në Kosovë. Kështu, mbi këto të dhëna të epitafeve, kemi identifikuar 11 haxhilerë nga Kosova, të cilët e kanë kryer haxhin në kohën e sundimit osman dhe të cilët po i japim në formë tabelare.

Të dhënat e mësipërme ofrojnë fakte të reja në raport me historinë e haxhilerëve nga Kosova, njëherësh këto fakte burimore shpërfaqin edhe përkushtimin e myslimanëve shqiptarë të hapësirës së Kosovës për të plotësuar njërin nga kondiditat kryesore të Islamit, atë të kryerjes së haxhit.

Të dhënat e epitafit të gjetur në Gadime të Lipjanit, ofrojnë informacion për njërin nga haxhitë e parë të kësaj zone, i cili kishte vdekur në vitin 1726. Një datë e cila orientimisht na bën të mundur që të supozojmë se historia e vizitës së vendeve të shenjta nga shqiptarët me qëllim të kryerjes së haxhit i takon shekullit XVII.




Foto e fillim shekullit XX

- 1 Azmi Özcan, "Osmanlı Döneminde Hilafet", Dianet İslam Ansiklopedisi, Cild 17, İstanbul: Dianet Vakfı Yayınları, 1998, f. 546.
- 2 Mustafa Sabri Küçükbaş, "Mekke", Dianet İslam Ansiklopedisi, Cild 28, İstanbul: Dianet Vakfı Yayınları, 2003, f.563
- 3 Feridun M. Emecen, *Yavuz Sultan Selim*, İstanbul: Hazine Yayınları, 2010, f.302.
- 4 Ibid.
- 5 Suraiya Faroqhi, *Pilgrims and Sultans, The Hajj under the Ottomans 1517-1683*, London-New York: I.B. Tauris & Co Ltd, f. 54
- 6 Tufan Buzpinar, "Surre" Dianet İslam Ansiklopedisi, Cild 37, İstanbul: Dianet Vakfı Yayınları, 2009, f. 567.
- 7 Ibid.
- 8 Suraiya Faroqhi, *Pilgrims and Sultans, The Hajj under the Ottomans 1517-1683*, London-New York: I.B. Tauris & Co Ltd, f. 61.
- 9 A. Latif Armağan, "XVIII. Yüzyılda Hac Yolu Güzergâhı ve Menziller (=Menâzilü'l-Hacc)", *Osmanlı Araştırmaları*, nr. XX, İstanbul, (2000), 76.
- 10 S. Faroqhi, *Pilgrims and Sultans*, f.64.
- 11 Ufuk Gülsoy, William Ochsenwald, "Hicaz Demiryolu", Dianet İslam Ansiklopedisi, Cild 17, İstanbul: Dianet Vakfı Yayınları, 1998, f. 444.
- 12 Agron Islami, Selim Selimi, Hatixhe Ahmeti, *Epitafet në Gjuhën Osmane, Dëshifrimi dhe Përkthimi i tyre, Regjioni i Prishtinës, vëllimi 1, Prishtinë: Fakulteti i Studimeve Islame*, 2017, f. 94
- 13 Ibid. f. 94
- 14 Agron Islami, Selim Selimi, , *Epitafet në Gjuhën Osmane, Dëshifrimi dhe Përkthimi i tyre, Regjioni i Mitrovicës, vëllimi 2, Prishtinë: Fakulteti i Studimeve Islame*, 2019. f. 163.
- 15 Ibid, f. 121
- 16 Ibid, f. 85, guri është i thyer dhe viti i mungon.
- 17 Ibid, f. 153, guri është i thyer dhe viti i mungon.
- 18 Agron Islami, Selim Selimi, , *Epitafet në Gjuhën Osmane, Dëshifrimi dhe Përkthimi i tyre, Regjioni i Gjilanit, vëllimi 3, Prishtinë: Fakulteti i Studimeve Islame*, 2021, f. 197.
- 19 Agron Islami, Selim Selimi, , *Epitafet në Gjuhën Osmane, Dëshifrimi dhe Përkthimi i tyre, Regjioni i Ferizajt, vëllimi 4, Prishtinë: Fakulteti i Studimeve Islame, (në Botim).*
- 20 Ibid.

Konvertimi i shqiptarëve myslimanë në fenë ortodokse në Sanxhakun e Nishit

Prof. dr. Jusuf Osmani

Më 1 dhjetor të vitit 1877, Serbia në aleancë me Rusinë, i shpall luftë Perandorisë Osmane. Ushtria serbe filloi fushatën më tragjike që është zhvilluar ndonjëherë në Ballkan kundër popullsisë së pambrojtur shqiptare

Sipas thënieve të Kuranit, çdo njeri duhet ta dojë vendin e vet dhe e ka për detyrë t'i dalë zot atij në rast rreziku. Pra, fetari i mirë është edhe atdhetar i mirë.

Shqiptarët deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX jetonin në shumicën e vendbanimeve të Sanxhakut të Nishit. Sanxhaku i Nishit ishte njësi administrative-territoriale e Perandorisë Osmane në kuadër të Vilajetit të Kosovës me qendër në Nish, qytet i lashtë, qendër e Dardanisë ilire. Përbëhej nga kazatë e Nishit, Urkupit (Prokuplës), Kurshumlisë, Vranjës, Leskovcit, Sharkoyt (Pirotit) dhe Izbolit (Tërnit). Në Sanxhakun e Nishit jetonin rreth 250.000-300.000 banorë shqiptarë autokton në 716 vendbanime.

Më 1 dhjetor të vitit 1877, Serbia në aleancë me Rusinë, i shpall luftë Perandorisë Osmane. Ushtria serbe filloi fushatën më tragjike që është zhvilluar ndonjëherë në Ballkan kundër popullsisë së pambrojtur shqiptare, por edhe të tjerëve myslimanë të Sanxhakut të Nishit. Sipas të dhënave të pakonfirmuara, më se 70.000 banorë shqiptarë u vranë, masakruan apo vdiqën nga të ftohtit, uria etj..

Brenda një periudhe dymujore, dhjetor 1877- janar 1878, u bë spastrimi etnik i shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit. Me vendimet e Kongresit të Berlinit, Serbisë i njihet si territor i saj aneksimi i tokave shqiptare në sipërfaqe prej 10.972 km² dhe pronës së shqiptarëve i realizuar përmes

spastrimit etnik, vrasjeve, masakrave dhe dëbimit të shqiptarëve nga vendi i tyre.

Serbia zyrtare filloi menjëherë kolonizimin e vendbanimeve të Sanxhakut të Nishit me elementin sllav në vend të shqiptarëve të shpërngulur. Shqiptarët e dëbuar që quheshin muhaxhirë (refugjatë) gjetën strehim në territorin e Kosovës, të Maqedonisë, Luginës së Preshevës, si dhe shumë prej tyre u shpërngulën në Turqi dhe nga aty në vendet arabe.

Shumë shqiptarë, për arsye të ndryshme, nuk kishin mundur të largoheshin nga Sanxhaku i Nishit. Por, shkaqet kryesore ishin këto: varfanjakët nuk kishin si të largoheshin, pasi nuk kishin mjete transporti, sidomos të qyteteve dhe të qytezave, e disa të tjerë për t'i ruajtur pasuritë dhe pronat mbesin aty, me shpresë se gjendja do të rregullohej. Madje disa fëmijë kishin mbetur nëpër shtëpitë e tyre ose gjatë rrugës dhe nuk kanë arritur të arratisen që andej. Disa shqiptarë kishin mbetur në Toplicë, meqë gjatë dëbimit të dhunshëm e të menjëhershëm nuk kanë qëlluar në shtëpi, kanë qenë nëpër ara, livadhe e me bagëti duke i kullotur. Këta kanë mbetur në Sanxhak të Nishit dhe atje edhe sot jetojnë pasardhësit e tyre, por të asimiluar, domethënë të serbizuar. Në qytetet dhe qytezat e Sanxhakut të Nishit, përveç varfanjakëve kishin mbetur edhe disa tregtarë, zejtarë, pronarë të tokave të shumta e të tjerë.

Shqiptarët e Sanxhakut të Nishit ishin kryesisht të fesë myslimane, por ka pasur



*Gjenocidi malazez ndaj boshnjakëve dhe shqiptarëve.
Ndërrimi më dhunë i fesë, nga ajo myslimane në atë ortodokse, Guci, 1913.*

edhe të fesë katolike, aty-këtu edhe të fesë ortodokse. Feja islame, me opsionet e saj për paqe, dashuri e mirëkuptim, jo vetëm midis besimtarëve të saj, por edhe me bashkatdhetarët me fe tjetër, ka krijuar e krijon një bazament të fuqishëm për qëndrueshmërinë, mbijetesën dhe unitetin e kombit shqiptar. Së këndejmi, nuk është e rastësishme se nga radhët e dijetarëve, atdhetarëve, patriotëve e tjerë gjatë historisë kanë dalë personalitete të njohura, të cilët kanë punuar, vepruar dhe kontribuar në aspekte të ndryshme si atë kombëtar, arsimor, kulturor, fetar, edukativ etj..

Pushteti ushtarako-policor serb, pas pushtimit të Sanxhakut të Nishit më 1877-78, zbatoi edhe metodën e konvertimit, të ndërrimit të fesë më dhunë. Në shumë dokumente të kohës nga viset e ndryshme shqiptare, raportuesit serbë gënjenin duke deklaruar se “se shqiptarët po shprehin dëshirë të kalojnë në fenë ortodokse”. Ndërkaq nga i njëjti raportues, bëhen kërkesa për përf forcime të mbajtjes së rendit e të qetësisë gjatë ndërrimit të fesë dhe çarmatosjes së shqiptarëve. Këtyre veprimeve dhe metodave djallëzore, iu kundërviheshin sidomos veprimtarët shqiptarë, hoxhallarët dhe priftërinjtë shqiptarë. Pushtuesit dhe kleri i kishës së tyre ortodokse, shpresonin se nëpërmjet ortodoksizmit do të zgjidhnin njëherë e përgjithmonë problemin e sllavizmit të territoreve të okupuara shqiptare.

Duhet theksuar se shqiptarët myslimanë dhe ata katolikë vështirë asimiloheshin, kurse ata ortodoksë më lehtë, kuptohet sepse e kishin një kishë të përbashkët. Por, shqiptarët myslimanë, të mbetur në Sanxhak të Nishit, pas një kohe të caktuar, në rrethana të tjera filluan të asimiloheshin ose të konvertohen në fenë ortodokse. Mirëpo, një kohë të gjatë

disa myslimanë (lexo: shqiptarë, J.O.) i kishin bërë rezistencë konvertimit në fenë ortodokse.

Përkitazi me këtë, në vitin 1939, hafëz Muhamed Panxha, në revistën “Glasnik Islamske Vjerske Zajednice BiH”, VIII, nr. 1/1940, kishte botuar punimin me titull “Kryqëzimi i myslimanëve në rrethinën e Nishit”, “Pokrštavanje muslimana o okolici Niša”, Sarajevë, 31 dhjetor 1939, të cilin po e paraqesim në tërësi.

Gazeta beogradase “Vreme” e datës 16 nëntor të këtij viti ka sjellë një artikull me titull: “Dhjetë familje me 40 anëtarë janë kryqëzuar në fshatin Malçë te Nishi”, ku është paraqitur puna e mjerë e disa priftërinjve ortodoksë, të cilët mundohen që myslimanët e varfër t’i kthejnë në ortodoksi, kështu që të dëshmojnë se si me sakrificë po e kryejnë “misionin e tyre baritor”. Këtë lajm për kryqëzimin e myslimanëve në rrethinën e Nishit e ka ndjekur me çudi edhe shtypi i huaj, duke e theksuar si dukuri shumë të mjerueshme në shekullin e sotëm të liberalizmit fetar, dhe që bie ndesh me bindjet e njerëzve dhe familjeve të caktuar, që me mjete të ndryshme prozelite njerëzit e varfër të ndërrojnë fenë. Kjo ngjarje e mjerueshme ka shkaktuar shqetësim të madh dhe të kuptueshëm në tërë opinionin e gjerë mysliman, i cili këtë e ka pranuar më habi dhe ka shkaktuar indinjatë dhe fyerje, që në këto ditë fatale dhe të vështira, në një anë të caktuar, e godasin vetëdijen dhe bindjen fetare të myslimanëve. Kjo indinjatë është edhe më e madhe, meqë me Ligjin për Bashkësinë Islame, në nenin 11, ndalohet çdo propagandë fetare nga jashtë në mesin e myslimanëve. Përveç kësaj, nga aspekti shtetëror dhe popullor, është shumë e dëmshme dhe e rrezikshme, sepse krijon luftë fetare dhe fronte fetare që askujt nuk i duhet, ai i cili ia do të mirën dhe përparimin

shtetit tonë popullor. Dhe për këtë është i kuptueshëm dëshpërimi i myslimanëve, të cilët me zemër e duan këtë shtet dhe që kanë dhënë dëshmi të shumta për dashurinë dhe lojalitetin ndaj shtetit, të cilin papërmbytshëm e duan.” Autori i këtij artikulli me sugjerim të Reis-Ulemasë dhe me referentin e Ulema Mexhlisit në Shkup, ka shkruar për të shqyrtuar arsyet e këtij kryqëzimi masiv të myslimanëve.

“Që shkaqet e këtyre kryqëzimeve të myslimanëve të përcaktohen në mënyrë të drejtë, është e nevojshme të kthehemi në kohën e para 70 e më tepër vjetëve, kur këto vise, të cilat tanimë janë të banuara popullatë të shpërndarë myslimane, pushteti turk i ka lëshuar. Me shkruarjen e turqve nga këto vise, këta myslimanë i ishin lënë vetvetes në aspektin e jetës së tyre fetare. Pushteti serb në disa vende kishte caktuar hoxhë dhe i kishte paguar me mjete shtetërore, por puna e këtyre nëpunësve në ngritjen fetare nuk ka kaluar nga suazat e edukimit nga vendi i shërbimit. Vendbanimet myslimane të shpërndara në edukimin fetar kanë mbetur dhe i janë lënë vetvetes dhe derisa ka pasur disa njerëz të vjetër, i kanë mbështetur dispozitat myslimane dhe zakonet islame. Gjendja e këtyre vendbanimeve myslimane deri në luftërat ballkanike, në aspektin fetar, ishte mjaft e volitshme, sepse ka të bëjë me përzierjen e përhershme me jomyslimanët, që kanë filluar të marrin shumë zakone të krishtera, si p.sh. kremtimi i festave të pagëzimit dhe dhënia e emrave të krishterë fëmijëve të tyre. Organet shtetërore ishin mjaft tolerante, por edhe pushteti kishtar është përmbajtur ndaj çdo veprimi prozelitues në mesin e këtyre myslimanëve. Luftërat e gjata prej vitit 1912 deri në vitin 1918 kanë ndihmuar shumë që ritet fetare të këtyre myslimanëve gati në tërësi të jenë zbehur, dhe pas mbarimit të luftës, situata ka ndryshuar për të keq, kur priftërinjtë ortodoksë kanë filluar t’i bindin myslimanët që në masë të kalojnë në fenë ortodokse. Për këtë arsye, kanë ndodhur disa kryqëzime masive të vendbanimeve të largëta myslimane. Në disa vite të fundit, ky aksion pak është heshtur, por në dy-tre vjetët e fundit ka filluar në masë të madhe të aplikohet. Si pasojë e kësaj janë kryqëzimet masive të myslimanëve në Zhinipotok, të rrethit të Prokuples, që është bërë në maj të këtij viti, si dhe kryqëzimi i fundit në Malçë.

Nga ajo që është theksuar, shihet se rrethanat për zhvillimin e jetës fetare nëpër këto vendbanime të shpërndara myslimane në Nish dhe në rrethinën e tij ishin mjaft të pavoritshme. Deri në luftërat ballkanike nuk kishte në përgjithësi asnjë aksion për kryqëzimin e këtyre myslimanëve, por pas luftës, rrethanat ndryshuan dhe pushteti kishtar aktivisht ka marrë pjesë, e nganjëherë drejtpërdrejt kanë ndihmuar disa organe të pushtetit politik. Po të kishin më shumë mirëkuptim nëpunësit fetarë, të cilët, edhe pse në numër të vogël, kanë shërbyer në këto treva, që sa më shpesh të binin në kontakt me këta myslimanë, kjo propagandë nuk do të kishte kurrfarë

suksesi, edhe nëse do të kishte, ajo do të ishte e parëndësishme. Që 70 vjet, mijëra e mijëra nga këta myslimanë nuk kanë pasur asnjë hoxhë, e as që kanë pasur rastin të shohin se si kryhen detyrat fetare islame. Islami është ruajtur te ta vetëm sipas traditës, ka mbetur emri mysliman, ka mbetur e rrënjësuar ndjenja se i takon Islamit, po pa kurrfarë forme islame. Për këtë shkak, kanë mundur dhe janë detyruar në rrethanat e caktuara të përvetësojnë shumë zakone të krishtera, e më shumë ritet krishtere. Këta myslimanë i ishin lënë vetvetes, andaj edhe i ka gjetur ky fat i rëndë, që i dhemb në zemër çdo mysliman, kur sheh se sa ka gabuar dhe sa lëshime të mëdha ka bërë, duke i lënë këta myslimanë në fatin e rëndë. Nëse organet e Bashkësisë Islame që nga viti 1930, kur administrata unike shtrihej në tërë elementin myslimanë të këtij vendi, të merrnin me seriozitet këtë situatë të vështirë të myslimanëve të këtyre viseve dhe të kërkonin mënyrën e duhur të shërimit, jam i bindur që këto ngjarje të fundit të mjerueshme nuk do të ndodhnin. Sepse, siç kam theksuar, vetëdija islame, domethënë vetëdija që i takonin bashkësisë islame, te këta myslimanë është e fuqishme dhe e palëkundur. Kur e pyetni ndonjë mysliman të moshuar të moshës 60-70 vjeç, se pse ndihet mysliman, ai vendosmërisht dhe me krenari përgjigjet: “Unë jam mysliman, sepse edhe baba ishte mysliman, por edhe gjyshërit e mi më se 500 vjet e kanë mbajtur këtë fe dhe as unë nuk do ta lëshoj”. Po ashtu, edhe kur e pyetni ndonjë të ri, që kurrë nuk e ka parë hoxhën dhe asgjë nuk di për dispozitat islame, ai vetë me vetëdije përgjigjet: “Po, bre, mysliman jam dhe nuk dua të kryqëzohem”.

Te kjo duhet të theksoj se që Ulema-Mexhlisi i tanishëm në Shkup përpaket të ndërmarë masa të nevojshme për ngritjen fetare të këtyre myslimanëve, por fatkeqësisht nuk ka hasur në përkrahje të Këshillit të Saborit në Shkup, i cili u ka shkurtuar mjetet buxhetore të nevojshme për pagesën e disa nëpunësve fetarë në hapjen e mejtepeve.

Tani në pika të shkurtra se si ka ndodhur ky kryqëzim masiv i myslimanëve kohët e fundit, ku më së miri do të shihen shkaqet e këtij kryqëzimi.

Më 26 dhjetor 1939, në imamatin e xhematit në Prokuple, është mbajtur konferenca me myslimanët e shumtë të atjeshëm. Duke i pyetur për jetën e tyre fetare, kanë deklaruar se për ne myslimanët askush nuk është kujdesur, se fëmijët e tyre kurrë nuk e kanë mësuar mësimin fetar dhe se nuk kanë vijuar shkollën, por kohët e fundit gjendja po përmirësohet, sepse u ka shkruar një hoxhë i ri dhe i mirë, që po i mëson që të ruhen nga zakonet e këqija, në xhami i ka tubuar ata dhe sipas këshillës së tij në këtë vit shkollor kanë regjistruar mbi 40 fëmijë të tyre në shkollën fillore, e fëmijëve të tyre u mbahen edhe orët nga edukimi fetar. Ata janë edhe për atë që t’u hapet mejtepi, por janë të varfër dhe nuk janë në gjendje që ta mbajnë, andaj luten që vakëfi t’u hapë mejtepin. Duke i

pyetur për shkakun e kryqëzimit të myslimanëve në Zhinipotok, ata deklarohen se këta myslimanë kurrë nuk e kanë parë hoxhën dhe nuk kanë ditur se çka është feja islame.

Një prej atyre kaluesve, që atë ditë ishte në Prokuple, menjëherë është thirrur në dëgjim. Ai konvertues quhej Raim (tani Rajko) Huseinoviç dhe në deklaratën e tij në procesverbal thuhej: “Në maj të këtij viti kam kaluar në fenë ortodokse me fqinjët tjerë të mi nga fshati Zhinipotok, gjithsej 12 familje. Ky kalim ka qenë vullnetar dhe e vërtetoj se askush nga famullia ortodokse e as fqinjët nuk na kanë detyruar. Famullia gjatë kohës së pranimit na kanë premtuar se do të na japin prona dhe çdo zot shtëpie i janë dhënë, sipas numrit të anëtarëve të familjes, nga 45 deri 55 dinarë. Jam plotësisht i gatshëm dhe kam dëshirë që të kthehem unë në Islam, vetëm nëse pranojnë edhe fqinjët e tjerë të mi, e unë do të bisedoj me ta. Shkaku kryesor është se kurrë nuk ka ardhur imami, por edhe të vdekurit vetë i kemi varrosur, sepse nuk kemi mundur ta sjellim nga Prokupa, që është 40km larg nga fshati ynë. Më a është e njohur se famullia nuk e ka lajmëruar hoxhën tonë, se kemi kaluar në krishterim, si dhe as ne nuk e kemi lajmëruar, si dhe nuk kemi kërkuar kurrfarë dokumenti, por kemi ditur se jemi regjistruar në librin amë. Deklaroj se toka e premtuar kurrë nuk na është dhënë”.

Sipas kësaj deklarate shihet se në çfarë mënyre bëhej propagandë për kryqëzimin e myslimanëve dhe njëherësh konstatohet se ky veprim i priftit ortodoks në përgjithësi nuk u përgjigjet dispozitave ligjore për kalimin nga një fe në tjetrën. Pra, një propagandë e tillë ilegale me vete duhet të sjellë pasoja ligjore.

Me qëllim të ilustrimit më të mirë të kësaj propaganda ilegale, kam paraqitur edhe procesverbalin e deklarimit të myslimanëve të Malçës, ku është bërë kryqëzimi masiv si dhe deklarimi i një të konvertuari nga Vrezhina e Epërme afër Malçës.

Më 27 dhjetor 1939 kanë dhënë deklaratat këta persona:

1. Vulle Buniq, farkëtar nga Malça ka dhënë këtë deklaratë:

“Gjithsej kam 8 anëtarë të familjes dhe këta dy djem (Miroslavin dhe Zhivojinin), një vajzë (Branën), dy reja (Desankën dhe Leposavën) dhe mbesën (Nadën) si dhe bashkëshorten (Spasenën). Nga të gjithë këta nuk kemi kaluar në fenë krishtere vetëm unë dhe bashkëshortja. Arsyen e kalimit të tyre nuk e kam saktësisht të njohur, por mendoj se famullitari disa herë u ka thënë se do t'i kurorëzojë pa

“Në maj të këtij viti kam kaluar në fenë ortodokse me fqinjët tjerë të mi nga fshati Zhinipotok, gjithsej 12 familje.

pagesë dhe do t'i shpërblejë shumë. Edhe mua dhe bashkëshorten disa herë na ka ftuar Prefektura e rrethit në Nish dhe ka kërkuar që të kurorëzohemi ose atje ose atje. Kjo është bërë për shkak se imami i Nishit ka paraqitur fletëparaqitjen që po jetojmë në mënyrë jashtëmartesore, edhe pse unë jam kurorëzuar para 40 vjetëve te hoxha në Nish.”

2. Vlladimir (Latif) Buniq, farkëtar nga Malça ka deklaruar:

“Gjithsej i kam 4 anëtarë të familjes, bashkëshorten Cana, e cila ishte e fesë ortodokse dhe ka kaluar në Islam; pastaj kam tre fëmijë: Rabinë (Radën), Mustafën (Mutën) dhe Rankun. Asnjëri prej këtyre nuk ka kaluar në fenë krishtere. Famullitari i atjeshëm disa herë, nëpërmjet të romëve, ish-myslimanë nga Vrezhina e Epërme, na ka ftuar për një bisedë, por unë nuk kam shkuar, sepse e kam ditur se do të na këshillojë që të braktisim Islamin. Hoxha nga Nishi kurrë nuk na ka ardhur, as ne nuk e kemi ftuar, sepse jemi shumë të vobektë. Unë para lufte isha toger i

xhandarmërisë në Shtip dhe s'kam qenë në xhami dhe e njoh pak fenë. Fëmijët askund nuk i mësoj.”

3. Uskokoviç Ranxhell nga Malça ka deklaruar:

“Unë i kam 4 anëtarë të familjes, nuk e kam lejuar askënd të kalojë në fenë ortodokse. Famullitari nga Malça më ka dërguar porosi nëpërmjet romëve të Vrezhinës së Epërme që të kaloj në fenë ortodokse dhe se falas do të kurorëzohemi, ndërsa te hoxha kushton 500 dinarë. Njëjtë na ka thënë edhe prefekti i Rrethit të Nishit, kur na ka thirrur për paraqitje në imamatin në Nish.

E kam të njohur se janë kryqëzuar këto familje në Vrezhinën e Poshtme: Vuka Musiq, farkëtar, që ka 6 anëtarë, 2. Maliq (Mihailo) Xhaferoviç me 8 anëtarë, 3. Smailoviç Çedomir me 5 anëtarë, 4. Deva Musiq me 2 anëtarë (ndërsa baba i tij Arifi ka mbetur në fenë islame) nga Malça: 5. Mirko Buniq me 2 anëtarë, 6. Zhivojin Buniq me bashkëshorten, dhe djalën Bulla Buniq. Këtë kryqëzim e ka bërë famullitari z. Nikolla Rançiq në kishën e atjeshme në ditën “Poklada”, të hënën, më gëzim dhe festim, të cilin e ka organizuar “kumbara” Çeda Stamenkoviç, tregtar nga Nishi. E kam të njohur se këta që kanë kaluar në fenë ortodokse janë penduar dhe mendoj se nëse hoxha bën pak përpjekje ata do t'i kthejë.

Na jetojmë në gjendje të vështirë ekonomike dhe se nuk po mund t'i dërgojmë fëmijët në shkollë, sepse nuk kemi para për libra si dhe as shkolla e as komuna nuk na i japin falas.”

Në fund të këtij procesverbali, të gjithë të përmendurit më lart, në mënyrë solidare deklarojnë: “Të gjithë të shënuarit më



lart deklarojmë se neve askush nuk mund të na detyrojë që të braktisim Islamin dhe deri në vdekje do të mbesim myslimanë dhe edhe fëmijët tanë do të mundohemi që edhe ata të gjithë të kthehen në Islam, pasi kanë kaluar në fenë krishtere.” Në fund, Vlladimir Buniq, pohon se e ka një fëmijë, Mustafën, i cili e ka kryer shkollën fillore, andaj lutet që të dërgohet në ndonjë shkollë më tutje, sepse ka dëshirë për mësim.

Më tutje gjatë dëgjimit të myslimanëve nga Malça thuhet që në mënyrë vullnetare ka vepruar Çedomir Selimoviq, kovaç nga Vrezhina e Epërme, që në emër të myslimanëve të kryqëzuar e jep këtë deklaratë: “Kam kaluar në fenë krishtere para dy muajve në Malçë me tërë familjen. Prefektura e Rrethit në Nish ka kërkuar që të kurorëzohem, prandaj kam shkuar të prifti, sepse kurrë nuk kam qenë në Nish, ndërsa baba më ka stërpikur me ujë gjatë lindjes.

Arsyeja kryesore që kemi kaluar është sepse jetojmë vetëm në mes të krishterëve, e hamë mishin e derrit dhe e kremtojmë festën dhe kemi dëshiruar që të llogaritim si ortodoksë. Pra, të gjithë ne nga Vrezhina e Epërme, kemi kaluar vullnetarisht dhe pa asnjë presion. Kumbare ka qenë Çeda Stamenkoviq, ndërsa jemi kurorëzuar në të hënën e fundit. Gjatë kurorëzimit, kumbara, sipas adetit, i ka qerasur gratë tona me nga një shami. Të tjerët asgjë nuk kemi marrë.

Më së shumti na ka ardhur rëndë se hoxha nuk na ka ardhur kurrë, andaj vetë i kemi varrosur njerëzit tanë dhe kemi parë se ata që kanë kaluar në Islam para disa vjetëve kanë probleme të mëdha për shkak të kësaj dhe ne kurrsesi nuk mund të paguajmë hoxhën, ndërsa popi të gjitha këto na i kryen falas. Po të dija diç për fenë islame, kurrsesi nuk kisha kaluar dhe se unë kam qenë si i pafe. Tjetër nuk kam çka të them për këtë.”

Deklarata e mëparshme e myslimanëve të Malçës dhe e konvertantit Selimoviq Çedomirit, e ilustron një mjaft mirë se cilat ishin shkaqet që këta myslimanë janë kryqëzuar. Gjithsej

në Malçë dhe në Vrezhinën e Epërme janë kryqëzuar 28 persona. Ky akt i kryqëzimit të myslimanëve është ilegal, sepse nuk janë zbatuar formalitetet e dispozitave ligjore kur kalohet nga feja në fe. Të gjithë këta myslimanë të kryqëzuar edhe tani në librat amëz janë të regjistruar si myslimanë, sepse akti i kryqëzimit të tyre është bërë në mënyrë ilegale.

Te kjo duhet të konstatohet një fakt shumë falënderues se fshatarët ortodoksë janë tolerantë ndaj fqinjëve të tyre myslimanë, që edhe të tjerëve duhet t’u shërbejë si shembull i mirë.

Myslmanët në Nish dhe në rrethet përfaqark jetojnë në gjendje shumë të vështirë materiale. Më së shumti merren me zejen e farkëtarisë dhe të shportarisë. Në Nish ka njerëz me gjendje paksa më të mirë, por duhet të konstatohet me keqardhje se shumë punëtorë të kualifikuar nuk mund të punësohen, edhe pse në Nish ekziston mundësia. Jemi të gatshëm që kjo padrejtësi do të përmirësohet dhe që myslimanëve do t’u ofrohet rasti që në bazë të fuqisë numerike do të punësohen në sipërmarrje të ndryshme, që në Nish ka në numër të madh. Sidomos fakti falënderues duhet theksuar se këta myslimanë në luftën për jetesë janë mjaftë të shkathtë dhe se në mesin e tyre, me gjithë varfërinë nuk mund t’i shohësh si lypës. Çdonjëri dëshiron që bukën ta fitojë me duart e veta. Në mesin e tyre shihet se edhe janë të prirë që fëmijët e tyre t’i shkollojnë, andaj si shembull, në këtë vit shkollor, në Prokuplë janë regjistruar në shkollën fillore mbi 40 fëmijë myslimanë, ndërsa më herët fëmijët e tyre fare nuk kanë shkuar në shkollë. Ata duhet të falënderojnë imamin në Prokuplë. Me vendosjen e imamëve agjilë dhe sakrifikues dhe të sejjar-vazit në këto treva, arsimi në mesin e myslimanëve të atjeshëm do të lëshojë shpejt rrënjë të thella.

Këtu shkurtimisht është paraqitur gjendja e myslimanëve në Nish dhe rrethinën e tij dhe arsyt e kryqëzimit të tyre. Andaj, duhet shpejt të merren masat e nevojshme që në të ardhmen të pengohen këto ngjarje të këqija, që i prekin ndjenjat e të gjithë myslimanëve të këtij vendi, si dhe i dëmtojnë interesat e shtetit dhe të bashkësisë kombëtare.

Që të vërtetohen masat e nevojshme, kam udhëtuar nga Nishi në Shkup me referentin e arsimit të Ulema-Mexhllisit në Shkup, kështu që në konferencën e përbashkët të Ulema-Mexhllisit dhe të anëtarëve të Saborit të vakëfit, të cilët gjendeshin në Shkup, kemi përcaktuar masat të cilat duhet të merren që kjo gjendje sa më shpejt të përmirësohet.

Në fund, theksoj besimin se ende ekzistojnë kushtet që gjendja shpejt të përmirësohet, sepse ndërgjegjja e myslimanit, edhe pse më decenie e papërpunuar, është e fortë dhe e palëkundur. Fara e mirë e mbjellë, shpejt jep fryt të mirë dhe të shpejtë.

Rëndësia e Imam Maturidiut dhe shkollës maturidite për një qytetërim të ri islam (1)

Prof. dr. Hasan Onat

Ruga historike e njerëzimit nuk ka ndjekur gjithmonë një vijë të drejtë, ndonëse ka pasur ulje-ngritje, zhvillim, prapambetje, ajo ka vazhduar të ekzistojë në një mënyrë gradualisht në zhvillim dhe të kuptueshme, ndoshta për faktin se kujtesa njerëzore regjistron edhe përvojat e jetuara dhe mësimet e nxjerra. Mund të thuhet se përcaktuesi kryesor në akumulimin e njohurive dhe përvojës në rrjedhën historike është njohuria e besueshme, shkenca, liria dhe krijimtaria. Në këtë kontekst, çdo kontribut i dhënë nga qeniet njerëzore për atë që ata e gjejnë gati në natyrë është kulturë në kuptimin më të përgjithshëm. Edhe pse ka nga ata që e përdorin kulturën dhe qytetërimin në të njëjtin kuptim, “civilisation” në fjalorët anglisht dhe frëngjisht, “medeniyet” ose “uygarlık” në turqisht, është një koncept kaq i rëndësishëm që ka gjetur vend në mendjen e njeriut, e që nuk mund të braktiset ose të shpërfilllet, për të kuptuar dhe shpjeguar disa nga situatat e kaluara dhe të tashme të njerëzimit. “Qytetërimi” është një koncept që mund të përfshijë atë që njerëzit kanë bërë gjatë historisë, mentalitetin pas krijimit njerëzor, vlerat që i bëjnë njerëzit njerëzor, artin, teknologjinë dhe rritjen e “fuqisë” shoqëruese. Koncepti i “civilizimit” ose “qytetërimit” duket se është i ngulitur në kulturë dhe memorie, dhe me sa dimë, është arritur një lloj konsensusi për domosdoshmërinë dhe funksionin e tij në kuptimin e së kaluarës, megjithëse jo në

përkufizimin e saj. Kur ky koncept të dalë nga fjalorët, nuk do të jetë e mundur të kuptohen apo shpjegohen shumë gjëra për qeniet njerëzore.

Në përpjekje për të kuptuar koncepte si “kultura” dhe “civilizimi”, vlen të theksohet se ato ndërtohen dhe kuptohen si një strukturë dinamike, e dyanshme drejt së shkuarës dhe së ardhmes, ashtu si rrënjët dhe degët e një peme. Në fakt, “të kuptuarit” në çdo fushë është një aktivitet retrospektiv. Fillojmë të kuptojmë gjithçka pasi largohemi nga ekrani i “momentit”. Kemi mundësinë të projektojmë të ardhmen aq sa mund të kuptojmë se çfarë ka mbetur nga “e kaluara”. E ardhmja ndërtohet me akumulimin që mund të gjejë mundësinë për të rrjedhur nga e kaluara. Në këtë aspekt, çdo kuptim i qytetërimit nuk është gjë tjetër veçse një mënyrë për të lexuar atë që njerëzi ka bërë në të kaluarën nga këndvështrimi i qytetërimit. Përpjekja për të kuptuar sfondin e formacioneve që lanë gjurmë të thella në historinë e njerëzimit, duke filluar nga vendi ku ndodhemi, me konceptet që kemi prodhuar, dhe diturinë, dokumentet dhe gjetjet që na arrijnë nga e kaluara. Të identifikosh parimet rrënjësore pas kulturës dhe vlerave të saj, do të thotë të rindërtosh atë qytetërim, mentalitetin që e mishëron atë. Në këtë aspekt, diskutet për qytetërimin duhet të bazohen gjithmonë në të kaluarën. Puna e bërë

“Njeriu e di se ndjenja që i thotë të mos mendojë nuk është gjë tjetër veçse një mashtrim i keq, sepse një veprim i tillë mund të jetë vetëm vepër e djallit dhe qëllimi i tij është ta pengojë një njeri të mbledhë produktin e mendjes së tij, ta frikësojë atë që të përdorë këtë amanet hyjnor që është i dobishëm për të kapur mundësitë dhe për të arritur objektivat e tij.” - Imam Maturidiu në “Kitabu’t-Tevhid”



kryesisht konsiston në përpjekjen për të kuptuar të kaluarën nga e tashmja, nga ku jemi, me njohuritë që kemi. Gjëja interesante është se përpjekja për të kuptuar qytetërimin duhet të kryhet kryesisht përmes diskurseve të ndërtuara që përbëjnë akumulimin në fusha si shkenca, historia, letërsia dhe arti. Gjetjet aktuale tregojnë se shumë qytetërimë janë ndërtuar gjatë historisë njerëzore.

Asnjë qytetërim në të kaluarën, përfshirë qytetërimin Perëndimor, nga i cili dominohem sot, nuk ishte një qytetërim i krijuar nga dikush. E vërteta është se qytetërimi nuk është projektuar; kur krijimtaria njerëzore merr një dimension universal dhe fillon të lërë gjurmë të thella të përhershme në rrjedhën natyrore të njerëzimit, ekzistenca e qytetërimin fillon të ndihet. Të bësh të ndjerë ekzistencën e qytetërimin do të thotë që mentaliteti i përfaqësuar nga ai qytetërim është “subjekti”. Gjurmët e dukshme të atij mentaliteti mund të shihen në rrjedhën e njerëzimit. Qytetërimet vdesin kur ndjekësit e tyre humbasin cilësinë e të qenit “subjekt”. Megjithatë, asnjë nga arritjet e qenieve njerëzore që arrijnë nivelin e “qytetërimin”, asnjë prej arritjeve të tyre që i kontribuojnë njerëzimit, nuk do të zhduket plotësisht. Të gjitha llojet e zhvillimit janë ndërtuar mbi themele që janë produkt i mundit të atyre të mëparshme. Çdo qytetërim i ri duhet të përfitojë nga akumulimi i atyre të mëparshëm. Në këtë kontekst, nuk do të ishte ekzagjerim të thuhet se rrënjët e qytetërimin perëndimor shtrihen në njohuritë dhe përvojën e myslimanëve, veçanërisht në fushën e shkencës. Si dëshmi e asaj që thamë, mendojmë se mjafton të kujtojmë njohuritë dhe përvojën që rrjedhin në Evropë përmes Andaluzisë. Megjithatë, qytetërimi perëndimor ka arritur të fshehtë shumë burimet ndikuese në ngritjen e tij.

Megjithatë, nuk duhet harruar se edhe pse është e mundur që të vërtetat të fshihen/injorohen për një kohë të gjatë, ato nuk mund të shkatërrohen plotësisht, ndaj dalin spontanisht kur të vijë koha.

Jeta e qytetërimin përcaktohet nga liria që u jep aftësive krijuese, nga niveli i vlerësimit të krijimtarisë në shoqëri, nga niveli i prodhimit total, nga brendësia e drejtësisë dhe nga funksionueshmëria e ligjit. Megjithatë, në kontekstin e qytetërimin, njerëzimi ka arritur një prag kritik që nuk e ka përjetuar kurrë më parë: Qytetërimi perëndimor ka qenë vendimtar në të gjithë botën në një shkallë që asnjë qytetërim i mëparshëm nuk ka mundur ta arrijë; sidomos duke përdorur epërsinë e saj në shkencë dhe teknologji dhe fuqinë e madhe që ka fituar, ai po shkatërron çdo gjë “tjetër” dhe e bën të pamundur edhe imagjinimin e një “qytetërimi alternativ”. Nuk duam të flasim për fundin e historisë apo të njerëzimit; por edhe ne mendojmë se nuk duhet të lëmë të shpohet anija ku jetojmë. Sinqerisht, shkatërrimi i qytetërimin perëndimor ka filluar ta bëjë botën larg të qenit një vend i jetueshëm, ta bëjë “njerëzorin” të harrojë se është “njerëzor” dhe të shpërbëjë vlerat që e bëjnë “njerëzor” njerëzimin. Për këtë arsye, ne besojmë se projektimi i një “qytetërimi të ri” është i një rëndësie jetike.

Disa vëzhgime dhe paralajmërime të disa mendimtarëve që meditojnë mbi qytetërimet dhe mendojnë për të ardhmen e njerëzimit sugjerojnë se duhet të veprohet pa vonesë për çështjen e “një qytetërimi të ri”. Analizat e mëposhtme të Toynbee janë të jashtëzakonshme:

“Zhvillimi që ne e quajmë qytetërim është përparim në teknologji, shkencë dhe përdorim jo personal të pushtetit; nuk është përmirësim në ndershmëri, pra në moral. Çdo

zhvillim teknologjik sjell me vete një rritje të fuqisë dhe fuqia mund të përdoret për të mirë ose për keq. Aspekti më i frikshëm i shoqërisë së sotme është se, ndërkohë që fuqia e ofruar nga teknologjia është rritur kohët e fundit me një ritëm dhe shpejtësi të paprecedentë, niveli mesatar i moralit - ose imoraliteti - i atyre që përdorin këtë pushtet, është rritur kaq shumë, ose ka mbetur i qëndrueshme ose ka rënë më poshtë.” (Toynbee, 1992, 352)

Një nga konceptet më të njohura të qytetërimit perëndimor ka qenë “përparimi”. A është e mundur të kundërshtosh “progresin”? Fakti që njeriu është një qenie “në gjendje të qenët” jo vetëm që u lë vend koncepteve si “zhvillim”, “përparim”, “ritje” në rrjedhën e jetës, por u jep atyre një përmbajtje të veçantë dhe misterioze. Megjithatë, çështja ka një dimension që Solzhenitsyn tërheq vëmendjen:

“Një detaj që ne e kemi anashkaluar dhe e kemi kuptuar vetëm kohët e fundit është se ‘progresi’ i pakufizuar nuk mund të ndodhë me burime të kufizuara në planetin tonë. Natyra ka nevojë për mbështetje dhe jo për pushtim. Ne, nga ana tjetër, nuk bëjmë gjë tjetër veçse gllabërojmë me sukses mjedisin që na është caktuar...”

“Transporti bashkëkohor e ka hapur botën për ata që jetojnë në Perëndim. Edhe nëse prezenca e tyre nuk është plotësisht kudo, ai është pothuajse në prag të kërcimit nga kufijtë e vetes së tij; duke qenë kudo në planet në të njëjtën kohë përmes syve të televizorit. Por duket se vrulli i këtij ‘përparimi’ teknocentrik, oqeanet e informacionit të panevojshëm dhe të soditjes së lirë nuk e zmadhojnë aspak shpirtin njerëzor, por përkundrazi e bëjnë atë më të cekët; jeta jonë shpirtërore po tkurret dhe zvogëlohet. Veç kësaj, kultura jonë po varfërohet dhe bëhet më e shurdhër; edhe pse ne përpigemi ta mbysim këtë rënie me risi të zbrazëta, rezultati mbetet i njëjtë. Ndërsa komoditeti i qenieve të gjalla vazhdon të përmirësohet për një person mesatar, zhvillimi shpirtëror ka mbetur i pandryshuar. Ngopja e tepruar sjell edhe një trishtim në zemra, kuptohet që e gjithë kjo kënaqësi nuk sjell asnjë kënaqësi, në fakt duket sikur do të na mbysë së shpejti.

“Jo, nuk është e mundur të vendosim të gjitha shpresat në shkencë, teknologji, rritje ekonomike. Triumfi i qytetërimit teknologjik ka mbjellë edhe një farë pasigurie shpirtërore brenda nesh. Dhuratat e tij na pasurojnë dhe na robërojnë. Gjithçka ka të bëjë me interesat - ne nuk mund t’i neglizhojmë

Transporti bashkëkohor e ka hapur botën për ata që jetojnë në Perëndim. Edhe nëse prezenca e tyre nuk është plotësisht kudo, ai është pothuajse në prag të kërcimit nga kufijtë e vetes së tij.

interesat tona - gjithçka është për hir të qenieve materiale; por një zë brenda nesh na pëshpërit se kemi humbur diçka të pastër, sublime, të brishtë. Ne e kemi humbur qëllimin. Le ta pranojmë; le ta pranojmë, qoftë edhe me një pëshpëritje që vetëm ne vetë mund ta dëgjojmë: Për çfarë po jetojmë kur e jetojmë jetën me një ritëm kaq të furishëm?” (A. Solzhenitsyn, 1999, 20-21)

Në të vërtetë, të gjithë ne duhet t’i bëjmë vetes pyetje të tilla. Ne duhet të pyesim veten pse nuk mendojmë se miliona njerëz që vdiqën për asgjë në shekullin XX u vranë, pse nuk mendojmë se çdo pikë gjaku i pafajshëm mund të kthehet në një liqen dhe të mbytet në një njerëzim, pse njerëzimi e merr vdekjen kaq të mirëqenë!

Qytetërimi perëndimor e ka tërhequr gjithë njerëzimin në një krizë serioze identiteti dhe në një krizë të thellë kuptimi. Dhuna dhe terrori i japin goditjen më të madhe dinjitetit njerëzor në duart e njerëzve të objektivizuar. A mund të injorohet se dhuna që shkatërron veçanërisht vendet ku jetojnë myslimanët sot ka një dimension global? Nuk është e

mundur të kapërcehen problemet e identitetit pa zhvilluar një ndjenjë të lartë kuptimi dhe dhuna dhe terrorizmi nuk mund të tejkalohen pa krijuar një kulturë besimi të lartë. Është e qartë se duhet një sistem i ri kuptimor për njerëzimin që ka rënë në “boshllëkun ekzistencial”. A mund të argumentohet se nevoja për një kuptim të ri të shkencës, një teknologji më humane, është jetike? Për të kapërcyer frikën ekzistenciale gjithnjë në rritje të njerëzimit, njeriu së pari duhet të jetë i vetëdijshëm për ekzistencën e tij. Prandaj themi se njerëzimit i duhet një qytetërim i ri, një sistem i ri vlerash. Kërkimi për një vetëdije të re për qeniet njerëzore, të përshtatshme për natyrën e tyre, duhet të zhvillohet, të zgjerohet dhe të vihet në veprim pa humbur më kohë. Përndryshe, dinjiteti njerëzor dhe “vetëdija për të qenë njeri” do të shkatërrohen në mënyrë të pakthyeshme. Kjo është fatkeqësia më e madhe që mund t’i ndodhë njerëzimit.

Nga ana tjetër, në mënyrë që myslimanët të bëjnë një jetë të lirë dhe të nderuar në të ardhmen, ata duhet të mos mbesin peng të së kaluarës, por të kthehen nga e ardhmja, të kenë fuqinë e dijes duke i shndërruar energjitë e tyre në vepra të mira dhe të prodhojnë vlerë në një shkallë universale. Të ekzistosh në kuptimin real do të thotë të marrësh pjesë në

procesin e “bërjes”, që siguron vazhdimësinë e krijimit hyjnor, me krijimtarinë njerëzore. Në kulmin e krijimtarisë njerëzore janë shkenca, arti dhe sporti. Ata që nuk mund të kontribuojnë pozitivisht në procesin e “bërjes” universale përpiqen të provojnë ekzistencën e tyre duke djegur, shkatërruar, prishur dhe vvarë. Kur mendojmë në këtë drejtim, nuk do të jetë çudi të thuhet se myslimanët fjalë për fjalë po enden rreth kufirit të ekzistencës dhe të mosekzistencës. Ajo që ndodhi në dy shekujt e fundit, shtypja e qytetërimit perëndimor ndaj asaj që konsiderohet “tjetër”, fizikisht dhe psikologjikisht ka çuar në shtypjen dhe objektivizimin e atyre që, në një farë kuptimi, nuk konsiderohen elementi thelbësor i atij qytetërimi. Mund të thuhet se arsyeja kryesore pse kultura myslimane prodhon dhunë në gjendjen e saj aktuale dhe pse myslimanët janë kaq të etur për të vdekur dhe vvarë është të reduktohen në pozicionin e të qenit “objekt” dhe të mos jenë në gjendje të përdorin arsyen dhe aftësitë krijuese në mënyrë efektive. Pjesa më e keqe e ndjenjës së shtypjes është se ajo heq ndërgjegjen e të qenit “njerëzor” nga njerëzit. Ashtu si skllevërit, jetimët dhe të huajt e rifituan “vetëdijen e të qenit njerëzor” me ajetet e para të shpallura në fillim të Islamit, edhe myslimanët kanë nevojë për një proces të ri ndërgjegjësimi. Meqenëse “trauma e qytetërimit të mundur” është vendimtare në negativitetet e përjetuara, zgjidhja mund të jetë e mundur me një lëvizje të re qytetëruese. Me fjalë të tjera, ndonëse në shikim të parë mund të duket sikur lumi po rrjedh mbrapsht, myslimanët nuk kanë shumë zgjedhje tjetër veçse të përfytyrojnë një qytetërim të ri për të jetuar të lirë dhe me nder.

Në mënyrë që myslimanët të përdorin energjitë e tyre në mënyrë efektive, ata kanë nevojë për një qëllim që mbledh, bashkon, integron, që është konkret por i vazhdueshëm, që do ta drejtojë gjithmonë pikëpamjen e shoqërisë në nivele më të larta dhe që ka një nivel të lartë kuptimor. Në një kohë kur i gjithë njerëzimi prodhon nga “hendeku i kuptimit ekzistencial” dhe bie në një krizë të thellë, “qëllimi i lartë” që mund t’i përgjigjet nevojës për kuptim në një shkallë universale dhe të rifreskojë vetëdijen e të qenit njerëzor, mund të jetë vetëm pretendimi për një qytetërim të ri. Fatkeqësisht, dimensionin e Islamit që i jep kuptim jetës njerëzore duket se është harruar. Rikuptimi i Islamit nën dritën e parimeve themeluese të Kuranit, madje edhe rindërtimi i tij brenda mundësive, natyrisht do të sjellë me vete një lëvizje të re qytetëruese. Kjo duhet kuptuar si një domosdoshmëri dhe jo një nevojë. Në këtë kontekst mendojmë se mendimet e Maturidiut për dijen, lirinë dhe fenë do të jenë një pikënisje e përshtatshme për diskutimet e një qytetërimi të ri.

Përktheu nga gjuha turke: Haki Sahitaj

URIME PËRVJETORI FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME

*Çdo përvjetor ka rëndësinë e vet,
E më i veçantë, përvjetori i tridhjetë,
Në kohë të okupimit, punën e fillove,
Studimet islame rinisë ia mundësove.*

*Deshi Allahu, Bujar dhe Fisnik,
Që ta fillosh rrugëtimin historik,
Për ta përhapur diturinë islame,
Në Dardani e në trojet tjera shqiptare.*

*Për studentët tanë, dituri ofron,
Cilësia e studimeve po prosperon,
Se pa dituri nuk ka ardhmëri,
Ajo nuk peshohet as me flori.*

*Tani të lirë jetojmë e veprojmë,
Shumë suksese të dëshirojmë,
Për punë shembullore të përgëzojmë,
Jubileun e tridhjetë ta urojmë.*

Prishtinë, 2023
Ismail Simnica

MYFTIU TËRNAVA DHE NËNSEKRETARI I KOMBEVE TË BASHKUARA VIZITUAN XHAMINË E MADHE

Më 13 maj 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, së bashku me nënsekretarin e Përgjithshëm për Paqe në Kombet e Bashkuara, Jean-Pierre Lacroix, vizituan Xhaminë e Madhe në Prishtinë. Gjatë kësaj vizite, Myftiu Tërnavë, e njohu për së afërmi nënsekretarin, z. Jean-Pierre Lacroix për historikun e kësaj xhamie, rëndësinë dhe rolin që ka pasur dhe që vazhdon ta ketë kjo xhami, e cila veç të tjerash u cilësua simbol i kryeqytetit. Në oborrin e kësaj xhamie, Myftiu Tërnavë dhe nënsekretari i Kombeve të Bashkuara, diskutuan për të arriturat, sfidat dhe bashkëpunimin mes tyre. Myftiu gjatë këtij takimi e njohu me punën e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe rolin e saj te besimtarët myslimanë. Veç të tjerash, ai shprehu shqetësimet e tij për Ligjin e Lirisë Fetare, si dhe me atë se çfarë ka ndodhur në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc

nga forca të asaj kohe. Në anën tjetër, nënsekretari i Kombeve të Bashkuara, z. Jean-Pierre Lacroix, përgëzoi Myftiun Tërnavë dhe Bashkësinë Islame të Kosovës për angazhimin dhe punën e palodhur që kryen në çështjen fetare,

por edhe në bashkëpunimin mes komuniteteve. Ai veç tjerash shprehu gatishmërinë për të rritur bashkëpunimin me Bashkësinë Islame të Kosovës në fushat e përbashkëta që synojnë paqen në vend dhe rajon.



MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA KRYETARI I KOMUNËS SË PRIZRENIT, Z. SHAQIR TOTAJ

Më 24 maj 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga zv.shëfi i kabinetit të tij, Besir ef. Neziri, është pritur në takim nga kryetari i Këshillit të BI-së së Prizrenit, Besim ef. Berisha. Më pas, Myftiu Tërnavë, i shoqëruar edhe nga kryetari dhe kryeimami i Këshillit të BI-së së Prizrenit, u pritën në takim nga kryetari i Komunës së Prizrenit, z. Shaqir Totaj.

Në këtë takim, Myftiu Tërnavë, e falënderoi kryetarin Totaj për bashkëpunimin e vazhdueshëm me institucionin e BIK-ut në përgjithësi, e në veçanti me KBI-në e Prizrenit. Ai gjatë këtij takimi e njohu kryetarin Totaj edhe me angazhimet dhe me aktivitetet e BIK-ut. Nga ana e tij, kryetari Totaj, e



falënderoi Myftiun Tërnavë për vizitën, duke shprehur kështu mirënjohje dhe falënderime të veçanta për Bashkësinë Islame të Kosovës, për gjithë kontributin e tyre dhënë për mirëqenien e qytetarëve të vendit. Të dyja palët ranë

dakord që në të ardhmen të intensifikojnë edhe më shumë bashkëpunimin për projektet e përbashkëta të të dyja institucioneve, gjithnjë në të mirë të qytetarëve të Prizrenit.

MYFTIU TËRNAVA PRANOI TELEGRAME URIMI ME RASTIN E FESTËS SË FITËR BAJRAMIT

Më 15 maj 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka shkëmbyer telegrame urimi me ministrin e Haxhit dhe Umres së Arabisë Saudite, Tefvik Favzan er Rubeje. Në telegramin e urimit, ministri Er Rubeje, shprehet se kam pranuar urimin tuaj me respekt dhe gëzim me rastin e Fitër Bajramit. Ju falënderojmë për këtë respekt vëllazëror, andaj lusim Allahun xh.sh. për begati dhe dhunti ndaj Jush, si dhe lusim Zotin që të pranohen të gjitha veprat e mira të kryera nga ne. Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, përmes ambasadorit të Ambasadës së Arabisë Saudite në Shqipëri, Fejzal Gazi Hifdhi, ka pranuar telegram urimi me rastin e festës së Fitër Bajramit nga Mbreti i dy Haremeve dhe princi i Kurorës. Ambasada e Arabisë Saudite ka përcjellë përshëndetjet më të sinqerta dhe përmes këtij telegrami falënderoi Myftiun Tërnavë për urimin, duke lutur Zotin që të pranohen të gjitha veprat e mira të kryera nga besimtarët dhe duke lutur Zotin për mirëqenien tuaj dhe popullit të Kosovës dhe kontributin që jeni duke dhënë në shërbim të Islamit dhe myslimanëve. Myftiu Naim ef. Tërnavë, përmes Ambasadës së Kuvajtit në Shqipëri, ka



pranuar telegram urimi me rastin e festës së Fitër Bajramit nga Emiri i Kuvajtit, Sheikh Nawaf al Ahmed al Jaber al Sabah. Ambasada e Kuvajtit në Tiranë ka përcjellë urimet më të sinqerta për Bashkësinë Islame të Kosovës dhe për Myftiun Naim ef. Tërnavë me rastin e kësaj feste, duke lutur Zotin e Plotfuqishëm që ta kthej këtë festë për të gjithë, me begati dhe mirësi të shumta, si dhe t'iu dhurojë shëndet të plotë. Po ashtu, në këtë

mesazh është bashkangjitur edhe telegram urimi nga ministri i Kabinetit të Emirit, Sheikh Muhamed Abdullah al Mubarek al Sabah, i cili ka përcjellë urimin nga Emiri i Kuvajtit. "Kam kënaqësinë t'ju përcjellë falënderimin e Emirit të vendit, shkëlqesinë e tij, shejh Nawaf al Ahmed al Jaber al Sabah, për urimin tuaj me rastin e festës së Fitër Bajramit, i cili ju uron gjithashtu shëndet të plotë e lumturi. Ju lutem pranoni konsideratën time më të lartë", thuhet në telegram urimin e dërguar nga ministri i Çështjeve Fetare të Kabinetit të Emirit. Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, përmes Ambasadës së Katarit në Shqipëri, ka pranuar telegram urimi me rastin e festës së Fitër Bajramit nga Emiri i shtetit të Kuvajtit, Tamim bin Hamad al Thani. Ambasada e Katarit në Tiranë me këtë rast ka përcjellë urimet më të sinqerta për Bashkësinë Islame të Kosovës dhe për Myftiun Naim ef. Tërnavë me rastin e kësaj feste, duke lutur Zotin e Plotfuqishëm ta kthej këtë festë për të gjithë, me begati dhe mirësi të shumta. Po ashtu në këtë mesazh është bashkangjitur edhe telegram urimi nga Emiri i shtetit të Kuvajtit, Tamim bin Hamad al Thani.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGA MËRGATA SHQIPTARE NË AMERIKË

Më 18 maj 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim një delegacion nga mërgata shqiptare në Amerikë, i cili përbëhej nga Shuajb ef. Gërguri, imam i Qendrës Islame Shqiptare në Michigan, Burhanudin ef. Fili, aktivist shumëvjeçar, si dhe prof. Elez Osmani. Myftiu Tërnavë i falënderoi mysafirët për vizitën dhe për gjithë kontributin që janë duke dhënë për mirëqenien e besimtarëve myslimanë shqiptarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai edhe njëherë rikonfirmoi gatishmërinë e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që edhe më tej të vazhdohet dhe të intensifikohet bashkëpunimi, si dhe çmoi lart angazhimin dhe punën e deritanishme të Qendrës Islame Shqiptare në Michigan. Edhe mysafirët e falënderuan Myftiun për mikpritjen si dhe çmuan punën dhe e tij dhe të institucionit që ai drejton për bashkëpunimin dhe për ndihmën e ofruar nga Bashkësia Islame e Kosovës sa herë që është kërkuar një gjë e tillë.



U INAUGURUA PROGRAMI PËR SHPËRNDARJEN E HURMAVE NË KOSOVË, DONACION NGA ARABIA SAUDITE

Më 22 maj 2023, me pjesëmarrjen e Myftiut të Kosovës, Naim ef. Tërnavë, përfaqësuesit të Qendrës së Mbretit Selman nga Mbretëria e Arabisë Saudite, Raed Ahmed Alwehaibi, si dhe ambasadorit të Arabisë Saudite në Tiranë, Feisal Hevzi, në Prishtinë, u inaugurua programi për shpërndarjen e hurmave në Kosovë i Qendrës së Mbretit Selman nga Mbretëria e Arabisë Saudite, ku me këtë rast u nënshkrua marrëveshjeje bashkëpunimi me ku do të shpërndahen 25 ton hurme në prag të festës së Kurban Bajramit. Myftiu Tërnavë falënderoi Raed Ahmed Alwehaibi për pjesëmarrjen e tij në këtë inaugurim, e me këtë rast shprehu falënderime edhe për shtetin e Arabisë Saudite për ndihmat e vazhdueshme që i ka dhënë popullit të Kosovës para, gjatë dhe pas luftës. Myftiu Tërnavë shprehu gatishmërinë e institucionit të BIK-ut që të vazhdojë edhe më tej bashkëpunimi i mirë ndërmjet BIK-ut dhe Ambasadës së Arabisë Saudite. Myftiu Tërnavë po ashtu theksoi edhe bashkëpunimin

shumë të mirë që kanë edhe ambasadorin e Arabisë Saudite në Tiranë, Feisal Hevzi. Bashkësia Islame e Kosovës është mirënjohëse për ata se çfarë ka bërë, por edhe në atë se çfarë është duke bërë si në ndihma humanitare, ashtu edhe në anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. “Kosova është vend i bereqetshëm, mik i dashur dhe vendi me më së shumti myslimanë në Evropë. Arabia Saudite është një ndër shtetet e para që ka njohur Pavarësinë e Kosovës. Bashkësia Islame e Kosovës ka raporte shumë të mira me Ministrinë e Çështjeve Fetare

si dhe me Ambasadën e Arabisë Saudite në Tiranë” – tha Myftiu Tërnavë. Nga ana e tij, ambasadori Feisal Hevzi, tha se sot janë në Kosovë për të inauguruar projektin e radhës për shpërndarjen e 25 ton hurmave. “Kosova është një vend mik i Arabisë Saudite dhe kjo dëshmon edhe për nivelin e raporteve të mira që kemi ndërmjet vete. Ne këtë program e kemi zhvilluar dhe po e zhvillojmë në disa vende të botës, përfshirë këtu edhe Kosovën, për çka ne jemi tejet të lumtur” – tha ambasadori Hevzi.



MYFTIU TËRNASA PRITI NË TAKIM PËRFAQËSUESIT E STUDENTËVE TË UNIONIT STUDENTOR TË FSHI-SË

Më 11 maj 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Unionit Studentor të Fakultetit të Shkencave Islame të Shkupit, z. Luftim Dearin, i cili shoqërohej edhe nga studentët e këtij Fakultetit, si dhe nga përfaqësuesit e Unionit Studentor të Fakultetit të Studimeve Islame të Prishtinës. Myftiu Tërnavë u uroi studentëve mirëseardhje në institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe i përgëzoi ata për këtë iniciativë dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer që kanë me studentët e Fakultetit të Studimeve Islame. Po ashtu, gjatë kësaj vizite, studentët e FSHI-së u pritën në takim



edhe nga drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri ef. Bajgora. Në emër të studentëve, z. Luftim Deari, falënderoi Myftiun

Tërnavë për pritjen dhe për përkrahjen e vazhdueshme që ka institucioni i BIK-ut për studentët në përgjithësi.

MYFTIU TËRNASA MORI PJESË NË DUANË E HATMES SË MATURANTËVE TË MEDRESENË “ALAUDDIN” NË PRISHTINË

Më 25 maj 2023, në ambientet e amfiteatrit të Medresesë “Alauddin”, u mbajt dua e hatmes së 60 maturantëve, të Medresesë në Prishtinë. Në këtë ceremoni mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë me bashkëpunëtorë.

Duaja e hatmes paraqet përmbylljen e leximit të Kuranit fisnik të nxënësve të Medresesë për gjatë tri viteve, e cila u realizua falë Zotit Fuqplotë, fillimisht, por pastaj edhe falë punës dhe angazhimit të profesorëve, në veçanti të profesorit të Kuranit, Jakup Çunaku. Nxënësve me këtë rast fillimisht iu drejtua drejtori i shkollës Fadil ef.



Hasani, i cili numëroi përmbylljen e leximit të Kuranit nga kjo gjeneratë si njëherë prej sukseseve më madhore të kësaj gjenerate.

Kurse në fjalën e tij, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë përgëzoi e përshëndeti nxënësit, duke uruar si dhe lutur Zotin që t'u ndihmojë në rrugën e diturisë.

MYFTIU TËRNASA PRITI NË TAKIM NJË DELEGACION NGA FONDACIONI “AZIZ MAHMUD HÜDAYI VAKFI”

Më 30 maj 2023, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në takim anëtarin e Bordit Drejtues të fondacionit “Aziz Mahmud Hüdayi Vakfi”, z. Abdurrahman Topbaş dhe ish-rektorin e Universitetit “Sabahaddin Zaim”, prof. dr. Mehmet Bulut.

Myftiu Tërnavë fillimisht u dëshiroi mirëseardhje mysafirëve dhe më pas i njohu ata me zhvillimin dhe me organizimin e jetës fetare në Kosovë. Ai çmoi dhe vlerësoi lart bashkëpunimin me fondacionin “Aziz Mahmud Hüdayi Vakfi” dhe me institucionet arsimore nga Turqia. Ai theksoi se populli i

Kosovës është mirënjohës për kontributin e shtetit dhe popullit turk të dhënë për Kosovën deri më tani, duke potencuar kështu bashkëpunimin shumë të mirë që kanë me Ambasadën e Turqisë në Kosovë dhe me DIJANET-in në realizimin e shumë projekteve të përbashkëta.

Nga ana e tyre, Abdurrahman Topbaş dhe prof. dr. Mehmet Bulut, falënderuan Myftiun Tërnavë për bashkëpunim dhe kontributin që po jep ai dhe BIK-u për jetën fetare, paqen, tolerancën dhe harmoninë ndërfaqetare në Kosovë.

Të dyja palët u pajtuan se rruga e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve do të thellohet edhe më në të ardhmen.



MINISTRI PËR ÇËSHTJE FETARE TË ARABISË SAUDITE PRITI NË TAKIM SHEFIN E KABINETIT TË MYFTIUT, MR. BESIM MEHMETIN

Më 9 maj 2023, gjatë vizitës së tij në Arabinë Saudite, shefi i kabinetit të Myftiut Tërnavë, mr. Besim Mehmeti, u prit në takim nga ministri për Çështje Fetare të Arabisë Saudite, dr. Abdulatif al Shejh. Ai përcolli përshëndetjet dhe urimet e Myftiut Tërnavë, duke falënderuar kështu Mbretërinë e Arabisë Saudite për përkrahjen e ofruar për Kosovën në periudha të ndryshme dhe në sfera të ndryshme. Ai gjithashtu e njohu nikoqirin me ecurinë e projekteve të përbashkëta të realizuara në Kosovë. Nga ana e tij, ministri saudit, çmoi këtë vizitë duke vlerësuar tej mase angazhimet e Myftiut dhe të BIK-it për thellim të bashkëpunimit, si dhe uroi të gjitha të mirat, prosperitet e zhvillim, për popullin e Kosovës.



DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM PËRFAQËSUES TË XHAMIVE SHQIPTARE TË DIASPORËS

Më 4 maj 2023, drejtori i Diasporës në BIK, Ekrem ef. Simnica, ka pritur në takim kryetarin e xhamisë "Ikra-Bashkimi" në Berlin të Gjermanisë, z. Albaner Hajredini.

Kurse, më 11 maj 2023, drejtori Simnica, ka pritur në takim kryetarin e Xhamisë Shqiptare Neumarkt në Bajren të Gjermanisë, z. Naser Gashi.

Drejtori Simnica falënderoi përfaqësuesit e këtyre dy xhamive dhe nëpërmes tyre tërë mërgatën tonë shqiptare që gjendet në diasporë për kontributin e tyre dhënë për mirëqenien dhe jetën e përgjithshme fetare të shqiptarëve atje. Ai shprehu gatishmërinë e tij, por edhe të institucionit të BIK-it që bashkëpunimi i mirë që ka mbretëruar deri më tani, ndërmjet BIK-it dhe diasporës të vazhdojë edhe më tutje.



KRYEIMAMI SAHITI TAKOI UDHËHEQËSIT E HAXHIVE NGA KËSHILLAT E BI-SË



Më 31 maj 2023, Drejtoria e Haxhit dhe Umres pranë Kryesisë e Bashkësisë Islame të Kosovës, mbajti mbledhjen e saj parapërgatitore me udhëheqësit e grupeve të haxhive për këtë vit. Mbledhjen e kryesoi drejtori i Haxhit dhe Umres, Vedat ef. Sahiti, i cili në fokus të diskutimit të tij kishte

koordinimin e punëve, bashkërendimin e detyrave, obligimeve dhe përgjegjësisë të udhëheqësve të haxhit në raport me haxhitë. Ai njoftoi se nisja e haxhive nga Kosova për këtë vit do të jetë në datat 17,18 dhe 19 qershor, ndërsa kthimi më 08, 09 dhe 10 korrik.

Në këtë mbledhje u diskutua gjithashtu edhe për duanë tradicionale të haxhive, e cila do të bëhet nëpër këshillat përkatës para nisjes së haxhive. Këtë vit nga Kosova për haxh do të udhëtojnë 1.597 persona.

GJENERATA E 22-TË E MATURANTEVE TË MEDRESESË “ALAUDDIN” PËRFUNDUAN DUANË E HATMES



Më 26 maj 2023, 69 maturanter të Medresesë “Alauddin” në Prishtinë, përfunduan me sukses leximin e Kuranit, ku u bë edhe ceremonia e duasë së hatmes.

Në një atmosferë mrekullueshme, maurantet u prezantuan në amfiteatrin e shkollës duke kënduar tekbirot, duke shprehur gëzimin e tyre për suksesin e arritur.

Drejtori i shkollës, mr. Fadil Hasani, në fjalën e tij, i përshëndeti të pranishmit, uroi prindërit dhe mësimdhënësit, e në veçanti maurantet për angazhimin dhe arritjet e tyre, duke shprehur konsideratën e thellë ndaj

kësaj gjenerate të shkëlqyer të medresistëve.

Të pranishmëve, në emër të Myftiut Naim ef. Tërnavë, iu drejtua me një fjalë rasti kryeimami i BI-së së Kosovës, Vedat ef. Sahiti, i cili uroi nxënësët për suksesin e arritur, udhëheqjen e shkollës dhe stafin për punën dhe angazhimin, kurse prindërit për besimin e tyre ndaj Medresesë, në veçanti, e edhe ndaj Bashkësisë Islame, në përgjithësi.

Në fund të pjesës hyrëse fjala iu kalua edhe mësimdhënëses së lëndës së Kuranit të kësaj gjenerate, mr. Valbona Asllani, e cila shprehu fjalët më të mira

për këtë gjenerate të shkëlqyer, të cilat mësuan Kuranin me shumë vullnet.

Në emër të prindërve të kësaj gjenerate të maturanterve, Enis ef. Rama, kryetar i KBI-së së Mitrovicë, s iu drejtua të pranishmëve, duke i uruar maurantet për suksesin e tyre. Pastaj ndau fjalët më të zgjedhura për punën dhe rolin e Medresesë “Alauddin”, tempullit të dijes dhe të edukimit të mirëfilltë të shumë gjeneratave.

Fjolla Miftari, nga klasa e 12 u zgjodh nxënësja më e dalluar në nivel të shkollës.

NË ZVICËR U PROMOVUA LIBRI “MUHAMEDI A.S., PROFETI ISLAM”



Falë bashkëpunimit të mirë ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, të shtunën, më 27 maj 2023, në ambientet e xhamisë shqiptare në Regensburg të Zvicrës, u promovua libri “Muhamedi a.s., Profeti Islam”, i autorit Imam Vehbi Ismailit.

Në këtë promovim mori pjesë edhe një delegacion i Bashkësisë Islame të Kosovës, i përbërë nga drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri ef. Bajgora, drejtori për Veprimtari Botuese në BIK, Ramadan Shkodra dhe Bashkim ef. Mehani.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, Mehas ef. Alija, falënderoi mysafirët dhe njëkohësisht theksoi domosdoshmërinë e bashkëpunimit me institucionet si motra në vendlindje për të vazhduar më tej në pasurimin e bibliotekave me kërkime dhe studime islame, gjë e cila ngelet si një trashëgimi për brezat e ardhshëm dhe njëkohësisht një sadaka rrjedhëse për kontribuuesit e kësaj fushe. Njëkohësisht ai shprehu falënderimet e tij për të gjithë shqiptarët në Zvicër të cilët kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin kontribute të vrya

në këtë fushë. Ai gjithashtu falënderoi të gjithë organizatorët dhe të pranishmit në këtë aktivitet.

Drejtori i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, prof. Sabri ef. Bajgora, në kumtesën e tij me temë: “Shëmbëlltyra e Pejgamberit Muhamed a.s. në edukimin e fëmijëve”, theksoi rëndësinë e edukimit të rinisë dhe brezave të ardhshëm, gjë e cila është një domosdoshmëri për një rini dhe të ardhme të sigurt dhe të shëndoshë. Ai gjithashtu tha se kjo arrihet duke mësuar rreth jetës së Pejgamberit Muhamed a.s., i cili ishte modeli më i mirë për mbarë njerëzinë.


Drejtori i Veprimtarisë Botuese në BIK, Ramadan Shkodra, në fjalën e tij u përqendrua në rëndësinë e botimit të këtij libri, duke thënë se ky libër ka rëndësi të veçantë, sepse është shkruar nga një autor shqiptar, i cili emigroi në ShBA dhe dha një kontribut të çmuar për komunitetin shqiptar në Detroit, ngjashëm me të gjithë imamët që sot shërbejnë në Zvicër apo në shtetet e tjera perëndimore. Gjithashtu ai tha se ky libër është botuar në vitet e 60-ta, vite kur Shqipëria, e izoluar nga komunizmi, e kishte ndaluar fenë, por edhe në Kosovë dhe viset e tjera

shqiptare vazhdonte censura sllavo-komuniste. Së treti, ky libër është trajtuar në formën e tregimeve të cilat autori ia tregon mbesës së tij. Ai njëkohësisht shprehu rëndësinë e bashkëpunimit të mëtijshëm mes dy institucioneve tona.

Në kumtesën e tij me titull “Veprimtaria e qendrave islame dhe e imamëve në Zvicër në fushë e botimeve islame”, dr. Bashkim ef. Aliu, vlerësoi punën e kryer nga shumë xhami dhe qendra islame të cilat kanë sponsorizuar botimin e shumë librave në gjuhën shqipe dhe atë gjermane. Ai gjithashtu vlerësoi kontributin e shumë imamëve që shërbejnë në Zvicër, të cilët janë autorë të mbi 40 botimeve të tyre si autorë dhe njëkohësisht mbi 60 libra të përkthyer vetëm në këto 20-të vitet e fundit.

Në fund, Bashkim ef. Mehani, bëri një paraqitje vizuale të disa botimeve të fundit nga shtëpia botuese “Dituria Islame” pranë BIK-it.

Në përfundim të kësaj ceremonie, kryetari i Komuniteti Mysliman Shqiptar në Zvicër, Mehas ef. Alija, shpërndau mirënjohje për penalistët dhe mysafirët.



**KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS
MEDRESEJA E MESME “ALAUDDIN” PRISHTINË**



KURBANI 2023

Porosinë tuaj mund ta bëni në:

- Këshillin e Bashkësisë Islame
- Përmes bankës & PayPal

NLB Banka

IBAN: XK05 1700200100103672

SWIFT Code (BIC): NLPRXKPR

PayPal: paypal.me/bikfitra

160€

